

BIBLIOTEKA
SHTETIT

92

B21

Prof. Vehbi Bala

10



portret - monografi


MIGJENI

92
1321.

PROF. VEHBI BALA

MIGJENI

Portret — Monografi



SHTËPIA BOTUËSE «NAIM FRASHËRI»

I JETA DHE VEPRIMTARIA

FËMINIA NË SHKODËR

Milosh Gjergj Nikolla lindi më 13 tetor 1911 në Shkodër, në një shtëpi të vogël përdheske, që u prish, më 1940 nga autoritetet fashiste të qytetit, për të zgjeruar rrugën përballë një kishe, me kérkesën e kësaj. Shtëpia e lindjes ishte buzë shtëpisë muze, ku sot ruhen disa nga të mbeturat e çmueshme të shkrimitarit dhe mësuesit.

Prejardhja e familjes së tij nga i ati ishte prej fshatrave shqiptare të krahi nës së Rekës, në Dibrën e Madhe. Gjyshi i Milloshit, i quajtur Nikollë Dibrani, u shpërngul nga Reka dhe u vendos në Shkodër, aty nga fillimi i gjysmës së dytë të shekullit të kaluar. Si dihet, Reka ishte një nga krahanat kryesore, ku u organizua qëndresa ndaj reformave/qendrëzuese turke të Tanzimatit. Më 1845, Reka u përfshi në kryengritjen, që dëboi garnizonin ushtarë turk nga Gjakova, por që, përballë epërsisë së madhe të forcave kundërshtare dhe për shkaqe të tjera objektive e subjektive, u detyrua të shpërndahej. Qeveria turke mori masa të egra kundër popullsisë, e cila, megjithatë, nuk pranonte politikën e shtypjes. Me sa duket, si pasojë e përndjekjeve që ndërmorën shkelësit e huaj, Nikollë Dibrani u largua nga

krahina e lindjes dhe erdhi të kërkojë jetesën në Shkodër. Në Rekë qenë lavruar disa tradita të mira atdhetare aq sa, më 1887, pikërisht disa javë pas hapjes së shkollës së parë shqipe të Korçës, u çel edhe aty një shkollë e tillë në gjuhën amtare. Nga Reka e kishte prejardhjen atdhetari demokrat Josif Bageri, i cili nxori në Sofje fletoren e njohur «Shqypëja e Shqypënis» (1909-1911).

Nikollë Dibrani ishte mjeshtër murator dhe punonte nëpër qytet të Shkodrës dhe në fshatra të malësisë. Thuhet se, tek punonte në Kuç, u njoh dhe u lidh në martesë me një vajzë të këtij fshati të quajtur Stakë. Nga kjo martesë lindën dy djem: Gjergji (ose Gjokua) dhe Kristua. Më 1876, pikërisht atë vit, kur Serbia dhe Mali i Zi, prapa të cilave qëndronte Rusia, i shpallën luftë Turqisë, duke u ardhur në ndihmë popullsive hercegovinase dhe boshnjake, që kishin ngritur krye për autonomi, Nikollë Dibrani humbi jetën në Mal të Zi.

Gjergj Nikolla, i mbetur jetim qysh i vogël nga i ati, hyri shegert në një magazinë dhe mundi të ndiqte, për pak kohë, një shkollë italiane të qytetit, derisa doli më vete me një pjetore, të cilën, më vonë, e ktheu në dyqan artikujsh ushqimorë. Gjergji u martua me shqiptaren Sofie Anastas Kokoshi, më 17 shtator 1900, pasi krijoi një gjendje më të mirë jetese, Sofia ishte e dobët me shëndet, kishte pak shkollë, po ishte e pajisur me virtute të bukurë mëra. Nga kjo martesë lindën dy djem dhe katër vajza. Milloshi ishte djali i dytë. Më 1910, një vit para lindjes së Milloshit, Gjergji qe kapur mjaft mirë me tregëtizë dhe ia doli të përballonë nevojat e familjes, që erdhi duke u shtuar. Por më vonë e goditën fatkeqësira të mëdha, njëra pas tjetrës, në

rrethana të vështira të luftërave të njëpasnjëshme, aq sa filloi të shprishej në mënyrë rrëqethëse.

Milloshi lindi atëherë kur u poqën kushtet për kryengritjen e përgjithëshme, që do ta shporrte përgjithnjë sunduesin anadollak. Sapo mbushi një vit, nisi Lufta Ballkanike dhe Shkodra u rrethua nga trupat shoviniste malazeze. Që me qumështin e nënës, foshnja e vogël u përkund nën gjëmimin e topave të huaj për muaj me radhë. Më 23 prill 1913, feudali tradhtar Esad pashë Toptani, ia dorëzoi qytetin Malit të Zi, por, më 14 maj, trupat pushtuese u larguan. Më 4 gusht 1914, kur foshnja po mbushte tre vjet, filloi Lufta e Parë Botërore. Qyteti i lindjes u bë shesh armësh, ku thundrat e huaja shkelnin pa mëshirë. Po këtë vit, më 16 gusht 1916, familjes së Milloshit i ra një gjëmë e madhe: vdiq nënë Sofia, pas 16 vjetësh martese, në moshën tridhjetepesëvjeçare, duke lënë burrin të ve dhe dy djem e katër vajza jetimë. Në shtëpi mbetën, pra, gjyshja Stakë, babai Gjergj dhe gjashtë fëmijët e vegjël. Milloshi po hynte në të pestin vit të jetës. Rreth fëminisë së tij në Shkodër hedhin dritë kujtimet e njërsës prej motrave të tij.¹⁾

Shtëpia, ku lindi Milloshi, ishte e ulët, me dy dhomëza e një korridor, prej të cilit dilej në një oborr të vogël.

Gjyshja Stakë, ndonëse në moshë të thyer, rrapoatej tërë ditën në shtëpi, për të gatuar e për të arnuar, për të larë e për të shplarë. Por kujdes të veçantë kishte për Milloshin e mitur e të brishtë, që vinë i pakët dh i imtë nga shëndeti. Kur ky u bë trevjeçar, u sëmur aq keq nga pleviti, sa njerëzit e familjes e humbën besimin se do të shërohej.

Në dimër, djali i vogël lodronte me të motrat

më të vogla. Fshiheshin prapa derës së hapur të dhomës dhe me krehër krihnin radhazi njëri-tjetrin, duke i ndarë flokët me një vijë nga pas.

— Kush e ka krehur tjetrin më mirë, gjyshe?
— pyesnin gjyshen Stakë.

Plaka, natyrisht, çmonte më lart aftësinë e Milloshit.

Në mbrëmje, tata Gjergj vinte në shtëpi i lodhur nga puna e rëndë e ditës në dyqan. Fëmijët e prisin me padurim. Ai zhvishej dhe pastrohej, zinte vendin e vet të zakonshëm në minder, në njërrën anë të dhomës së ndenjës. Në anën tjetër, ende para darkës, shtroheshin dyshekët për të fjetur më të vegjëlit tok me gjyshen Stakë. Teksa shtroheshin dyshekët, fëmijët gjenin një lodër tjetër: nisnin të mateshin se kush ishte më i fortë, duke bërë lara-dasha dhe mundje tërheqëse. Gjyshja druhej se mos vriteshin, kurse tata Gjergj kënaqej dhe queshte me gjithë zemër, sidomos për shakatë me kripë të Milloshit. Motrën e vogël ky e rrëzonte «me një gisht...», por, kur në mundje hynte motra pak më e madhe se ai, vogëlushi bëhej all në fytyrë dhe s'ishte më në gjendje të dilte mundës.

— Desha vetë të rrëzohem... — i thoshte baba.

Në verë, në piskun e vapës, babai urdhëronte fëmijët që të bënin një sy gjumë pas dreke, kësaj radhe në dhomën e «pritjes», ku, zakonisht, flinte vetë babai me djalin e madh. Me hir a me pahir, fëmijët e vegjël mbyllnin sytë dhe pushonin. Zgjohet babai, zgjoheshin edhe ata. Atëherë, bashkë me motrën e vogël, shkonte në korridor, ku i ati qëndronte në fresk për të pirë një kafe, para se të dilte përsëri në dyqan. Milloshi merrte këpucët e ba-

bait dhe, ndonëse ishin fshirë e lustruar që më parë nga motra e madhe, i lustronte sërisht me furçë, duke u matur me motrën e vogël se cili e krynte më mirë këtë punë prej lustraxhiu.

— Lustra! Lustra! — thërriste Milloshi me zë të lartë, dhe tata Gjergj kënaqej duke e parë.

Milloshi po rrитеj vërtet pa përkëdhelitë e nënës, por, për të plotësuar këto, kishte kujdesin e parrështur të gjyshes së dhembshur, dashurinë e parrëfyer të babait, ngrrohtësinë e motrave dhe të vëllait të vetëm.

Kur Milloshi u bë në moshë për të hyrë në shkollë, i ati e çoi në filloren serbe të qytetit të Shkodrës. Regjimet antipopullore dhe institucionet e huaja fetare kishin ngritur me kohë në këtë qytet shkolla të tilla për të përhapur politikën e shteteve imperialiste dhe shoviniste-turke, italiane, serbe. Një nga mjetet e thellimit të ndasisë kombëtare ishte përçarja fetare me anë të kishave, xhamive dhe shkollave në gjuhë të huaja. Këto veprime antikombëtare i provoi që në vegjeli edhe Milloshi, ashtu sikurse fëmijët e tjerë të kohës, që detyroheshin të shkonin nëpër shkollat e besimeve përkatëse fetare. Që në moshë të njomë, ai u ndesh me atë kontrast të thellë, që ndante në dy fole të kundërtë shtresat e pasura dhe vegjelinë varfanjake, kishën e lartë franceskane dhe shtëpinë e tij përdheske. Ai hyri në një shkollë, ku detyrohej të merrete dogmat e para të fesë ortodokse në gjuhën serbokroate.

Në fillore fitoi të gjitha notat «shkëlqyeshëm». Mësuesit e lëvdonin gjithnjë për punën e mirë, sjelljen dhe pastërtinë. Ndonëse i brishtë dhe i imtë, ai nuk ishte i ngathët. Kërkonte lodra të ndryshme dhe në to tregohej mjaft i zhđervjellët. Por tanë,

pak më i rritur, ato erdhi duke i rralluar. Shkonte dhe vinte më shumë me një kushëri moshatar, i cili banonte larg shtëpisë. Kur s'takohej me të, rrinte e lodronte me shokët e lagjes.

Qyteti ishte ndarë si me thikë në dy anë: në njérën banonin vetëm muslimanë dhe në tjetrën vetëm katolikë. Ortodoksët, shumë më të pakët në numër, ishin, si të thuash, të vendosur në mes. Këtë ndarje në dy krahë e dallonte njeriu, në fytyrën e qytetit, qysh në pamjen e parë: te xhamitë me minare dhe te kishat me kryqe, që thernin qiellin, te shtëpitë, dyqanet dhe deri te veshjet e njerëzve. Këtë ndasi e kishte mbjellë me kohë parësia e klasave shfrytëzuese dhe fetare. Vegjëlia punëtore, e varfër, e shtypur dhe e shfrytëzuar nga shkelësit e huaj e nga rendi sundues i vendit, pësonte rrjedhimet e përgjashme. Fëmijët e besimtarëve të ndryshëm nuk i njihnin dredhitë e parësisë, që përçarjen fetare e thellonte për t'i shfrytëzuar më shumë masat punonjëse; ata, të vegjël sic ishin përfshireshin ndër lagjet, ku ndarja e qytetit i kishte zënë. Ata lozni dhe shoqëroheshin sipas kësaj ndarje me thikë. Shpesh, të nxitur për të krijuar pështjellime në qytet, në rrëthanat politike që shfrytëzonin parësia dhe kleri reaksionar, elementët e pavetëdijshëm të besimeve të ndryshme fetare përlesheshin njëri me tjetrin. Kjo përleshje ndodhte edhe me fëmijët. Të vegjëlit e një feje dilnin në grupe dhe prisnin «kundërshtarët» për t'u kacafytur me grushte, me gurë e me thika. Pas këtyre rrahjeve, të vegjëlit ktheheshin ndër shtëpitë e tyre duke qarë me dënesë nga plagët e rënda që merrnin. Milloshi i vogël banonte në një lagje katolikësh, veç ai kurrë s'u kthye në shtëpizë i rrahur dhe kurrë s'u që për

përleshje të tillë, jo se e kuptonte ku qëndronin rrënjet e pérçarjes, por sepse gjente shokë të mirë në të dyja anët e qytetit. Edhe kur familja e tij u shpërngul nga banesa përdheske përballë kishës franceskane dhe vajti nëpër tri shtëpi të tjera me qira, ai ruajti miqësitë e para me të vegjëlit e lagjes ku lindi. Jo rastësish, kudo që vajti, fëmijën e vogël e ndoqi po ai kontrast i thellë shoqëror e fetar i qytetit. Ai përsëri, më vonë, u vendos në një banesë përdheske, përballë së cilës, kësaj radhe, nuk ishte kisha franceskane, por shtëpia luksoze e familjes së «Kapidanit të Mirditës», ku bijtë e bijat e tij jetonin në «shtretënt e lumtunisë» dhe ku s'arrinte dot «zani i lypësisë». Tërë mjedisi, rrëth e qark, ishte pronë e urdhërit jezuit. Këto pamje të shoqërisë së qytetit, ndarë, sipas pronës, me avlli të larta dhe, sipas fesë, me dogma të prera, do të mbeten në kujtesën e tij të pashlyera dhe do të pasqyrohen më vonë me vija e ngjyra të forta në veprën e tij aq të frymëzuar letrare.

Si zakonisht, shkollari i vogël kthehej shpejt në drekë dhe më shpejt akoma në mbrëmje. Babai kujdesej në mënyrë të veçantë që fëmijët e tij jetimë, pa nënë, të mos bridhnin rrugëve sëkoti. Ai urdhëronte që, me të ngrënë drekën, në zhegun e fortë, që kapërtante qytetin, fëmijët të binin në gjumë. Kjo s'i pëlqente fort vogëlushit, por babait s'i duhej prishur qejfi dhe urdhëri i tij duhej quar në vend. Në oborr kishte pemë të ndryshme, si kumbulla bardalike dhe zerdelia. Ishte koha kur këto piqeshin dhe sikur të grishnin për t'i ngrënë. Të vegjëlit, të shtruar mbi dyshekë, pikërisht kur nisin të dremitnin, dëgjonin se si binin për tokë frutat e pjekur, nën diellin e zjarrtë, dhe goja u shkon-

te lëng. «Tak» binte njëra kokërr, «tak» e pasonte tjetra, «vring» conte kokën Milloshi mbi jastëk, për t'i numëruar më mirë.

— Një... dy... tri... — pëshpëriste ai te veshi i motrës së vogël, derisa, me porosinë e fundit të babait, detyrohej të ulte kokën, të kyçte gojën dhe të mbyllte sytë. Atë me siguri e zinte gjumi duke shpresuar se, kur të ngrihej nga dysheku e të dilte në oborr, do t'i gjente kokrrat të gatshme përtokë. Por nuk ndodhë kështu, sepse disa fëmijë të tjerë fqinj, të cilët ndoshta nuk detyroheshin nga prindërit të flinin në zhëgun e ditës, rendnin me të katër dhe i merrnin frutat një nga një. Tata Gjergj e vërente këtë gjë, por shtihej sikur nuk kuptonte. Veç në mbrëmje, kur kthehej në shtëpi, nuk harronte t'u sillte fëmijëve pikërisht kumbulla bardalike dhe zerdeli.

Gjyshja Stakë, si ngrihej nga shtrati, ku 'pushonë në vapë, e kishte bërë zakon të ulej në korridor, në fresh, të thërriste mbesat më të rritura dhe t'i vinte të shprishnin lesh. Milloshi i vogël donte të bënte si ato: merrte një shtëllungë në dorë dhe shtrohej në punë. Gjyshes i queshte nuri. Vogëlushi mburrej se dinte edhe të thurte, prandaj kapte nganjëherë shtizat. Atëherë, një fqinjë, që e kishte përzemër vogëlushin, e ngacmonte duke i thënë se do t'u thoshte shokëve të tij që «*Milloshi bën punë vajzash*». Por Milloshi nuk tundej nga ky ngacmim dhe vazhdonte punën, derisa e tërhoqite një lodër tjetër në rrugë.

Në shkollë, si thamë, shkonte rregullisht: i pastër, i veshur me shije, i përgatitur. Detyrat e shtëpisë i bënte vetë. Librat dhe fletoret i mbante mirë. Shkrimin e endte me kujdes. Por shpesh, në klasë,

mendja i fluturonte te një shok e mik, që e donte shumë dhe që s'i ndahej në shtëpi e në rrugë, veç kur ai hynte në shkollë ose kur binte në gjumë. Ky shok e mik ishte qeni i tij besnik «Biser». Gjyshja mërzitej kur «Biseri» trazovaç ia shpupurishte dhe ia shpërndante leshin nëpër korridor. Veç, për hatër të të nipit, e duronte dhe nuk i fliste rëndë.

— «Biser! Eja këtu! — e thërriste Milloshi. Dhe qeni shkonte në vendin që i tregonte i zoti.

Në shpërblim të kësaj besnikërie, vogëlushi e ndante çdo gjë të mirë me të. Kur tata Gjergj i jepte para për të blerë në mëngjez simite me salep, Milloshi ia ndante gjysmën e simites «Biserit» dhe ia mëkonte vetë, duke ia mëlmyer me salepin eëmbël. Gjatë gjithë fëminisë së tij në Shkodër, «Biseri» qe për të një qenje e pandarë. Por, kur Milloshi kreua filloren dhe u largua nga qyteti i lindjes, qeni ngeli pa shok në shtëpi, rroi sa rroi, derisa dikush nga familja, padashur, e përvëlloi me qumësht të valuar. Më kot Milloshi do të shkruajë e të pyes me letra për shokun e mikun e pandarë të fëminisë. Motrat nuk do të guxojnë t'i tregojnë menjëherë, përfundin e dhimbshëm të jetës së tij, sepse do të druhen se mos vëllai i tyre do të lëndohej shumë, ashtu siç do të ndodhë vërtet, kur do ta marrë vesh lajmin e zi.

Kështu kaloi fëminia e Milloshit në Shkodër. Kur kreua filloren, nuk ishte më shumë se dymbëdhjetë vjeç. Tata Gjergj, me qëllim që djali të vazhdonte shkollën në një qytetëse, e dërgoi në Tivar, te bija më e madhe, që ishte martuar atje me një mekanik nga Kavaja.

Milloshi ishte ende i vogël për të kuptuar ngjarjet e mëdha, që po ndodhnin njëra pas tjetrës në

betejën e ndezur midis forcave demokratike të shqërisë shqiptare dhe atyre çifligaro-borgjeze për çështjen e regjimit në Shqipëri. Fëminia e tij kaloi shpesh e shqetësuar nga kthesa të forta që shkaktuan luftrat e njëpasnjëshme në qytetin e lindjes dhe nga vdekja pikëlluese e nënës së tij të ëmbël. Ima zhi i fëminisë do t'i mbetet i tiposur thellë në kujtesë dhe motivi i të vegjelvë do të trajtohet prej tij më se një herë në temën e qytetit dhe të fshatit, ashtu siç do të trajtohet edhe motivi i kundërshtive shoqërore, ekonomike e politike, i kontrasteve të shumta qytetare, i mjerimit, i errësirës fetare, etj. me të cilat ai u ndesh që në vegjeli në qytetin e lindjes, që nga pushtimet e huaja deri në prak të revolucionit demokratik borgjez të qershorit të vitit 1924.

NXËNËS NË TIVAR DHE NË MANASTIR

Njeriu e merr me mend se me sa dashuri do ta ketë pritur familja e motrës së madhe Milloshin e vogël në qytetin bregdetar të Tivarit. Ky qytet nuk ishte larg mjedisit shqiptar. Sipas udhëtarëve të huaj të viteve '30-'40 të shekullit të kaluar, Ami Bue-s dhe J. G. Han-it, kufijtë e trojeve të banuara krejtësisht ose kryesisht nga shqiptarët shtriheshin në një zonë të gjërë, që përfshinte edhe tokat në jug të Tivarit. Si dihet, më 24 prill 1877 Rusia i pat shpallur luftë Turqisë. Në rrëthanat e operacioneve të ushtrisë ruse kundër forcave kryesore turke, Malë i Zi rifilloi luftën kundër Turqisë, duke pushtuar, ndër të tjera, edhe Tivarin. Për Milloshin e vogël kalimi nga Shkodra në Tivar, njëkohësisht me kalinin nga fillorja në qytetëse, qe një ngjarje me rëndësi. Por ai shpejt u mësua me vendin e me njerëzit. Përkëdhelitë e gjyshes, ngrohtësinë e babait, dashurinë e motrave dhe «Biser-in» besnik nuk e kishte më; në vend të tyre kishte tani kujdesin e motrës së madhe dhe mësimet e shkollës, që vinin duke u vështirësuar. Ndonëse i dobët nga shëndeti, ai në Tivar përvetësoi për bukurin sportin e notit. Por nëse viti i parë i kaloi me mësime dhe lodra të ndryshme argëtuese, viti i dytë nuk qe i qetë për

të. Më 21 mas 1924 i vdiq i ati, Gjergj Nikolla, në moshën pesëdhjetëvjeçare, duke varfëruar pa mës familjen e gjorë. Milloshi mbeti tani jetim pa nënë e pa baba, mbeti vetëm nën kujdesin e gjyshes plakë, të vëllait 23 vjeç dhe të motrave zemërplasura. Për një kohë, vogëlushi trembëdhjetëvjeçar braktisi lodrat, humbi buzëqeshjen dhe u tërroq më vete me dhembje të thellë. Pasi mbaroi klasën e dytë të qytetëses në Tivar me notat «*shumë mirë*», me përjashtim të gjuhës serbokroate, ku mori «*mirë*», një dajë i tij i nxori bursë për të vazduhar mësimet në gjimnazin e Manastirit.

Në vjeshtën e vitit 1925, Milloshi u largua nga motra e madhe, nga Tivari, dhe u ngul në Manastir. Por edhe atje e ndoqën, njëra pas tjetrës, fatkeqësitë familjare. Po atë vit i vdiq vëllai i vetëm, Nikolla, në moshën njëzetkatërvjeçare, kurse një vit më vonë, gjyshja Stakë, në moshën tetëdhjetëvjeçare. Familja e Milloshit u godit shumë rëndë, kur ky ende ishte fëmijë pesëmbëdhjetëvjeçar dhe pikërisht kur mori semimaturën.

Ngjarjet e rëndësishme të Revolucionit Demokratiko-Borgjez, ndeshja e ashpër klasore dhe restaurimi i regjimit reaksionar feudal-borgjez, që solli thellimin e shfrytëzimit, mjerimin dhe ashpërsimin e luftës klasore nuk kaluan pa lënë mbresa të thella tek Migjeni qysh në moshën adoleshente, mbasë jehona e tyre u reflektua thellë në veprën e tij. Semimaturën e mori me notat «*mirë*» në serbokroatësht, në histori dhe në fizikë, kurse «*mjaftueshëm*» në aritmetikë. Po ai dajë, që i nxori bursën për të ndjekur mësimet në gjimnazin e Manastirit, i nxjerr tani bursën për në seminarin ortodoks të këtij qyteti, ndonëse Milloshi nuk donte të meirte rrugën

e priftërisë. Por, i mbetur jetim dhe i vetëm në dallgët e furishme të jetës, pranoi të hyjë në këtë seminar, me qëllim që, më vonë, ta zgjidhte vetë rrugën e së ardhshmes.

Manastiri u bë qyteti i tretë i fëminisë dhe i rinasë së tij. Në Trevën e Manastirit dhe të Ohrit, si një pakicë e rëndësishme, bashkëjetonte me popullsinë sllavo-maqedonase edhe popullsia shqiptare. Gjatë pushtimit turk, Manastiri kishte qenë qendër ejaleti; më vonë u bë vilajet. Territoret e Maqedonisë nuk bënин pjesë në asnje njësi të vetme administrative turke, por pjesa më e madhe e tyre përfshihej në vilajetin e Manastirit. Përfshiheshin në të edhe sanxhaqe me popullsi shqiptare ose kryesisht shqiptare. Sipas statistikave të kohës, shumicën e popullsisë së vilajetit të Manastirit e formonin shqiptarët. Popullsia shqiptare e Manastirit u lidh që herët me lëvizjen tonë kombëtare. Në Manastir, më 1886, Gjergj Qirjazi hapi një shkollë private shqipe. Kur në lëvizjen kombëtare fillooi të forcohej dhe të ushtronte ndikim më të madh rryma e atdhetarëve revolucionarë e demokratë, të cilët rridhnin kryesisht nga shtresat mikroborgjeze të fshatit dhe të qytetit, pra kishin edhe kufizimet e tyre të njoitura, përfaqësues të tyre morën këtë radhë në dorë drejtimin e lëvizjes për krijimin e organizatës së fshehtë. Në nëntor të vitit 1905, me nismën e Bajo Topullit, u formua në Manastir një komitet i fshehët shqiptar me emrin «Për lirinë e Shqipërisë», ku merrte pjesë edhe Gjergj Qirjazi. Në janar të vitit 1906, ky komitet mori vendim të krijojë çetat e para të lirisë. Fill pas shpalljes së kushtetutës («Hyrijetit»), në Manastir u krijuau klubë i parë shqiptar «Bashkimi», i cili jo vetëm nuk ra nën ndikimin zhon-

turk, por, në shumë raste, luajti rol drejtues në lëvizjen kombëtare në Shqipërinë e Jugut e të Mesme. Në Manastir u mblodh, prej 14 deri më 22 nëntor 1908, «Kongresi» i njojur për caktimin e alfabetit të vetëm të shqipes, që pati rëndësi të madhe kulturore e politike për lëvizjen tonë kombëtare. Atje filloi veprimtarinë atdhetari Themistokli Gërmenji dhe po atje u botuan fletoret «Bashkimi i Kombit» (1909-1910), nën drejtimin e Fehim Zavalanit, dhe «Drita» (1911-1912), nën drejtimin e Muço Qullit.

Në atë qytet plot kundërshti të karakterit shoqëror, kombëtar dhe fetar, me kaq tradita atdheta-re të popullsisë shqiptare, Milloshi do të qëndrojë deri në moshën njëzetën jëvjeçare. Në kushtet e këtyre kundërshtive lindi një lëvizje e gjërë punëtore dhe depërtuan mendimet socialiste. Që në fillimet e viteve '20 vepronte Federata Komuniste Ballkanike, e cila ndihmoi të mërguarit antizogistë shqiptarë të organizonin, më 1925, konferencën, që krijoi Komitetin Nacional Revolucionar në Vjenë. Kur, më 1927, Konare-ja u kthye në Komitet të Çlirimt National dhe zhilloi më tej programin demokratik revolucionar, ky Komitet kërkoi ta koordinonte lëvizjen antizogiste me lëvizjen çlirimtare të të gjithë popujve ballkanikë të shtypur nga qeveritë reaksionare, kërkoi të mbështetet në «organizatat kombëtare liberatore ballkanike». Në këtë kohë kemi në atdhe shfaqje të ndryshme të lëvizjes punëtore dhe fillimet e lëvizjes komuniste. Më 1928, në Korçë u formua celula e parë komuniste me punëtorë dhe zejtarë të përparuar. Lëvizja komuniste i zgjeroi radhët e veta dhe, brenda një viti, më 1929, kur Miloshi arriti në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare

u formua Grupi Komunist i Korçës. Kjo ishte e para organizatë politike revolucionare e klasës punëtore në Shqipëri. Nga të gjitha grupet e tillë, që do të ngrihen më vonë në atdhe, grupin e Korçës Milloshi do ta vlerësojë dhe simpatizojë më shumë.

Në vitin e parë të seminarit, ndonëse i lënduar dhe i pikëlluar nga të gjitha ato fatkeqësira që e goditën, Milloshi nuk u nda keq me mësimë: mou «mirë» në serbokroatishë, greqishtë, latinishtë dhe frëngjishtë. Në vitin e dytë, në këto gjuhë dhe në rusishtë mori «shumë mirë», kurse në patrologji (letërsi kishëtare) notën «mirë» dhe në pedagogji, metodikë, gjimnastikë e këngë «shkëlqyeshëm». Në vitin e tretë, në greqishtë dhe latinishtë zbut në «mirë», ashtu si dhe në «Shkrimet e shenjta». Në vitin e katërt gjithnjë merr «mirë» në latinishtë, kurse «shumë mirë» në greqishtë dhe «shkëlqyeshëm» në rusishtë, teksa «mirë» në dogmatikë (teologji), psikologji dhe logjikë. Në vitin e pestë, domethënë të fundit, në latinishtë dhe në mësimet fetare nuk e kalon notën «mirë». Notat nuk janë treguese të saktë të dijenive të nxënësve, sepse shpesh janë të vendosura në mënyrë subjektive, që varen nga ndërgjegjja, simpatitet apo antipatitetë e mësuesve, sidomos në një shkollë si ajo ku nxente Milloshi. Prapëse-prapë pasqyra e mësipërme dëshmon, sadopak, për interesat e tij, për kujdesin që tregonte ai ndaj gjuhëve të huaja, frëngjishtes dhe rusishtes. Me sa rrëfejnë bashkënxënësit, ai ishte shumë i përpikët me mësuesit, ndonëse ndonjëri sish e merrte me sy jo të mirë për prirjen ndaj problemeve jashtë sférës fetare. Kështu, na thonë se mësuesi i gjuhës i paskësh bërë një herë këtë shënim të prerë një har-timi të tij në klasë: «Parashtrimi 5; brendia 0!» Po

pikërisht në hartime fitonte edhe çmime. Nganjëherë, hartimet i shkruante në vargje. Interesimin e posaçëm për gjuhët e huaja të gjalla dhe për problemet shoqërore na e dëshmojnë edhe shënimet e vetë Milloshit në radhorët e librat e leximit. Kjo ishte e natyrshme. Me anë të frëngjishtes dhe të rusishtes ai mundi fë lexonte një letërsi të gjerë drejtpërdrejt në original ose në përkthimet e bëra në këto gjuhë, si dhe në serbokroatishë, nga letërsia botërore. Në bibliotekën e vogël vetjake të Milloshit, ekspozuar në Shtëpinë-muze të tij në Shkodër, shohim veprat e klasikëve rusë L. Tolstoi, etj., të themeluesve të realizmit socialist Gorki, Majakovski, etj., si dhe të një radhë autorësh përparimtarë të letërsisë evropiane të shekullit të kaluar e të shekullit tonë. Ne do të kishim një pasqyrë më të plotë të leximeve të tij, pra edhe një kuptim më të gjerë të formimit të tij intelektual e të edukimit të tij shoqëror, po të kishim në dorë sot të gjitha librat dhe dorëshkrimet e Milloshit, që u dogjën ditën e 22 qershorit 1942, kur ranë tre Heronjtë e Shkodrës, ndër të cilët bënte pjesë edhe shoku, miku e bashkënxënësi Jordan Misja.

Duke gjykuar sipas fondit të librave, që kanë mbetur nga biblioteka e vogël vetjake e Milloshit, përveç letërsisë kishëtare, të cilën ishte i detyruar ta përvetësonte në seminarin teologjik, që nga «*Dhiata*», «*Bibla*», «*Rrëfimet e Augustinit*», deri te të përkohëshmet fetare — nxënësi i seminarit ortodoks të Manastirit kishte edhe letërsi historike, sociologjike e artistike. Nga kolana «*Les clasiques pour tous*» (klasikët për të gjithë) vërejmë librin e Blez Paskalit «*Mendime*», si dhe atë të Antuan Galandit «*Historia e Sindbad detarit*», të cilat i ka përdorur

si tekst për të nxënë frëngjishten; nga kolana «Biblioteka Narodnog Universiteta u Beogradu» (Biblioteka e Universitetit Popullor në Beograd) librat serbokroatishë, që trajtojnë probleme të filozofisë, psikologjisë, të njohjes së botës bashkëkohore, etj., thuajse të gjitha të viteve 1928-1929, por, mbi të gjitha, librat nga kolana «Nolit» («Novaja literatura» — Letërsia e re), si romanet: «Metropol» i Apton Sinklerit, «Rruja kryesore» i Sinkler Levisit, «Sama» i Anjes Medlit», «Trëndafili i bardhë», i B. Travenit, «Mbreti Alkool» i Xh. Londonit dhe përmbledhja e 13 novelave nga Vojvodina «Rend duhet të ketë» e J. Popoviçit. Sipas shënimeve të Milloshit, shohim se që më 1929 ai ka lexuar «Vëllezërit Karamazovë» të Fjodor Dostojevskit, kurse, pas dy vitesh, librin «Shënime nga shtëpia e të vdekurve» të po këtij autori. Thuajse në të gjitha këto libra kemi nënvizime ose shënime të tij anash. Në kushtet e censurës së seminarit teologjik, Milloshi nuk mundi të shënone qartë mospajtimin e tij me dogmat fetare; megjithatë, është interesant të vërejmë se në librin e Petar Çules «Misli velikih umova o bogu i vjeri» (Mendime të mendjeve të mëdha mbi zotin dhe fenë), botuar më 1925 dhe lexuar nga Milloshi më 1929, lexojmë të nënvizuar, si për qesëndi, thënjen e Herderit: «Početak i konac filozofie bila je uvi-jek religija» (Fillimi dhe mbarimi i filozofisë ka qenë gjithmonë feja). Në mjaft vise të romanit të Dostojevskit «Vëllezërit Karamazovë» janë nënvizuar gjithashtu ato caste mistike me të cilat, si duket, ai nuk pajtohej. Për formimin intelektual të Milloshit luajtën rol të madh veprat letrare bashkëkohore, romanet realiste kritike të shkruara nga shkrimitarë të njohur si Xh. Londoni, B. Traveni, etj. Kritika ku-

ndër rendit borgjez, kundër shfrytëzimit imperialist mbi vendet e pazhvilluara, demaskimi i formave të ndryshme të sundimit mbi popujt punëtorë, të gjitha këto mbrujtën te Milloshi urejtjen për kapitalizmin, kolonializmin dhe reaksionin. Romanet «*Metropol*», «*Mbreti Alkool*», «*Rruga kryesore*», *Trëndafili i bardhë*», etj., që u përkthyen dhe u botuan serbokroatisht në vitet 1930-1932, i siguroi që kur ishte nxënës në Manastir dhe i solli në atdhe. Këto vepra përparimtare do t'ua shpërndajë shokëve për t'i lexuar. Njérën prej tyre, romanin «*Rruga kryesore*» të Sinkler Ljuisit, do t'ia dhurojë nga Shkodra shqes së vet me këtë shënim: «*Bojkës — si shej mirënjohje dhe kujtimi, M. Nikolla, Shkodër më 12 shtator 1935*». Novelat e J. Popoviçit me pamje dhe fityra nga bota e ngushtë krahinore e Vojvodinës, të botuara më 1932, trajtonë me realizëm kritik atë tematikë, shtjellojnë me satirë, stil të mprehtë e të qartë atë problematikë shoqërore, që na kujton skicat migjeniane në kushtet, rrethanat dhe njediset e vendlindjes së tij.

X Milloshin e interesonte historia e vendit, lëvizja shoqërore dhe mendore, që, në ato vite pasqyrohej, sado në mënyrë të kufizuar, në libra dhe të përkohshme. Veprën «*Historia e Shqypnisë*» të Ndoc Nikajt, të botuar më 1917, e ka lexuar me vëmendje, ka shënuar, në faqen 164, «*Shumë interesant*» dhe ka nënshkruar «*M. Nikolla*» tri herë me radhë në faqe të ndryshme. Do të shohim më vonë se, kur do të ngulet përfundimisht në atdhe, do të ndjekë edhe botimet e klerit reaksionar katolik, duke bërë një mori nënvizimesh për ato raste flagrante, në të cilat luftohej mendimi përparimtar materialist. Do të shohim më vonë se si librat kishtare dhe ata të propa-

gandës fetare do t'i quajë «*paçavure, që zunë myk ndër tempuj*». Për kupimin e formimit të pikëpamjeve të tij mbi botën dhe shoqërinë njerëzore do të na shërbejnë edhe nënvizimet shumë interesante që do të bëjë në veprën «*Vilhelm Teli*» të F. Shilerit, të shqipëruar nga Skënder Luarasi. Por, për këto do të ndalemi në kapitujt e ardhshëm, ashtu siç do të ndalemi edhe te veprat realiste socialiste të M. Gorkit, A. Tolstojt, etj. që ai i lexoi te përmbledhja e gjerë «*Nova ruska proza*» (Proza e re ruse), të përkthyer e të botuar serbokroatisht më 1933, në kolanë «*Letërsia e re*».

Provimet e pjekurisë i dha nga 1 deri më 17 qershori 1932, duke marrë 6 nota «mirë», 14 «shumë mirë» dhe 2 «shkëlqyeshëm». Ky ishte përfundimi logjik i studimit të tij sistematik dhe i aftësive të tija intelektuale.

Një nga bashkënxënësit e tij më të afërt ka qenë mësuesi dhe piktori, dëshmor i ardhshëm komunist, Jordan Misja. Shokët e donin shumë. Në shoqëritë kulturore në shkollë ose gjatë pushimeve verore në Shkodër, atë e zgjidhni sekretar. Për një kohë drejtoi rrëthin letrar të shkollës. Kemi në dorë tanimë disa mbresa të shkruara të shokëve të tij, që e kujtojnë kur ishin bashkë me të në Manastir. Milloshi kishte, thotë njëri sish²), një fytyrë të ëmbël e të qeshur. Pashaporta, që iu lëshua nga konsullata shqiptare në Manastir, e përshkruan me këto tipare fizike: «*Shtati i lartë, ... balli i rregullt, sytë gështenjë, hunda e rregullt, goja normale, flokët gështenjë..., ngjyra e bardhë...*».

Milloshi kishte një zë të ëmbël lirik prej tenori dhe, me një pajë të tillë prej natyre, me një shije e vesh të hollë muzike, merrte pjesë, si një nga pje-

sëtarët më të mirë të tenorit të parë, në korin e seminarit. Shokët e thërrisin «bilbil». Në masën e nxënsve, ai ndahej në shenjë si një nga më të aftit e më seriozët e shkollës. Kishte, rrëfen bashkëshkollari, një zgjuarësi të mprehtë, të përsosur, shquhej si talent i fuqishëm dhe i pasur në të gjitha mbledhjet dhe konferencat letrare të seminarit... Teologjinë nuk e pati për zemër, megjithëse u detyrua ta njihet. E interesonin veçanërisht arti letrar, muzika dhe, sidomos, problemet shoqërore. «*Kurdo që shfaqe jndonjë çështje për mbrojtjen e së drejtës, në çfarë do lande qoftë, Milloshi shpërblyente si llavë vullkani me shprehjet e tija të zjarrita plot shpirt. Më kujtohet shpeshherë kur fliste në konferencë. Ai dukesh si një flakë, që digjesh për të drejtën njerëzore*».³⁾

Kishte në rrethin shoqëror një qëndrim të urtë. Fliste pak. Ishte, si thotë një ish bashkënxënës i tij, «Tihi čovjek» (njeri i qetë), nuk merrej me gjëra të parëndësishme, me vogëlsira. Grindjet, për gjëra të tillë, i urrente. Kur e sillte hera të gjendej në ngatërresa për punë të kota, hahej me vvetven, skuqe nga zemërimi dhe largohej duke mbajtur një vështrim qortues, herë me të heshtur, herë me të folur, ndaj shokëve, që binin në thashetheme. Ndoshta përkëtë arësye, ndokush pandehu se Milloshit i paskësh pëlqyer tepër vëtmia. Bile është arritur derisa të merrej përmizantrop. Por kjo s'ishte e saktë. Milloshi linte përshtypje të tillë sepse ishte i përbajtur dhe i prushëm. Kishte botën e tij që e ruante me ngulm. Në mbrëmjet e vallëzimit, që organizoheshin nga nxënësit dhe nxënëset e shkollave të mesme të qytetit, merrte pjesë edhe Milloshi. Pamja e jashtme e përpiktë dhe e pastër meditative e kontemplative, përkonte me maturinë dhe hijeshinë e sjelljes e të

të shprehurit të tij. Për vajzat kishte një nderim të veçantë. Ishte i ndjeshëm ndaj bukurisë femërore. Një ish-bashkënxe në i tij kujton një dashuri të Milloshit me një vajzë në Shqipëri, me të cilën këmbente letra. Këtë dashuri e mbante fshehur dhe rrallë kujt ia rrëfente... Ndoshta ishte zonjusha B... Ai nuk ia lëjonte vetes të kalonte masën, që dallon ndjenjën e nxehjtë nga logjika e akullt. Po ta vështrosh me kujdes albumin e fotografive të tij, të bie në sy ajo thjeshtësi e veshjes, e cila të tërheq për ngjyrat dhe simetrinë.

Verës, eprorët klerikë i dërgonin seminaristët për pushime, me qëllim të caktuar, pranë manastireve të ndryshme. Kështu ndodhi një herë, kur i nisën në manastirin Vraçin, midis bjeshkëve të Peristerit dhe liqenit të Prespës. Bashkë me të tjerët, vajti edhe Milloshi. Vendi ka pamje magjepsëse, plot pyje, përrrenj dhe liqenj. Djaloshi u kënaq me natyrën, që e joshte aq shumë, dhe me shokët, që i kishin më për zemër. E ndjeu veten të çliruar për një kohë nga atmosfera e zymtë e seminarit. Në natyrë të hapët, në ajër të pastër dhe të lirë, shpërtheu kënga e tij, herë në shoqëri, herë në vetmi, herë ditën për diell, herë natën për hënë. Jonet eëmbla lirike të zërit të tij prej tenori tërhiqnin menjëherë dëgjuesit dhe shoqëruar nga rrëthi i afërt. Këndonte këngë shqipe, serbe dhe ruse. Kishte një «repertor» mjaft të pasur. Nga këngët shqipe i pëlqenin «Në mës të pyllit do vemi» dhe «Nën hije të hënës rrinnje»; nga të huajat kënga ruse «Vjeçerni Zvon», «Serenata» e F. Shubertit, etj. Kur ia merrte këngës, ndjente një èndje të thellë në shpirt, një prehje të vërtetë. E kishte këngën si shoqe intime. Edhe kur luante shah, e kishte zakon të merrte me fishkëllimë

të lehtë ndonjë melodi, Jo rrallë i bine edhe mando-linës. Një motër e tij dëshmon se në shtëpi kondon-te shpesh. Me ëndje të madhe dëgjonte këngët kora-le, sidomos ato ruse. Me veshin e hollë muzikor, meloditë i kapte menjëherë. Kur motrat ishin të mërzitura, i luteshin t'u këndonte diçka. Dhe ai nuk ua prishte. Ato kënaqeshin me zërin e tij të bukur.

Pasion i tij ishin edhe teatri i kinemaja. I ndiqte shumë, kur kishte para. Shpesh, nga Manastiri i shkruante një motrës së tij se ç'pjesë dhe filma kish-te parë. Filmat i komentonate dhe përpinqej të sqa-ronte çdo gjë, që, pér të tjerët, mund të ishte e errët. Njihte, si thonë, një radhë regjizorësh dhe artistësh nga filmat që kishte parë. Nganjëherë, duke u mbështetur në aftësitë e tyre, i gjykonte filmat «à priori». Nuk i pëlqenin sentimentalizmat romantike. Në skicën «*Urime pér 1937*», ai do të përmendë me ironi të hollë Greta Garbo, që puth shtyllat në filmin «*Mbretëresha Kristina*», kurse te skica «*Moll e ndalueme*» do të përshkruajë me vërtetësi figurën e një punëtori të papunë, tek pështyn përpara reklamave të kinemasë, që nxjerrin një jetë luksoze, e cila është në kontrast aq të madh me jetën e vaj-tueshme të vegjëlisë së varfër. Por qëmonte lart lojën mjeshtërore të artistëve të ekranit, siç ishin: Çarli Caplin, Greta Garbo, Maïta Egert. Fotografitë e ty-re i mbante në album.

Së fundi, pasion tjetër i tij ishte edhe sporti. Notin, që e kishte përvetësuar në Tivar, e ushtronte edhe në Shkodër, kur kthehej pér pushimet verore, qoftë te Ura e Mesit, qoftë në Shirokë. Shkonte të lahej bashkë me shokët. Edhe në liqenin e Prespës, ku e dërgonin me internatistët e tjerë, ai notonte me ëndje.

Në Manastir, Milloshi filloi të ushtronte edhe futbollin. Kur kthehej për pushimet verore në Shkodër, shkonte e luante futboll te Zalli i Kirit. Por, i dobët siç ishte, ai vazhdimisht qortohej nga të motrat dhe të afërmit. Nganjëherë vinte në shtëpi me plagë në këmbë, në gjunjë, në krahë. Kushërima e tij, në shtëpinë e së cilës banonte familja e Milloshit, përkujdesej në mënyrë të veçantë për të: ia pastronte plagën dhe ia lidhte. Për të mos u kujtuar motrat, Milloshi dhe kushërima qeshnin me zë të lartë. Por këtë lojë motrat e kuptionin dhe rendnin në cast ta qortonin vëllanë me gjithë seriozitetin e duhur. Djaloshi i qetësonë duke buzëqeshur:

«— Ani... S'ka gja...»

Në internat, ku ushqimi ishte i barabartë për të gjithë, si për të shëndoshët si për të dobësuarit, Milloshi nuk pati mundësi të vinte shëndet si duhej. Më 1931, mjeku e këshilloi të kalonte një muaj pranë familjes, në mënyrë që ta merrte veten më mirë nën kujdesin e njerëzve të vet. Por në Shkodër, ku i kishin vdekur e éma, i ati, i vëllai dhe gjyshja, kurse motrat ishin shpérndarë ndër të afërmit), Milloshi nuk erdhi. Muajin e kurës e kaloi në Tivar, te motra e madhe. Megjithatë, sportin nuk e ndërpren.

Përveç notit dhe futbollit, ai ushtronte edhe lojën e shahut. Në shtëpinë-muze të tij në Shkodër ruhet një skakievë, me të cilën ai ka luajtur kushti sa herë. Thonë se, kur luante, nuk e lëshonte vetveten në teka nervozizmi, por mbahej i qetë, i qeshur dhe lojën, siç e përmendëm më sipër, e shqëronte me fishkëllimën e lehtë të ndonjë melodie.

Ndonëse i shoqëruar nga shokë, që pinin duhan dhe alkool, ai nuk përdori as cigaren as rakinë. Në seminarin teologjik të Bitoljes (Manastir), kur organizoheshin shoqata kundër pirjes së duhanit, ai dilitte në krye të tyre si një nga më të vendosurit. Por, mbi të gjitha, Milloshi merrej me libra dhe lexonte shumë. Kohën e lirë e kalonte duke lexuar. Shumë fotografi, që na kanë arritur, e tregojnë me libër në dorë. Për moshën e re që kishte ai e fitoi kulturen e gjerë, jo nga shkolla fetare, ku u detyrua të hynte, por nga leximet jashtëshkollore, në gjuhët që përvetësoi.

Gjatë periudhës pesëvjeçare (1928-1932) që ka loi në Seminarin teologjik të Bitoljes (Manastir), Milloshi, përveç hartimeve shkollore, që do të sillnin interes, për të parë fillimet e tij letrare, shkroi edhe artikuj në revistën e seminarit dhe në ndonjë tjetër serbisht, shkroi letra për të afërmit, shokët dhe miqtë, por, mjerisht, këto nuk i kemi në dorë. Kohët e fundit u bë e njohur një vepër inedite, tek e cila do të ndalemi më poshtë. Të shtunave pasdreke letrare, Milloshi lexonte vjershat e veta të para. Në njérën prej tyre, rrëfen një ish-bashkënxënës i tij, shkruante: «*Në ndërgjegjen time ka dy Milloshë: Milloshi i gjallë, i jetës së përditshme, që vepron, gabon, dhe Milloshi tjetër, që i ihet përballë atij, e vëren dhe dënon gabimt e Milloshit real. Te njeriu bëhet vazhdimisht një luftë e brendshme për përsosjen shpirtërore*.»³⁾ Kemi të bëjmë me një nga ato alternativa, me të cilat ai do të trajtojë kontrastet jetësore.

Vjershat i shkruante shqip dhe i sillte pastaj serbokroatisht. Në ndonjérën kujtonte Shqipërinë.

Gjatë kësaj periudhe, brenda dhe jashtë seminariatit, ai u shoqërua me të rinj revolucionarë dhe,

bashkë me ta, erdhi në kontakt me letërsi përparimtare, që ishte e ndaluar nga kleri dhe regjimi reaksionar në fuqi.

Më 22 qershor 1932, Millosh Gjergj Nikolla u largua nga Manastiri dhe vajti në Tivar. Deri më 24 dhjetor të atij viti, domethënë 6 muaj me radhë, që-ndroi atje, pastaj, me 25 dhjetor, u kthye në Shkodër te motra e dytë, me qëllim që të kërkonte nga shteti shqiptar ose bursë për studime të larta letrare ose punë për të jetuar. Në këtë kohë, ndonëse gjithnjë kishte qenë i dobët nga shëndeti, nuk tregohej i lodhur dhe nuk jepte asnje shenje sëmundjeje. Me sa duket, ai e kishte marrë veten dhe kishte nisur të përtérihej.

Dajua i tij fanatik, që i pat nxjerrë bursë për në Seminarin e Bitoljes, ndërhyri nga Podgorica ta dërgonte me bursë në fakultetin teologjik të Oksfordit, me anën e Kishës Autoqefale Shqiptare, ndonëse e dinte shumë mirë se Milloshi nuk donte të merrte në asnje mënyrë rrugën e priftërisë Dhe, me të vërtetë, djaloshi nuk pranoi.

Periudha midis viteve 1923-1932 ishte, pra, shumë e rëndësishme për formimin e tij. Në Shqipëri shpërtheu dhe u thye Revolucioni Demokratiko-Borgjez, iu hapën dyert imperializmave të huaja, kryesisht fashizmit italian. Regjimi monarkik çifligaroborgjez ishte vendosur edhe në Jugosllavi, në dy qytete të të cilët shtet Milloshi kaloi këtë periudhë. Një regjim i tillë i errët monarkik sundonte edhe në vendet e tjera të Ballkanit — Greqi, Bullgari, Rumania, — kurse në Itali erdhi në fuqi fashizmi. Të njëjtat marrëdhënie ekonomiko-shoqërore, që vëreheshin në Shqipëri, vëreheshin edhe në Jugosllavi, ndonë-

se me veçoritë lokale, që dallonin njërin midis tjetrit, në kushtet e caktuara historike.

Milloshi vajti në Tivar dhe në Manastir, i dalë nga rrethana familjare dhe qytetare me karakteristika të veçanta. Gjyshi i tij kishte qenë murator, që, me djersë të ballit, e kishte fituar jetën; i ati, duke kaluar vështirësira të ndryshme, u kap në tregëtizë, për të mbajtur familjen me një tufë fëmijë, por vdiq shpejt dhe e la vatrën e shtëpisë pa mbështetje ekonomike, kështu që Milloshi, nga prejardhja dhe, sidomos, nga përbërja familjare, mbeti një bir i vengjelisë qytetare, ndonëse, nga njerëzit e s'ëmës, në gjëndje më të mirë ekonomike, tërhiqej të bëhej klerik në shërbim të klasave në fuqi. Kur flasim për prejardhjen dhe gjendjen familjare, nuk mund të mos marrim parasysh edhe pozitën e tij shoqërore. Familja e Milloshit bënte pjesë në atë kategorji prej rrith 100 familjesh ortodokse, që jetonin në qytetin e Shkodrës, të ardhura kryesisht nga krahina shqiptare të Malit të Zi, të Dibrës së Madhe, të Strugës dhe të Kosovës. Kjo kategorji familjesh kalonte në procesin e dy palë kundërshtive. Në ato 100 familje ishte një pakicë, që kishte vënë pasuri dhe bënte pjesë në klasat shfrytëzuese, që e përdornin fenë dhe kishën si vegla të zgjedhës lëndore dhe shpirtërore të masës së familjeve të varfëra. Ajo pakicë ushqente iluzione serbomëdha te ortodoksët e tjerë. Përveç kësaj shtypjeje klasore, masa e familjeve të varfëra ortodokse, që përbëhej nga zanatçinj, sheqerxhinj, bakrinxhinj, furrtarë, etj. pësonte edhe pasojat e dallimit fetar, që kishin përpunuar me kohë klasat shfrytëzuese feudale e borgjeze, klerikët reaksionarë dhe pushtuesit e huaj. Përballë shumicës së popullsisë dhe të institucioneve fetare muslimane e katolike,

pakica ortodokse e qytetit të Shkodrës ishte fare e vogël. Milloshi, pra, i ndjeu që në moshë të njomë këto dy palë kundërshti. Është meritë e tij e veçantë që jo vetëm nuk mori anën e parësisë ortodokse — nga mund të prirte ndonjë element — as anën e kultit fetar, as anën e iluzioneve serbomëdha, por, përkundrazi, kundërshtoi kishën si institucion skllavërues dhe klerikët si shërbyes të saj, pikërisht nga pozita e vegjilisë shqiptare, bir të së cilës ai e ndjeu veten që atëherë, në moshë të re. Te djaloshi Millosh u zhvillua jo vetëm ndjenja e shqiptarësisë, por edhe, ndonëse e pakristalizuar sa duhet, ajo shoqërore internacionale. Në Manastir, ky i ri u pritanimë të anojë nga lëvizja shoqërore e mendore revolucionare e kohës, për shumë arësy: objektive e subjektive. Atje u ndesh me një seri kundërshtish: në planin klasor — midis mësave të shfrytëzuara të popullit dhe klasave në fuqi; në planin e kombësive — midis popullsive maqedonase, shqiptare dhe serbe, në kushtet e regjimit monarkik çifligaro-borgjez të kralëve serbë; në planin fetar — midis kishës ekzarkiste, patriarche dhe serbe, pasojat e të cilave shfrytëzoheshin nga fuqitë rivale, për të pasur epërsinë politike dhe ekonomike. Atje u ndesh me një institucion mesjetar, siç ishte seminari teologjik, i ngritur mbi bazën e dogmave fetare dhe skolasticizmit murgar. Përballë ndrydhjes intelektuale dhe shpirtërore që i shkaktonin rregullat e ngurta të seminarit dhe mësimet e tij, Milloshit iu zgjua ndjenja e revoltës, aq sa të bëhej liberal në teologji dhe të kritikonte rreptë përbajtjen mësimore-ekductive të kishës. Aspekt i hapët i kësaj revolte, sa që nxënës, ishte kundërshtimi i tij për të ndjekur rru-gën e priftërisë.

Ndër të gjitha kombësitë e rrethit të Manastirit, kombësia shqiptare ishte ajo, që përndiqej më shumë se të tjerat prej regjimit të kralëve serbë. Edhe në massën e seminaristëve, seminaristët shqiptarë ishin në pakicë të theksuar dhe, me siguri, e ndjenin më shumë se të tjerët shtypjen shpirtërore të mjedisit rrethues. Miloshi do të ketë njohur jo vetëm rivalitetet politike, shoqërore dhe fetare të Manastirit, por edhe traditat atdhetare, demokratikë e revolucionare të aktivistëve të Rilindjes Shqiptare deri në prak të 1912-ës, nga e cila rrethanë historike nuk e ndanin veçse dy dekada. Kështu, në Manastir, ai mori anën e rretheve atdhetare dhe revolucionare të rinisë, rrethe këto të ngritura nga organizata kombëtare të çlirimt, që vepronin në këtë periudhë nënpër qendrat kryesore të Ballkanit. Në vegjelinë punëtore kishte filluar të ndikonte Federata Komuniste Ballkanike. Me vendosjen e regjimit reaksionar të A. Zogut në Shqipëri, u zgjerua fronti i reaksionit në Ballkan. Nëpërmjet këtyre rretheve shoqërore dhe nëpërmjet letërsisë përparimtare i riu Millosh erdhi në kontakt me vepra të njohura letrare aktuale të vendeve perëndimore, me vepra të realizmit socialist dhe me të dhëna për shtetin e parë socialist, që u themelua pas Revolucionit të Totorit, siç do të na e dëshmojnë më vonë disa të njohur të tij. Me këto njohuri erdhi ai në atdhe. Këtë rrethanë njohjeje e favorizoi lëvizja komuniste, e cila, në Shqipëri, gjeti shprehjen në krijimin e grupit të parë dhe të celulave të para komuniste me të rinj revolucionarë si Vasil Shantua, Vojo Kushi, etj. që do të jenë miq e shokë të tij.

Po mbruhej tek ai, pra, krahas revoltës kundër kishës, revolta kundër klasave në fuqi, simpatia për

lëvizjen punëtore e komuniste. Lidhja e miqësisë së ngushtë në seminar me Jordan Misjen, shpjegon pikërisht vazhdën që kishte nisur formimi i botëkuptimit revolucionar te këta dy të rinj, në këtë periudhë, në Manastir.

Sic e pamë më sipër, Milloshin e tërhiqnin më shumë se çdo gjë problemet shoqërore dhe, në mbrojtjen e të drejtave njerëzore, ai shquhej për pasionin e zjarrtë, ndonëse paraqitej nganjëherë me një natyrë të myllur në vetvete. Prirjen drejt lëvizjes së majtë e shkaktoi, së fundi, edhe qenja e tij i varfër dhe jetim që në moshë fare të re, kur, radhazi, i vdiqën e ëma, i ati, i vëllai dhe gjyshja.

Duke kaluar nga Shkodra në Tivar dhe në Manastir, ai e zgjeroi rrezen e të parit, përvetësoi tri gjuhë të huaja, fitoi njoħuri të 'pasura për historinë, letërsinë, etj. Sido që i goditur nga fatkeqësira të mëdha familjare, i varfér dhe i dobët në shëndet, nuk ra në pellgun e misticizmit dhe të idealizmit fetar, nuk i humbi forcat dhe energjitë, por, përkundrazi, shpesh doli më i fuqishëm me dashurinë e madhe për jetën. Atë e interesonte që herët arti letrar, muzikor, kinematografik, teatral dhe sporti. Kjo pasuri shpirtërore, kjo mendje e ekuilibruar, kjo shije e hollë dhe ky talent, që shpejt do të shpërthejë me bujë, përputheshin me atë thjeshtësi të hijshme e simetrike, që karakterizonte veshjen e tij, sjelljet e matura e tërheqëse me shokët e shoqet e rini-së. Të gjitha këto tregojnë për një pjekuri të parakohëshme të intelektit dhe të karakterit, të botëkuptimit dhe të ndërgjegjes kombëtare e shoqërore. Që këtu nis e përftohet zotimi i tij ndaj shoqërisë, që do të shprehet me një art novator. Novatorizmin nuk do ta përcaktojnë vetëm forma a mjetet e reja

të shprehjes, po, në radhë të parë, përbajtja e re ideore dhe tematika shoqërore. Millosh Gjergj Nikolla do të hyjë në letërsinë shqipe, duke thyer të vjetrën, duke ruajtur e çuar më tej çka më të shëndoshë kishte tradicionalja dhe duke përkrahur të renë, revolucionaren, në brendi dhe në formë.

Por tek ai lanë vragë, në këtë periudhë, disa rrethana të pavolitshme. Vajta në Tivar dhe në Manastir e largoi për një kohë ngajeta dhe qëndresa e masave të popullit shqiptar kundër regjimit reaksionar në fuqi, hyrja në seminarin teologjik dhe fatkeqësirat familjare ia ngushtuan dhe ia kufizuan për një kohë notat e revoltës revolucionare, ashtu si leximi i liturgjisë, shërbesat fetare, dogmat e fesë, zgjedha shpirtërore, ndjenja e vëtmisë, shëndeti i dobët. Kështu, deri në atë kohë që kreu seminarin. Milloshi ishte nën presionin e fesë dhe të letërsisë mistike. Vetëm kur do të kthehet në atdhe përfundimisht, do të vijë në kontakt drejtpërdrejt me realitetin shqiptar dhe do të jetë i pavarur nga ai presion. Kundërshtia në formimin e tij shpjegohej pranë kushtet konkrete nëpër të cilat ai kaloi në këtë periudhë të rëndësishme të jetës së vet. Në këtë proces zhvillimi do të mbizotërojë rryma e revoltës revolucionare, kurse shfaqja e rezinjacionit do të pasqyrohet vetëm në disa raste dëshpërimi dhe melankolie.

Në këtë periudhë kemi edhe fillimet e tij letatra, me ato vjersha e proza të shkurtëra në shqip, që na dëshmohen nga ish-bashkënxënës të tij. Dhe, në këtë mes, gjëja më e rëndësishme, që sjell diskutim, është proza e gjatë «*Jeta pa fat*»⁴⁾. Eshtë fjala për një vepër me shumë interes, por të cilën nuk e njohim në origjinal, veçse në përkthim të tretë.

MËSUES NË FSHATIN VRAKË DHE NË QYTETIN E SHKODRËS

Me t'u kthyer në atdhe, Millosh Gjergj Nikolla kërkoi nga shteti shqiptar t'i jepte ose bursë për studime të larta letrare jashtë ose punë për të jetuar. Po vetëm më 27 prill 1933, pasi qëndroi katër muaj pa punë, u emërua mësues në shkollën fillore të fshatit Vrakë.

Në shkresën e Inspektorisë së Arsimit të Shkodrës, datë 26 prill 1933, drejtuar Milloshit po në Shkodër, thuhet: «*Simbas urdhënët të Ministris s'Arësimit, Nr. 115/V, dt. 23-IV-1933, Z. e Juwj emënoheni Zav. Kryemësues në shkollën mikste të Vrakës. Porositeni m'u nisë në kryedetyrës qysh nesër, më 27/IV/1933, tue na njostue për ditëfillimin.*» Në Vrakë shërbeu si mësues që nga 27 prilli 1933 deri në gusht 1935, duke përjashtuar ndërprerjet për pushimet verore ose për lejet shëndetësore. Në shtator 1935 u transferua nga Vraka në qytetin e Shkodrës, pranë shkollës «28 Nëndori», sipas kërkësës së tij, për arsyen ekonomike familjare. Siç do ta themi më poshtë, në Shkodër qëndroi deri më 18 prill 1936, datë në të cilën do të niset për në Pukë. Pra, këto janë tri vitet e para të punës së tij në Shkodër dhe në një fshat të vogël afér këtij qyteti të lindjes.

Në Shqipëri po ndjeheshin nga ditë e më shumë pasojat e krizës ekonomike botërore. Mbizotëronte ekonomia e varfër, që po shkatërrrohej vazhdimisht, për shkak të politikës antikombëtare dhe antipopullore të regjimit zogist dhe për shkak të depërtimit të kapitalit italian. Qeveria shqiptare, gjoja për t'u vënë fre shtrëngesave të qeverisë italiane ndaj saj, mori disa masa demostrative, ndër të cilat qe, në prill 1933, moslejimi i funksionimit të shkollave 'private, të huaja dhe fetare. Në këtë rrethanë Milloshi përfitoi të emërohej mësues i gjuhës shqipe te një shkollë, e cila, deri atëherë, mbahej nga shteti jugosllav. Tensioni, i krijuar brenda viteve 1932-1933 midis qeverisë shqiptare dhe asaj italiane, filloi të zhdukej atëherë kur qeveria shqiptare i bëri koncesione të mëdha kapitalit italian. Në vitet 1933-1934, një varfëri e paparë deri në atë kohë pushtoi gjithë vendin. Në këto kushte u gjallërua lëvizja antizogiste dhe antiimperialiste, demokratike dhe punëtore. Në gusht 1935 shpërtheu Kryengritja e Fierit, që u shtyp me zjarr e hekur. Si pasojë e politikës kapitulluese të regjimit në fuqi, Italia fashiste zuri 'pozita kyçë në fushën e ekonomisë, të arsimit, kulturës dhe ushtrisë, duke përgatitur terrenin e pushtimit të plotë të vendit tonë. Si kudo, edhe në Shkodër, ku u ngul Milloshi, gjendja paraqitej e nderë. Bejlerët dhe agallarët feudalë zotëronin prona të mëdha toke. Të tilla prona kishte edhe kleri, sidomos ai katolik dhe ai musliman. Në kohën e krizës u shtuan fajdexhinjtë gjakpirës, të cilët rriten përqindjet e fajdesë në kurriz të vegjëlisë. Borgjezia krahinore shkodrane grumbulloi kapitale dhe këto filloj t'i investonte qoftë në industri dhe në veprimtaritë financiare e bankare, qoftë në pronat tokësore. Krahas

shtypjes së rëndë që ushtronte rendi i egër policor, mbi masat e punës rëndonte edhe shtypja e klerit reaksionar. Një sistem të tërë, për të nënshtuar masat, kishte ngritur sidomos kleri katolik me «shekullarët», «urdhërat» e fretërvë dhe të jezuitëve, me morinë e kishave, shkollave, seminareve, shoqërise, organeve të shtypit, etj. Regjimi dhe kleri ushtronin një censurë të rreptë kundër njerëzve përparimtarë, ideve dhe lëvizjeve emancipuese, duke nxitur me çdo mjet ideologjinë fashiste. Për më tepër, në Shkodër vepronin konsullatat italiane dhe jugosllave — çerdhe të rrezikshme agitacioni, propagande dhe komplotesh kundër kombit dhe popullit shqiptar. Figura e beat feudal, e agait fajdexhi, e reshperit shtijnjak, e bajraktarit kapadai, e xhandarit nursëz, e memurit anadollak, formonte një kategori të tërë përfaqësuesish të klasave e të shtresave të 'privilegjuara bashkë me figurën e priftit hipokrit, të hoxhës injorant dhe të popit të zvetënuar. Gjithë kjo kategori syfetesh të urryera kontrastonte thellë me figurën e punëtorit të papunë, të cirakut të ftikur, të lypësit të leckosur, të fshatarit të robëtar; me imazhin e masave, të cilat detyroheshin të çonin një jetë të amullt varfërie, paditurie, errësire dhe pasigurie për të nesërmen. Punëtorët e zënë me punë në ato pak fabrika dhe punishte, që ekzistonin, rropateshin deri 12 orë në ditë me një pagë fare të vogël. Kushtet e tyre të punës ishin të vajtueshme. Si pasojë e rrénimit të ekonomisë fshatare nga kriза e gjatë bujqësore, u përhap zia e bukës. Më 1935, kjo arriti përpjestime të mëdha, krahas papunësisë. Gra dhe burra, fëmijë dhe pleq, të zbatuhur dhe të zhveshur, grumbulloheshin te dyert e institucioneve shtetërore, për të kërkuar punë dhe misër. Të urit

turit dhe lypësit endeshin rrugëve të shkretuara e të zymta nga avllitë e larta, tamam porsi hije të marrakotura, duke shtrirë dorën për një kothere bukë. Zu të shfaqej haptazi 'plaga e zezë e prostitucionit. Fshatarët nga fushat dhe malet rendnin në qytet për të shitur krahu e punës ose prodhimin e vogël me një çmim të papërfillshëm. Përveç fshatarësisë, varfëria preku edhe shtresat e gjera qytetare — zanatçinjtë, tregtarët e vegjël dhe nëpunësit e kategorisë së ulët. Ndaj këtij sistemi të egër shtypjeje dhe shfrytëzimi ziente pakënaqësia e masave, grumbulloheshin urejtja dhe revolta si llavë vullkani, gati për të shpërthyer. Në Shkodër, ku kishte një farë tradite lëvizja punëtore spontane, kishin nisur të përhapeshin idetë socialiste, ndonëse jo të kristalizuarë mirë. Përmes rrugëve të ndryshme klandestine, komunistët dhe njerëzit patriotë shtinin në dorë organet e shtypit dhe botimet e tjera antizogiste të mërgimit politik shqiptar të Austrisë, Francës, etj., siç ishin fletorja «Liria Kombëtare», broshurat «Nga triumfi i legalitetit në revolucionin popullor», «Shpëtimi i fshatarëve», etj.; ata shfrytëzonin edhe shtypin e huaj me prirje të majtë, literaturën demokratike që, herë pas here, i shpëtonte censurës së regjimit dhe të klerit. Pikërisht në këto rrëthana u themeluan në Shkodër celulat e para komuniste, të përbëra nga nxënës gjimnazi dhe çirakë pazari. Të rintë komunistë, në vitet 1935-1936, shtinë në dorë drejtimin e shoqërisë «Besa shqiptare» dhe i vunë vetes për qëllim ta shkëputnin rininë nga ndikimi i regjimit dhe i institucioneve obskurantiste fetare, të organizonin aktivitete masive kulturore-artistike, të përhapnin ide socialiste; ata shfaqën pjesë teatrale dhe u përgatitën të botonin një të përkohshme me

titullin kuptimplotë «Shkëndija», në përfytyrimin e «Iskras»-s leniniste, por autoritetet e vendit, në bashkëveprim me klerin, nuk i lejuan. Në këto aktivitete milituan të rintjtë Qemal Stafa, Jordan Misja, etj. Kjo ishte atmosfera e Shkodrës, në të cilën filloj veprimtarinë si mësues dhe letrar revolucionar Millosh Gjergj Nikolla, i njohur tani e tutje me pseudonimin Migjeni.

Të rintjtë përparimtarë zunë ta njihnin Milloshin nëpërmjet shkrimeve të tij dhe nëpërmjet shokëvë, që ishin farë e fis me të, ndonjëri prej të cilëve bënte pjesë në celulat e porsangritura komuniste. Milloshi nuk hyri në asnjërën prej këtyre celulave dhe as, më vonë, në grupet komuniste, por mbajti lidhje me anë të literaturës revolucionare që shkëmbente me ta. Edhe pasi u kthyen në atdhe, ai vazhdoi ta ndiqte këtë literaturë. Dëshmi është përbledhja «Proza e re ruse», përkthyer nga rusishtja në serbo-kroatishët më 1933, botuar prej «Nolit», tek e cila përfshiheshin tregime dhe skica të shkrimittarëve sovjetikë: M.Gorki, A.Tolstoj, V.Ivanov, K.Fedin, etj. Në radhën e librave, që na kanë mbetur prej tij, është edhe «Noçista krv» (Gjaku i papastër), roman dokesh e zakonesh shoqërore i Borisav Stankoviqit. Këtë vepër ai do ta kërkojë më vonë, më 14 mars 1938, nga Torinua, për ta lexuar sérishmi në vetminë e spitalit. Në radhën e librave gjinden gjithashtu: «Kako se hranimo» (Si ushqehemi) e Ivan Bajës, botuar më 1935, «Demi për brinjësh», polemikë e Pikës me klerin, botuar në Korçë, po atë vit. Te kjo vepër e fundit, Migjeni ka shënuar me laps, në anën e sprasme të mbulojës: «*Hik! Hik, moj flutur, se do të digjesh!* *Hik! Se ke me ra në gyp të llampës dhe në flakën e saj ke m'u djegë.* Por flutura s'dëgjon, si-

llet. Sillet e sillet. Dhe, m'atë të sjellun, shkrepet për gyp, largohet, shkrepet, rrrotullohet rrreth llampës dhetë herë për m'u shkrepë...» Më poshtë, po aty, poeti shënon:

*O si nuk kam një grusht të fortë
t'i bij në zemër malit qi s'bzan
Unë — lugat! Si hije...*

Dihet se kjo strofë u përpunua më vonë dhe, që andej, doli vjersha «Recital» i Malsorit», botuar pas vajtjes së tij në Pukë. Me sa duket, Migjeni lexoit në këtë kohë edhe disa broshura, që qarkullonin dorë më dorë te anëtarët e celulave komuniste, siç ishin: «Zhvillimi ekonomik», «Vlera dhe mbivlera», «Mbi zhvillimin e shoqërisë», etj. Në fillim, kur u ngul në Shkodër, ai qëndroi thuajse i myllur në shtëpi dhe nuk u ekspozua shumë. Shkonte për vizitë te njerëzit e afërm, që i kishte farë e fis, dhe nuk përzuhej fort me të panjohurit. Më vonë, kur zuri punë si mësues në Vrakë, u njoh me një rrëth të ngushtë kolegësh. Dhe të gjithë i bëri për vete me dijenitë që kishte rrëth gjendjes shoqërore të kohës. Një nga të njohurit e parë të Migjenit në Shkodër, mësuesi dhe letrari Teufik Gjyli, rrëfen:

«Kishte njohuri për revolucionin e madh rus, për ndërttonjësit dhe për jetën e re, që po krijohej në Bashkimin Sovjetik. Qysh se erdhi këtu, u duk se kishte qenë i paisun me këto njoftime. Po, për të vërtetue çka u tha ma sipër, rrëfej se një ditë, tek qëndrojshim vetëm për vetëm në klasë, e pyeta diçka rrëth mësimit të gjeografisë. Në atë kohë, mësimi i gjeografisë, përsa i përkiste Bashkimit Sovjetik, kufizohej vetëm me pjesën fizike. Për ndërtimin

e tij shoqënuer dhe ekonomik nuk u folte veçse fare pak. Milloshi, atëherë, tue iu përgjegjë pyetjes sime, më tregoi mbi transformimin rranjësuer nga ajo, që kish qenë ma parë në Bashkimin Sovjetik. Më tregoi për fabrikat e ndryshimin e tynë dhe mbi gjendjen e punëtorëve, më foli për elektrifikimin e vendit, mbi kolkozet e sovkozet, dhe për SMT-të.

Një rol të mirë, për ta mbajtur Milloshin afër me idetë socialiste, luajti një nga ish anëtarët e shqërisë «Bashkimit» të A. Rustemit, që ishte mërguar në Bashkimin Sovjetik dhe që do të njihej në shtypin demokratik me pseudonimin «Harbuti».

Vraka është një fshat dy orë larg Shkodrës. Atje lulëzon një kooperativë e përparuar bujqësore dhe s'ka mbetur gjurmë e së kaluarës, përvèç një kasolleje me kashtë, e lënë qëllimi si simbol i një bote të përenduar. Por, në atë kohë, banorët e këtij fshati, të shpërngulur nga disa vise të Malit të Zi rreth vitit 1870 dhe të ngulur këtu për të nxjerrë jetesën, kishin të njëjtat kushte të fshatarësisë së vendit, që shtypej dhe shfrytëzohej nga rendi çifligaro-borgjez, me ato toka të copëzuara prej gardhiqesh dhe të punuara me mjete primitive, me ato kasolle varfanjake, me ato bestytni, sëmundje dhe mungesa të mëdha. Shkolla e vogël fillore, ku deri atëherë jepeshin mësimet serbokroatisht, ishte e vendosur pranë një kiske ortodokse, të cilën e mbante kleri në bashkëpunim me Konsullatën Jugosllave. Kjo bëri çmos ta bindte Milloshin që të kthehej sérishmi në Jugosllavi dhe të shërbente si prift në Banat ose të studjonte teologji në Beograd. Milloshi nuk pranoi dhe iu vu punës në shkollë. Veprimi i tij zemëroi kishën dhe konsullatën, të cilat, me çdo mjet, kërkuan ta sabetonin punën e tij si mësues shqiptar. Në fillim,

të mashtruar nga kleri, fshatarët i krijuan shumë vështirësi Milloshit. Duke spekuluar në ndjenjat e tyre fetare, me qëllim që ta diskreditonin si mësues, kisha dhe konsullata shpifën se gjoja njëherë Milloshi paskësh hequr nga muri ikonën e «Shën Savës», «protektorit» të shkollave serbe, dhe e paskësh shkelur me këmbë në sy të nxënësve! Milloshi nuk bëri gjeste të tilla, por e filloi punën si mësues patriot dhe demokrat, duke i afruar nxënësit dhe duke u hyrë në zemër bujqve të varfër.

Disa dokumenta⁵) që kemi në dorë na ndriçojnë, sadopak, punën e tij si mësues. Në shkresën me datë 6 qershor 1933, drejtuar prej tij Inspektorisë së arsimit në Shkodër, thuhet se ai kishte arritur të formonte «Këshillin shkolluer të Vrakës». Me shkresën e datës 20 korrik 1933, ai njofton Inspektorinë për gjëndjen e lokalit të shkollës: ndërtesa ishte një shtëpi private me pesë dhoma për mësim, një dhomëzë për drejtori dhe me dy të tjera në dispozicion. Të nesërmen, më 21 korrik, ai përcjell listat emërore të fëmijëve nga gjashtë deri në trembëdhjetëvjeçarë për vitin e ardhshëm shkollor. Më 6 qershor 1934, paraqet një lutje, por përbajtjen e saj nuk e dimë. Më 10 qershor kuptojmë se ai është paraqitur në detyrë pas një leje të gjatë, që i ishte dhënë, me sa duket, për arsyen shëndetësore. Një vlerësim të mirë të punës së tij si mësues i bën proces-verbal, i lënë nga Inspektoria e arsimit, më 18 qershor 1935, ku thuhet se Milloshi kishte mbajtur në rregull dokumentacionin e shkollës dhe se kishte përballuar me aftesi vështirësitet që kishin nxënësit në përparim, pasi, një pjesë e tyre, përdornin për të parën herë gjuhën shqipe në mësim.

Në fshatin Vrakë, Milloshi njozu, për të parën

herë, jetën e zymtë dhe revoltuese të fshatarësisë me të gjitha brengat dhe dëshirat. Kushtet e punës ishin të pavolitshme. Vrakaçorët nuk patën mundësi ta mbanin ndër kasollet e tyre dhe ai u detyrua të bënte 14 km. rrugë të pashtuar, mbi një biçikletë të marrë me qira, ditë për ditë, mëngjezit e mbrëmjes, si në vapë, si në të ftohtë. Shëndeti iu dëmtua rëndë. U sëmur në mënyrë të pashërueshme nga ftizia, e cila do ta çojë në varr në lulen e rinisë. Në këto rrethana, krijimtaria e tij pasqyron kushtet e fshatit dhe gjendjen e tij të vështirë. Në njérën nga dy letrat e dërguara nga Vraka në Shkodër mikut të vet Teufik Gjyli, Migjeni bën fjalë për rrezikun e komprometimit, që i kërcenohej në mjedisin shoqëror ku jetonte. Dhe shkruante me ironi: «*Mos ec si ta do natyra, por ec si duhet, mos të komprometohesh; mos fol si do natyra, por fol si duhet, mos të komprometohesh; mos u sjell si ta do temperamenti, por sjelli si duhet, mos të komprometohesh; mos u shpreh kurrë më sinqeritet, por me rezervë, mos të komprometohesh dhe kështu gjith jeta e njeriut, ndër imitacione, pra, shumë thonë se njeriu nuk rrjedh prej majmunit, që të imitojë kaq shumë.*» Kështu shkruante Migjeni në Vrakë, më 14 prill 1934, pas një viti e pak muajsh, që ishte kthyer në atdhe. Në letrën e dytë, botuar nën titullin «Të fala nga fshati», porsi një simbol-credo, ai dëshmon se qysh, rrugëve të jetës, ende s'ka gjetur një orientim të quartë plotësisht, se qysh nuk është i kënaqur dhe vuan «*me bujkun, që lufton me tokë... me punëtorin të cilin hekuri e ndrydh... me të sëmundët e të gjitha sëmundjeve të krejt botës*». Atë s'e ka rrëmbyer pesimizmi, por pezmatimi për shoqërinë, që shtypet dhe shfrytëzohet. Që atëherë, Migjeni dallon

kundërshtitë, që ndanin klasat e varfëra nga të pasurat, të dobëtit pa pushtet nga të fuqishmit me pushtet, të vënë ballë për ballë njëra 'palë kundër tjetrës. Mban qëndrim ironik ndaj fesë, rreh të fiksojë imtësitë më karakteristike të njerëzve dhe të ambienteve me një thellësi vëzhgimi, me një sintezë ndjenjash e mendimesh, që të rrëmben, zotohet si shkrimtar para shoqërisë të denoncojë «sëmundjen epidemike» (të shoqërisë, V.B.) *bashkë me shkaktarin e saj*, pasi fshati është «në mosmarrëveshje të plotë me qiellin (rendin në fuqi V.B.). Prandaj do të donte dritë nga një diell tjetër për botën, që është zhytur në errësirë (kujtojmë diellin alegorik të vjershës «Këngët e pakënduara»). Por, te Migjeni, në këtë kohë, ne shohim edhe mëdyshje, që nga admirimi i stilit të A. Shopenhauerit deri te iluzioni në një «mbinjeri», i cili, megjithatë, nuk është i përcaktuar në kuptimin thellësisht reaksionar, siç e ka filozofi gjerman i kultit të mbinjeriut, F. Niçe. Kjo letër u botua te «Yllyria», më 1 korrik 1934. Ndoshëta asnjë nga shkrimtarët e Shkodrës nuk e ka paraqitur këtë qytet të lindjes me kaq zjarr dhe vërtetësi, me penelata kaq të forta në kushtet e viteve '30: «*Tue ndjekë shetinë, marr drejtimin kah jugu, kah një largësi 7-8 km. shof Shkodrën, të mbësh-tjellun në një tym të kaltër. Sa dëshira të flakta ushqej për këtë qytet! Dëshirat e mia janë shumë-shumë ma të singerta e ma të mëdha se dëshirat që pat prëndia kur krijoj botën, Shkodra, Shkodra, dashunorja e qiellit të kaltër! Shkodra, Shkodra, dashunorja e maleve të hqëdhta, e lumenjve të cemptë, e ligonet andërtar, në të cilin në mëngjeze të kulluet — lanë hijen e vërt, Shkodra — një atitudë shprehjeje... një fjalë, e cila përmban gjithë nostalqjinë*

e ditëve të fikuna. Këtu, në këtë largësi, ndjej damarët e saj, që rrahin e rrahin... edhe, sikur mjeku, që tharton fytyrën, kur shef se pacienti i tij ka ethë, — q'ashtu dhe unë pezmatohem n'hidhni, tue pa se pulsi i dashnores sime nuk rreh si duhet. Rreh dy herë-një herë-pesë herë-dy herë-tetë herë-dhetë herë-tridhetë herë në sekund! Pushon përsëri: një herë-katër herë-gjysmë herë! — Tue rreshtue këto të rrahuna, fshana, pse nuk jam një pontifex maximus, një papë ose një patrik, të hudhi mallkimin e plotë, t'anatemizoj sëmundjen epidemike bashkë me shkaktarin e saj?» Ka rëndesi të vërehet se, që kur u kthye në atdhe, Migjeni mori anën demokratike të mendimit shqiptar të kohës dhe u shfaq si një shkrimitar i ri, i zotuar për shoqerinë. Me formimin e tij ideologjik dhe kulturor, nga pozita të avancuara shoqërore, që në këto dy letra dhe skicat e vjershat e para, Migjeni kapet pas tematikës shoqërore në kontrastet më shprehëse që ia sugjeronte ndarja e shoqërisë në klasa antagonistë. Derisa nuk doli ndonjë organ shtypi përparimtar, ai u detyrua t'i bontonte shkrimet e veta te të përkohshmet zyrtare, por duke përjashtuar këtu ato të klerit, në të cilat nuk pranoi kurrsesi të bashkëpunonte. Në vitet 1934-1935, brenda dhe jashtë Shqipërisë dilnin disa organe-fletore dhe të përkohshme. Në mënyrë më të hapur ose të maskuar, me nuanca të ndryshme sipas rastit, me përjashtim të fletores «Liria Kombëtare», që mbante një qëndrim të prerë antizogist dhe antiimperialist si organ i Komitetit të Çlirimt National (KÇN), i udhëhequr nga demokratë revolucionarë, si dhe, deri diku, «Rilindja», të gjitha të tjera, fletore e të përkohshme, ndiqnin politikën dhe ideologjinë e rendit në fuqi. Në pozita të theksuara

reaksionare qëndronin organet e qarqeve qeveritare («Besa», etj.), dhe ato fetare («Zani i naltë» i klerit musliman, «Leka» i urdhërit Jezuit dhe «Hylli i Dritës» i urdhërit françeskan). Këto luftonin me ashpërsi çdo lëvizje mendore përparimtare, veçanërisht lëvizjen punëtore dhe ideologjinë e saj, i bënин elozi regjimit zogist dhe filozofisë idealiste, përhapnë rrymat më reaksionare dhe konservatore të mendimit borgjez. Në to dhe në «Illyria», «Arbëria», «Minerva», etj. zu të përhapej edhe ideologjia e hapët fashiste, filozofia e kultit të mbinjeriut e F. Nicës, pozitivizmi i O. Komtit, psikoanaliza e Frojdit, etj. Në rrëthanën e censurës zogiste, me vështirësi depërtonin në shtyp mendimet përparimtare materialiste, demokratike, dhe shkrimtarët përparimtarë detyroheshin të përdornin alegorinë më të hollë përtë botuar shkrimet e veta. Millosh Gjergj Nikolla ishte njëri nga këta shkrimtarë të rinj. Që në skicën e parë ai nuk doli me emër të vërtetë, por me pseudonimin *Migjeni*, të përbërë nga bashkimi i rrokjes së parë të emrit të vet, emrit të babait dhe emrit të gjyshit. Shkrimet e para i botoi në «Illyria». Teky organ ai nxori, radhazi, më 1934, më 1935 dhe në fillimin e vitit 1936, prozat *Sokrat i vuejtun apo derr i kënaqun*, *Alternativë: Ose... Ose..., Tragjedi apo komëdi*, Të fala nga fshati, *Një refren i qytetit tim, A do qymyr, zotni?* Në kishë, Ngjarje pa lëvizje, Vetëvrasja e trumcakut, Luli i vocërr dhe vjershat *Shpirtnat shtegtarë*, Të lindet njeriu, Zgjimi, Shkëndija, Kanga e rinisë, Melodi e këputun, kurse te dy të përkohshme të tjera («Minerva», «Jeta dhe Kultura») prozat *Novelë mbi krizë*, *Moll' e ndalueme* dhe vjershat *Kanga e prendimit* dhe *Plaga*. Deri në fund të vitit 1935, ai kishte gati vëllimin «Vargjet

e lira» më 35 vjersha, duke përfshirë edhe *Poemën e mjerimit*. Duket sheshit puna e dendur krijuese në të dyja gjinitë njëkohësisht, sidomos në poezi, megjithë shërbimin e rëndë që kryente si mësues në kushte të papërshtashme dhe megjithë sëmundjen e ftizisë, që iu shfaq tanë haptazi. Në verë të vitit 1935 iu këshillua të kurohej në ndonjë sanatorium. Me kursime të mëdha ia doli të grumbullonte të holla për t'u nisur jashtë shtetit. Konsullata Juggosllave, që e mori me sy të keq, nuk ia lëshoi vizën për në Gollnik. Atëherë, me të mbaruar viti shkollor, ai mori vizën për në Greqi. Por, pa u mbushur muaji, u detyrua të kthehej nga Athina në atdhe, sepse nuk pati mundësi t'i përballonte shpenzimet për një kurë të plotë.

Dalja e Migjenit në arenën letrare qe një ngjarje me rëndësi për letërsinë demokratike, që i kundërvihet letërsisë klerikale dhe borgjeze dekadente. Duke kapërcyer ndonjë luhatje dhe paqartësi, ai e kishte përcaktuar lidhjen e vet me çështjen e popullit, të demokracisë dhe të përparimit. Ai ishte i ndërgjegjshëm për artin e vet dhe kishte një kuptim mjaft të përparuar mbi burimin dhe misionin e artit në shoqëri. Pikpamjet mbi artin iu formuan në bazë të rr Ethanave, që e frymëzuan, dhe të shkallës së njohjes ideoestetike. Këto pikpamje zbulohen në disa kënde: në veprën e tij, në shënimet ose nënvizimet e librave të lexuara, në dëshmitë që sjellin miqtë dhe shokët e tij. Në radhë të parë, ai e shikonte artin si mjet për pasqyrimin e jetës, të shoqërisë, si një nga format e ndërgjegjes shoqërore. Arti, sipas tij, ka karakter shoqëror dhe i shërben një klase të caktuar në shoqërinë e ndarë me klasa antagonistë. Në të vërtetë, në thelb të krijimta-

risë së tij qëndron antagonizmi shoqëror, që përcakton mohimin dhe pohimin, antitezën si mjet kryesor figurativ të shprehjes poetike. Në kundërshtim me klasicizmin arkaik dhe me romantizmin lëngues, që idealizonin të kaluarën, ose me manierizmin dhe imitimin në mënyrë formale të folklorit, që idilizonin jetën e vajtueshme të popullit, — rryma këto që përcaktonin vjershërinë zyrtare të kohës, — Migjeni përqafoi metodën e realizmit si drejtimin më të drejtë letrar për të pasqyruar jetën e popullit, për të mbrojtur masat e gjera, për të shprehur brengat, revoltën dhe aspiratat e tyre demokratike. Ky koncept për rolin e letërsisë është thënë qartë prej tij në vjershën *Kanga e dhimbës krenare*. Me këtë titull poeti karakterizon krijimtarinë e vet, të frymëzuar, që në fillim, nga gjendja reale e shtresave të gjera në atë kohë. Poeti i kishte vënë vetes si qëllim të denonconte pa mëshirë pabarazinë në shoqëri dhe kushtet çnjerëzore, në të cilat rronte populli shqiptar, të stigmatizonte shkaktarët e tragedisë kombëtare — sundimtarët dhe shfrytëzuesit feudalo-borgjezë, fenë dhe klerin reaksionar në shërbim të tyre, fashizmin, që po fuste kthethrat në Shqipëri dhe në vendet fqinjë, etj., të ndillte e të paralajméronte revolucionin popullor për një jetë më të mirë njerëzore.

Në përmbledhjen që i bëri rusisht veprës: *Zakoni dhe arti i revolucionit francez*, Migjeni shkruante: «Arti... është një nga shfaqjet e ndërgjegjes shoqërore... Në art, ligjet dhe psikologjia e luftës së klasave shfaqen po aq qartë sa edhe në fushat e tjera të ndërgjegjes shoqërore... Arti përherë është mbartësi i ideve dhe pasqyrë e jetës së kësaj ose asaj klase shoqërore, pasqyrimi i luftës së këtyre ose

atyre klasave, dhe kjo është plotësisht e natyrshme, sepse artisti, si qenje e gjallë, që zhvillohet e ndryshohet, ushqehet me ushqim «shpirtëror» të atmosferës psihike, që e rrethon... Dhe ja, si të jetë kjo atmosferë psihike e ky ushqim, po ashtu është edhe pinjolli i saj — njeriu, artisti... Përgjithësisht, arti i Revolucionit të madh, në të gjitha degët e veta, ishte shok dhe bashkëudhëtar besnik i përpjekjzve, i ideve dhe i veprave të klasave të kohës së vet. Arti është një nga format e ndërgjegjes shoqërore dhe, si i tillë, ai është i lidhur në mënyrë organike, plekset në mënyrë organike me fushën politike të ndërgjegjes shoqërore». Te vepra e F. Shilerit «Vilhelm Teli», ai ka nënvizuar shprehje të tilla, që vlejnë për të njohur botëkuptimin e tij:

Më kullon shpirti gjak për tëndin popull;
po vuaj un' me të, kaq fort e dua
për urtësin' dhe trimërin' e tij...

Kudo ka mjerime...
Dhe vetë malet zunë e tunden? S'paska
asgjë të palëkundshme mbi dhe...
... lufta 'sht, kush do jetë zot
i këtij vendi, bujku apo kaizeri?

Sipas dëshmisë së mjaft shokëve të tij, ai, që në fillim, kishte synuar një qëllim të caktuar me krimtarinë e vet. Kështu, për këngët, që prinin vëllimin — *Këngët e Ringjalljes* dhe *Parathanja e parathanjeve* — ai thoshte se me këto donte t'i këndonte zgjimit kombëtar, përpjekjeve të popullit për çlirim në formën e një programi poetik për lëvizjen e emancipimit shoqëror. Ai shënonte se vepra e

tij kishte karakter luftarak, por, për kushtet e vëçanta që kalonte vendi, i duhej të manovronte. Vërejtjes, që i bëhej lidhur me karakterin e errët të disa vjershave të tij, i përgjigjej duke thënë se vjershat e qarta do të ndriçonin të errtat. Vetëdijen e rrezikut, që do t'i sillte krijimtaria revolucionare, e shfaqte duke thënë se dy armiq konkurronin t'i ofronin qefinin e vdekjes: qeveria zogistë dhe tuberkulozi. Por kishte edhe besim në të ardhshmen, se vegimet do t'ia verifikonte zhvillimi i mëvonshëm i ngjarjeve.

Si u tha më sipër, deri në mbarimin e vitit 1935, ai kishte përfunduar vëllimin «Vargjet e lira» dhe, gjatë dy viteve të fundit, me sa dimë, shkroi vetëm 6-8 poezi e, ndoshta, ndonjë tjetër, që nuk e njohim, por me një karakter më vetjak dhe jo në nivelin e poezeve të para madhore. Kjo do të thotë se poeti thuajse e mylli krijimtarinë poetike që më 1935 dhe vazhdoi të shkruante në prozë. Duke kaluar nga skicat në novelat, ka shumë të ngjarë që, po të jetonte më, do të kishte arritur te llojet më të gjata të kësaj gjинie, me një pjekuri më të madhe. Por, edhe në këtë, ai mbeti kryesisht poet. Në qoftë se, siç thoshte vetë, poezitë e qarta vlejnë për të sqa-ruar të errëtat, atëherë mund të shtohet mendimi se edhe prozat e tij shërbejnë për të sqa-ruar poezi-të. Marrë në përgjithësi, gjithë krijimtaria e Migjenit, që, për shkakun e jetës së tij të shkurtër, nuk është voluminoze, mbeti një e tërë, e lidhur në unitet organik, jo vetëm si gjini, por edhe si ide e tematikë, si përbajtje e formë, si metodë e stil. Jetën dhe veprimtarinë e Migjenit, që në vitet e para të nguljesh përfundimtare në atdhe, për vetë qenjen e tij si njeri dhe si artist, sidomos për karakterin e

krijimtarisë së tij, duhet t'i lidhim me lëvizjen antizogiste dhe antiimperialiste, veçanërisht me lëvizjen punëtore dhe komuniste në atdhe. Nga poezitë e para të një romantizmi revolucionar, nga prozat e para të një karakteri filozofik, por jo pa ndonjë pështjellim ideor, Migjeni kaloi në trajtimin e një brendie të thellë shoqërore në poezi dhe, veçanërisht, në proza të fuqishme realiste kritike, në një qartësi më të madhe ideore dhe në një mjeshtëri më të shkathët figurative stilistikore. Ai erdhë kështu duke u ngritur vazhdimesh në artin poetik, krahas rritjes së lëvizjes punëtore dhe demokratike në Shqipëri, pavarësisht nga dobësitë objektive dhe subjektive.

Për plotësimin e portretit të tij në këtë periudhë prej tri vitesh (1933-1935), përveç veprés së tij, shërbejnë mjaft dëshmi të shokëve dhe të të afërmve. Një motër e tij shkruan:

«Unë nuk mund ta harroj kurrë atë qoshen në dhomën e motrës në Shkodër, më 1933-34, ku Milloshi, të djelave ose kur kthehej nga shkolla e Vrakës, ulej dhe lexonte e lexonte vazhdimesh, pa u shqetësuar fare nga zanet e fëmijëve, që shkonin e vinin nëpër dhomë. Lexonte me rëmendje të madhe dhe kishte zakon të nënvizonte fjalët që i bannin përshtypje, fjalët që kishin një kuptim të thellë ose ato që s'i njifte. Shumë libra, nga ato që nakanë mbetë, e dëshmojnë këtë».

Ajo tregon edhe për disa anë të tjera të figurës së poetit në këtë periudhë: «Milloshi nuk fliste shumë dhe jiptë përshtypjen e një djali të myllun; por, kur binte fjala midis shokëve për ndonjë temë interesante, mbi të cilën ai kishte njoftime të sigurta, zberthente një bisedë të zjarrtë. Në këto bi-

seda, ai ka qenë kurdoherë i sinqertë, por nuk i mungonte ironia kundër njerëzve, që mbronin me këmbëngulje pikpamje të gabuara... Shitet jet i pël-qenin shumë, sidomos shëtitjet në natyrë, jashtë qytetit, në shoqëni, por edhe vetëm. Kënaqej kur shihte pemët në lulëzim, kur shihte bagëtitë në kullotë ose njerëzit në lëvizje e në punë... Shokët e tij e kanë dashur Milloshin për frymën e tij socialiste dhe për ndihmën që ishte gati t'u jipte atyne».⁶⁾

Si u tha më sipër, Milloshi në fillim u shoqërua me pak njerëz, me ndonjë kushëri a të afërm, më vonë me mësuesin e fillorës dhe letrarin Teufik Gjyli, me mësuesin e gjimnazit Skënder Luarasi, me Vojo Kushin dhe Jordan Misjen, me militantin revolucionar Selim Shpuza, po edhe me të birin e konsullit jugosllav në Shkodër Bozhiq. «Një ditë — shkruan Skënder Luarasi — i biri i konsullit erdhi fshehurazi në shtëpinë e Milloshit dhe i tha:

— Babaj më ka dhënë urdhër të mos shëtisë e të mos flas me ty, por unë të dua si vëlla. Më fal!

E, kur piqeshin udhës, në drejtëm të kundërt, djaloshi serb e shikonte me bisht të syrit dhe ulte kryet i turpëruar...»

Ishte koha kur Milloshit iu shfaq për të parën herë sëmundja e ftizisë. Luarasi shkruan për këtë: «... Kur qe arësimtar në Vrakë, — Milloshi, gjatë një shiu të rreptë, u lag, u bë quall dhe u plevitos. Pas ca kohe, një ditë erdhi në shtëpi i shqetësuar dhe i tha dajeshës:

— Jam i sëmurë, jam shumë i sëmurë; kam pështyrë gjak! Mbajini larg mëje fëmijët! Mos më jepni në një enë me të tjerët!»

«Ishte nga fundi i vitit 1933 — dëshmon Teufik Gjyli — kur e takova për herë të parë. Takimi

me tē mē la një përshtypje tē thellë. Në këtë kohë, Migjeni ende s'i kishte plotësuar tē njëzet e tre vjetët. Qe një djalë i ri, i hijshëm, me një trup tē drejtë, i pastër në veshje dhe ma i pastër në shpirt. Më bisedat e para ta fitonte zemrën e tē bante përvete. Në fytyrë tē dukej gjithnjë i thithun dhe i përhjekun. Kur tē shtrëngonte dorën — e kjo ndodhi do kohë më vonë — dora e tij tē ipte një nxehësi. Ishin shenjat e para tē sëmundjes, që kishte fillue me ia bre mushkënité».?)

Për mënyrën si éshtë frymëzuar Migjeni ngajeta e përditshme, shoku i tij rrëfen: «Migjeni i pa me sytë e vet ngjarjet, tē cilave u kushtoi radhët dhe vargjet e tij. Ai vrente sendet, që i kalonin para syve. I vrente gjatë e me kujdes tē madh. Pastaj mendonte. E, atëherë, shkruante. Më kujtohet, si tash, një ditë kur po shetisnim bashkë me tē, në një nga rrugët ma kryesore tē qytetit.

Migjeni shikoi një lypës, tuz trokllue te një derë, dhe u ndal:

- Ç'ke? — e pyeta — Përse ndalon kështu?
- Prit pak! — m'u përgjegj — Shiko!
- E çfarë tē shikoj. Një lypës. Lypës tē shkretë ka mjaft sot...
- Vre pak edhe anën tjetër! — ma këputi shkurt e shkurt, pa ia nda sytë lypësit.

E ç'anë tē vrejshe? Megjithatë, shikova: ana tjetër ishte një portë e madhe, e bukur, e skalitun me daltë. Një dyqan plot e përplot me mall u gjindte përbri. I mbështetun për një tryezë tē lëmuet, qëndronte i zoti me disa letra përpara. Bante hesap ndoshta fitimet e ditës e nuk vështronë andej nga rruga. Sipër, ishte shtëpia. Një zojë, e veshun mi-rë dhe e lyemz në fytyrë, hapi dritaren, që ishte mbi portë.

— Zoti të dhashtë! — i tha lypësit me neveri e tue përdredhë buzët. Pastaj, mbylli dritaren dhe u zhduk. Lypësi u nis. E shikojsha nga larg kah u binte portave dhe ecte gjithnjë. Por Migjeni e vrente. E vrente me kujdesin ma të madh dhe pa folë asnje fjalë udhës. E ashtu e ndoq më sy derisa lypësi u kthye në një rrugë tjetër. Atëherë Migjeni më tha:

— Vune ore ndonjë gja të jashtëzakonshme?

— Strajcën bosh — iu përgjegja.

— Jo, — më tha, tue shikue thellësinë e rrugës më ata sy të zez që, në atë çast, i qitshin flakë

— Strajca e tij u mbush plot e përplot.

— Me se? — pycta i habitun.

— U mbush plot me «Zoti të dhashtë!» — m'u përgjegj. E ma nuk foli. Aty për aty u nda prej meje dhe e ndoqi lypësin. Nuk e pashë për dy ditë me radhë. Të tretën ditë më erdhi në shtëpi. Pa u ulë mirë, nxori një letër të pastër nga xhepi. E hapi. Letra ishtë shkrue me bojë. Në krye të saj ishin vendosë këto fjalë: «Zoti të dhashtë!» Ma vonë, kjo letër u botue në formë tregimi.»

Qysh me shkrimet e para që iu botuan, Migjeni tërhoqi vëmendjen e publikut lexues. Të rinjtë revolucionarë shihnin tek ai poetin e idealeve të tyre; ndërkojë, edhe njerëzit e regjimit, duke parë talentin e tij, u përpinqën ta bënin për vete. Revista «Illyria» i dërgoi një letër⁸⁾ lajkatare Migjenit më 4 nëntor 1935.

Por Migjeni nuk u gënjiye nga këto lajka. Ai vazhdoi të botojë te *Illyria*, por me shkrime që donte vetë. Dëshmi interesante sjell edhe një shok i tij i asaj kohe, Andrea Stefi, lidhur me krijimtarinë e poetit: «Kur ja theksova — shkruan ai — se rre-

thet komuniste shqiptare s'do t'ja falshin atë lëshim, qoftë edhe formal, në lidhje me poezinë «Trajtat e mbinjeriut», m'u përgjegj: Vepra ime ka karakter luftarak dhe, praktikisht, për kushtet e veçanta tonat, duhet me manevrue, pra, disa herë, edhe në mënyrë të maskueme. Unë s'mund t'ua shpjegoj këto grupeve. Ata duhet t'i kuptojnë vetë. Qarkullimi i veprës s'ime diktohet nga imperativi i etapës shoq-nore që po kalojmë. Për veten time, unë e quej ve-prën t'ime si një kontribut për bashkimin e këtyne rretheve. Në rrnofsha edhe pak, Andre, vepra ime, konspektivisht, do të kryhet».⁹⁾ Migjeni kishte besim në realizimin e idealeve të veta, por, njëkohësisht, parandjente se nuk do ta gëzonte vetë atë ditë të bardhë!

«Kam besim se vegimet e mia do t'i verifikojë zhvillimi i mavonshëm i ngjarjeve, përndryshe s'do t'i shkojshë deri në fund punës që i kam hy. Sa i lum do t'isha po ta preksha këtë konstatim. Por unë përjashtohem nga ky fakt!... Le të gëzohen të tjerët!»

Shqetësimi më i madh i Migjenit, në mbarimin e vitit 1935 dhe në fillimin e vitit 1936, ishte çështja e botimit të përbledhjes së vjershave nën titullin «Vargjet e lira». Më 12 janar 1936, tek shërbente si mësues në shkollën «28 Nëntori» të qytetit të Shkodrës, ai i dërgon letër Skënder Luarasit në Tiranë, ku, ndër të tjera, i shkruan:

«Ma parë dëshroj që të Ju gjejë kjo letër të kënaqun në çdo pikëpamje — mbasi që e dij mirëfilli se ç'do me thanë i pakënaqun në të gjitha pikëpamjet.

E dyta — Unë jam gati t'i lëshoj në shtyp kangaët e mijë. Tue qenë se Ju, kur ishit këtu, më prem-

tuet se do ta merrni përsipër me folë me ndonjë botonjës, si për shembull me «Gutenberg», unë tashti po Ju kujtoj at gja tue Ju thanë se jam gati. Dhe Ju pata thanë se të holla nuk kam (Këtë Ju përsërita që ta dini të rregulloheni në bashkëfjalim me botonjësin). Vjersha janë 35 copë. Mbas mendimit t'em, po qe se asht formati i librit 20×13 cm — si dëshroj unë — vjershat mund të shtypen në 90 faqe. Kjo barrë, që po Ju a ngarkoj, asht e vetëdëshruarme nga ana e Juej, e unë do të Ju jem mirënjohtës dhë në rasë mossuksesi në kët punë. Por Ju lutem të më lajmëroni përfundimin e bashkëfjalimit, që të dij të rregullohem».

Në fund të letrës, Migjeni shkruante «nuk më duhet transferimi për Pukë», duke u penduar kësh-
tu për lutjen që i kishte bërë Ministrisë. Por Mi-
nistria e Arsimit, pas dy ditësh, domethënë më 14
janar 1936, me urdhër telegrafik, i lajmëronte Mi-
lloshit vendimin e saj për ta transferuar në Pukë.

MËSUES NË PUKË

Milloshi e filloj punën si mësues në Pukë më 18 prill 1936. U emërua drejtues i «Shkollës fillore të përzieme», që varej, nga ana administrative, prej Inspektorisë së Arsimit të Shkodrës.

Në «Raportin vjetuer»¹⁰⁾ dërguar nga Milloshi prej Puke, më 29 nëntor 1936, Inspektorisë së Arsimit në Shkodër, thuhet se ai ishte transferuar «*mbas dëshirit*» në shkurt 1936 (ndonëse pat kërkuar një herë ta tërhiqte lutjen), se ishte liruar nga shërbimi ushtarak «*si i pa-ndimës*», se kishte pasur leje nga Ministria e Arsimit pér arsyen shëndetësore «*në fillim të vitit shkolluer*». Data e fillimit të vitit shkollor ishte 23 marsi, kurse ajo e mbarimit 28 nëntori. Duheshin bërë mësim 162 ditë. Por, siç shënon Milloshi, ai vit nuk u realizua plotësisht, sepse, pér shkak të epidemisë së fruthit dhe ajasmave, ishte ndërprerë një muaj.

Vajtja në Pukë, pas tre vitesh që kishte shërbyer në qytetin e Shkodrës dhe në fshatin Vrakë, që një ngjarje me rëndësi pér punën e tij si mësues dhe pér krijimtarinë e tij si shkrimtar. Ai u lidh me një mjesdis fshati malor, përfytyrimi epik i të cilit kontrastonte aq thellë me jetën e vajtueshme të pukjanëve. Krahinë shumë e prapambetur e veriut. Pu-

*tuet ~ sjeroi Migjenit tema, motive dhe ide që nuk
përkasin kishin sugjeroar as qyteti i lindjes as fshati i vogël fushor Vrakë.*

Milloshi dha mësim në klasën e tretë dhe të katërt. Në të tretën e realizoi programin për lëndët hartim, drejtshkrim, aritmikë, bukurshkrim, vizatim, këngë dhe gjimnastikë, por nuk e realizoi për mësimin e jetës, e cila «*në disa pika të programës... nuk përkon me stinët e punimit në këtë shkollë, mbasi asht shkollë me pushime dimrore*», as për lëndën e gjuhës, ku «*këndimit i janë lanë disa copa të kuptueshme për nxënësit e të III klasë.*» Në të katërtën e realizoi programin për lëndët mësim moral dhe qytetar, hartim, drejtshkrim, gramatikë, aritmikë, bukurshkrim, vizatim, këngë dhe gjimnastikë, por nuk e realizoi për lëndën e gjuhës, ku «*këndimit nuk i janë bamë disa copa nga mungesa e kohës*», as për lëndën e bujqësisë, ku, «*nga shkaku i kohës jashtëzakonisht të keqe, nuk ka muejtë me u ba sa duhej.*».

Pasi, për shkaqet e përmendura më sipër, nuk u realizua një pjesë e programit, Milloshi sugjeron që «*me çeljen e vjetrit shkolluer 1937, të bahan shkurt përsëritjet — ose skicat — mësimave të mësuara në këtë vjetë.*» Nga raporti në fjalë marrim vesh se Milloshi u ngarkua me shumë detyra si drejtues. «*Titullari — shkruan ai — ka korrespondencën e 8 shkollave të rrethit, mbledhjet e shpeshata të këshillit shkolluer për shqyrtimin e mungesave të nxanësve të të pesë shkollave, kështu që nuk mund të bajë as ma tepër se i përket mbas ligjit. E mësuesja e deritanishme nuk asht e zoja të bajë kangë, gjimnastikë dhe të mbajë kujdestarinë jash-të orëve.*» Prandaj kërkon që, përveç tij, si titullar

dhe si mësues, të kishte edhe një mësues tjetër për vitin shkollor 1937.

Kushtet e punës në lokalit e shkollës i kishte mjaft të vështira. Në raportin e dërguar nga Puka më 4 qershor 1936, ai shënon: «*Nga shkaku i disa meremetimeve të ndërtesës shkollore, regjistrimet shkollorë filluen më 16 mars të k. v. dhe mësimet më 23 po t'atij mueji*». Më 29 nëntor 1936 ngul këmbë për ndreqjen e shkollës: «*Fjala asht për ndërtesë, që nevojit meremetime: tjegulla e tjera, mbasi pullazi pikon gjithkund dhe rrezikon kalbjen e trenvz; mandej muri i jugut nevojit mistrinë me çimento, mbassi, tue e rrahë shtërngratë e madhe, prishet muri dhe ban lagështinë të madhe*». Më 7 qershor 1937, rithekson: «*Ndërtesa shkollore ka nevojë për një meremetim të mirë të pullazit, për mistrimin e një muri të jashtëm, për zbardhimin e dhomave përmbrënda dhe për ndreqjen e prakut të shkollës. Simbas thanjeve të titularit të komunës, këto meremetimë do të fillojnë shpejt*». Më 15 shtator 1937 përsëri ndalet te kjo çështje e pazgjidhur dhe shkruan: «*Meremetimet, për të cilat ka shumë nevojë ndërtesa shkollore, deri më sot nuk u banë. Në bgzë të shkresave të komunës së vendit, së shpejti do të mblidhet parija e katundeve për me e vendosë at çeshtje*».

Fëmijët vinin nga larg të zhveshur, të zbatur, të uritur. Edhe në shkollë, ata nuk gjenin ambjentin e përshtatshëm për mësim dhe strehim. Për më tepër «*mësimet e rregullta kanë fillue me 26 mars — shënon Milloshi — mbasi ma parë nuk mundën me filluz, nga shkaku i prrojeve, të cilët lëshohen me rasën e shinave dhe nxanësit nuk mund t'i kalojnë*».

Miloshi i donte shumë të vegjëlit. Në radhë të

parë, ai përpinqej t'ua bënte mësimin sa më të kuptueshëm, t'u jepte dije të ngulta, në të gjitha lëndët, ku kishte mundësi. Më se njëherë bën vërejtje për të meta të programit shkollor, për mungesa të theksuara, natyrisht me sa ia lejonin rrethanat. Protokollet e lëna nga kontrolli, pasi tregojnë gjendjen e shkollës si lokal, numrin e nxënësve, frekuencimin, vështirësitetë në përparim, bëjnë fjalë për she mbullin e mirë të mësuesit Millosh në mbledhje dhe në mbajtje të rregullt të dokumentacionit shkollor. Kur kërkon ndreqjen e lokalit të shkollës, Milloshi niset piksëpari nga qëllimi për t'u krijuar nxënësve një kënd të përshtatshëm mësimor. Ai bëri çmos që, ashtu si djemtë, shkollën ta ndiqnin edhe vajzat. Por u ndesh me kushtet e vështira të mjedisit shqëror të varfër dhe fanatik të Pukës.

Ashtu si të vegjëlit, Milloshi përpinqej të ndihmonte edhe punonjësit e varfër. Shkolla kishte një punëtor shërbimi. Gjendja e tij ekonomike, me të ardhurat e pakta që kishte, ishte shumë e vështirë. Në letrën e 16 prillit 1937, dërguar nga Puka Inspektorisë së Arsimit në Shkodër, Milloshi shkruan: «*Shërbëtori i kësaj shkolle... asht emrue para tri vjetve me rrrogë mujore 20 fr. a. Gjendja familjare në familje të tij asht shumë e vështirë dhe rroga e tij i del vetëm për bukë... Shërbëtori çfaq ankim për rrögë të vogël dhe lutë që ajo t'i përmirësohet. Titullari (domethënë vetë Milloshi, V.B.) i kësaj shkolle propozon dhe lutë që rroga e shërbëtorit në fjalë të caktohet 30 (tridhjetë) fr. a.*» Përgjigje nuk merr. Atëherë i shkruan përsëri Inspektorisë më 28 prill 1937: «*Këtu ngjitun përcjellim lutjen e shërbëtorit të shkollës... për shtimin e rrogës. Mbassi shërbëtori në fjalë është i vobegët dhe rrrogën e ka shumë*

të vogël... kjo Kryemësuesi e shef t'arësyeshme shtimin e rrrogës së tij me fr. a. 30».

Me gjithë punën e rëndë të mësuesit dhe të drejtuesit të disa shkollave të rrëthit, Milloshi iu vu në Pukë edhe kualifikimit të mëtejshëm. Me shkresën e 13 shtatorit 1936, dërguar nga inspektori i arsimit të Shkodrës Ministrisë së Arsimit në Tiranë, bëhet e ditur kërkesa e Milloshit që të shlyejë detyrimet e rrjedhura nga akuivalimi i shkollës teologjike, të kryer prej tij në Manastir, me shkollën normale (pedagogjike) laike në Shqipëri: «*Mësuesi i Pukës, Z. Millosh Nikolla*, — thuhet aty — *kërkon të japë provimet në sezonin e ardhshëm të vjeshtës si mbas nenit 439 pika 6 b të D. L. O. L.*».

Gjithsejt, në Pukë, Milloshi jetoi dhe punoi më pak se 18 muaj, domethënë që nga mezi i prillit 1936 gjer në dhjetor 1937, me ndërprerjet që bëri për shkak të lejës dhe të sëmundjes, duke e kaluar kohën në Shkodër. Një leje të tillë shëndetësore mori që nga marsi gjer më 15 qershori 1938, leje e cila zgjati deri më 30 qershori, tek ishte për kurim në Itali.

Kështu, në një kohë kur vuante nga një sëmundje e pashëruar dhe që iu acarua më shumë, kur kishte mjaft brenga përmajtjen e familjes së rrënuar ekonomikisht, kur ishte i ngarkuar me punën e mësuesit dhe të drejtuesit të aq shkollave në një lokalitet aq të prapambetur të veriut, me malësorë të zhytur në varfëri, në errësirë dhe në sëmundje epidemike, në një kohë kur vuante me Zenelët, që i dilnin përpara çdo ditë të zhveshor, të zbathur dhe të uritur, kur realiteti shoqëror, i errët dhe i rëndë, ia brente zemrën me dhembje e revoltë, Millosh Gjergj Nikolla shkroi më shumë se kurrë, shkroi kryevepërzat e veta në prozë.

* * *

Ngjarje të shënuara ndodhën në periudhën midis viteve 1936-1937. Në shkurt 1936 u krijua Grupi Komunist i Shkodrës, kurse në Kuçovë u zhvillua greva e punëtorëve të naftës dhe në Korçë demonstrata e bukës. Një muaj më vonë, më 16 mars, u formua, jashtë vendit, Fronti Demokratik Nacional. Lëvizja antizogiste po bënte përpëra. Një ngritje të dukshme pati lëvizja punëtore. Nënshkrimit të marrëveshjeve të reja ekonomike dhe politiko-ushtarake midis qeverisë zogiste kapitulluese dhe qeverisë fashiste italiane, që u bë më 19 mars, iu përgjegj një valë e re zemërata dhe revolte nga masat popullore. Në prill nisi botimin në Korçë e përkohshmja «Bota e re», me inisiativën dhe frymën e Grupit Komunist të atij qarku. Kur në korrik filloi kundërrevolucioni në Spanjë, mjaft komunistë dhe patriotë vajtën atje si vullnetarë shqiptarë dhe u radhitën në brigadat ndërkombëtare, për të mbrojtur Republikën Demokratike të Spanjës, duke e ditur se luftonin kundër fashizmit, të njëjtit armik, që, në bashkëpunim me regjimin zogist, po gllabëronte Shqipërinë. Forcimit të lëvizjes antizogiste, demokratike dhe punëtore, brenda vendit, qeveria mbretërore ia pat frikën shumë. Për të mbajtur në këmbë rendin në fuqi, ajo shpalli, më 23 prill 1937, Dekret ligjën mbi fajet kundër rendit shoqëror dhe ekonomik. Ndërkohë, forcat sunduese po grindeshin, duke synuar forcimin e mëtejshëm të pozitave me ndërrim roje. Puçi i Ethem Totos në Delvinë, më 15 maj, dështoi. Në pushtet mbeti krahu më konservator dhe reaksionar i rendit çifligaro-borgjez me përfaqësues kryesor mbretin satrap, Ahmet Zogun.

Në një mënyrë a në një tjetër, këto ngjarje politike gjetën pasqyrim në shtypin e përditshëm dhe periodik. Në Tiranë, përveç fletores «Arbëria», që kishte filluar të dilte që më 1935 dhe që vazhdoi të dilte pastaj, botoheshin edhe «Besa», «Drita» e «Shtypi», zëdhënëse të ideologjisë e të politikës së regjimit monarkik. Në Gjirokastër vazhdonte të dilte «Demokratia», në Korçë «Gazeta e Korçës» dhe në Vlorë filloj të botohej «Jeta e re», të gjitha me pozita të njëjtë ideo-politike, pavarësisht nga nuanca të ndryshme maskimi a demagogje.

Përveç fletores «Populli» të grupit të komunistëve shqiptarë të Lionit, pasuar nga fletorja «Sazani» (Lion 1937 dhe Rhone 1938) botime publicistike me përbajtje revolucionare antifashiste dhe antizogiste kemi tanë organin «Vullnetari i lirisë» që nxirrin vullnetarët shqiptarë në brigadat ndërkombe të Spanjës republikane, dhe fletoren «Shkëndia» që nxirrte një komitet revolucionarësh shqiptarë në Rumani. Krahas fletores, në Shqipëri botoheshin edhe një tok të përkohshmesh si: «Ekonomia kombëtare», «Përpjekja shqiptare», «Illyria», «Java», «Minerva», etj., organet klerikale, që kishin filluar të dilnin më parë si «Zani i naltë», i klerit musliman «Hylli i dritës» i urdhërit franceskan, «Le-ka» i urdhërit jezuit, etj. Të vetmet të përkohshme përparimtare, që dolën brënda vendit, qenë: «ABC», e cila pushoi së botuari që pas numrit të parë, dhe «Bota e re» e Korçës, e cila u mbyll nga regjimi zogist më 1937.

Në verën e vitit 1936, vëllimi i Migjenit «Var-gjet e lira» ishte bërë gati për të qarkulluar, por censura ndërhyri, e bllokoi në shtypshkronjë dhe nuk e lejoj të përhapej. Kjo gjë e lëndoi shumë poe-

tin. Veç ai nuk u dha. Vazhdoi të krijojë, sidomos në fushën e prozës. Te «Illyria» nxori në dritë vjershën *Recital' i malsorit* (7 mars 1936) me shënimin: «Nga «Vargjet e lira», që do të botohen». Në numrin e 18 prillit 1936, kjo e përkohshme bënte këtë lajmërim: «Për së shpëziti do të qarkullojë libri i vjershave me titullin «Vargjet e lira» prej shkrimtarit të ri dhe bashkëpunëtorit t'onë Migjeni». Me të dalë «Bota e re» e Korçës, thuajse të gjitha shkrimet Migjeni i dërgoi te kjo e përkohshme: vjershat *Kanga skandaloze* dhe *Kanga e të burgosunit*, prozat *Zoti të dhashtë! Program'* e një reviste. *Qershijat*, *Idhujt pa krena*, *Legjenda e misrit*, *Bukuria që vret*, *Urime për 1937* e Gogoli. Veç këtyre, ai shkroi në Pukë prozat *Puthja e cubit* e *Zeneli* si dhe gjashtë vjershat e fundit — *Kanga që s'kuptoheq*, *Një natë pa gjumë*, *Vuejtja*, *Frymëzimi i pa fat*, *Vetmija*, *Nën flamujt e melankolisë* e, ndoshta, *Hidhet e përhidhët* dhe *Malli rinuer*.

Gjatë kësaj periudhe, kryesisht në Shkodër, tek kalonte pushimet dimërore ose lejet shëndetësore, shkroi skicën *Në sezonën e mizave* dhe novelat *Studenti në shtëpi*, *Të çelen arkapijat*, *Historia e njanës nga ato*, *Pak poezi...* *Bukën tonë të përditshme falna sot...*, *M'atë anë gardhit asgja e re* (e pambaruar), të cilat i grupoi në një cikël me titull «Trajtat e qytetit», më vonë «Novelat e qytetit të veriut». Por këto mbetën në dorëshkrim, ndoshta sepse autori mendoi t'i përpunonte ose ndoshta sepse u step nga shkaku i censurës.

Migjeni ndiqte me vëmendje shtypin e përditshëm dhe periodik, si dhe botimet e kohës, duke përfshirë broshurat klerikale, që propagandonin ideolo-

gjinë mistiko-fetare dhe villnin helm kundër lëvizjes përparimtare demokratike dhe mendimit materialist, broshurat «Vlerë shpirtërore» (1936) të A. Harapit, «Kush çpif?» (1936) të F. Kordinjanos, etj. Një çast i rëndësishëm ishte lidhja e Migjenit me redaksinë e së përkohshmes «Bota e re». Migjeni u afrua me këtë organ, jo vetëm sepse ishte e vëtmja tribunë përparimtare brenda atdheut, por edhe sepse, nga të gjitha grupet e rrethet komuniste të vendit, simpatizonte më shumë Grupin Komunist të Korçës, që e nxori atë të përkohshme dhe që mbante një qëndrim më të avancuar ideo-politik. Edhe «Bota e re», me sa shihet, bëri një punë të mirë me Migjenin. Kështu, në numrin e 15 shtatorit 1936, redaksia i shkruan atij «*Që prej kohe s'na keni dërguar gjë. C'të jetë shkaku?*». Migjeni dërgon prozën *Legjenda e Misrit*, që botohet në numrin e 15 tetorit. Po në këtë numër, redaksia shënon: «*Migjeni, Pukë — Falemi nderit shumë. Vrejtjet tuaja janë me vend, por, siç e thoni dhe vetë, kjo nuk varet vëtëm nga ne. Megjithatë, do të përpinqemi. As për «Kangën skandaloze» s'kemi për të thënë gjë.*» Në numrin e 15 shtatorit 1936 lexojmë: «*Migjeni, Shkodër — Shumë falënderime. Na dërgoni sa më dendur. Besojmë se nuk do të kini paskëtaj ankime për gabime shtypi.*»

NË TORINO, MUAJT E FUNDIT

Klima e ashpër e Pukës, puna e dendur në shkollë dhe krijimtaria e pandërprerë letrare e dobësuan shumë shëndetin e Milloshit. Në këtë gjendje, ai nuk mundi të vazhdonte me punën dhe kérkoi shërim jashtë shtetit, pasi kushtet në Shqipëri ishin të papërshtatshme për një kurë të plotë kundër ftizisë. Kështu, më 13 dhjetor 1937, mori lejën dhe vizën, më 20 të atij muaji u nis nga Shkodra dhe arriti në Durrës, më 22 në mëngjez në Bari dhe, në mbrëmje të asaj dite, në Torino. Zgjodhi për qytet Torinon, sepse atje studjonte, në fakultetin e matematikës, motra e tij, e vogla. Në këtë mënyrë, ai do të kishte për ndihmë të motrën dhe vetë do t'i qëndronte asaj më pranë. Njëkohësisht, ëndërronte të regjistrohej në fakultetin e letërsisë së atij qyteti.

Në mbresat e udhëtimit që pati nga Shkodra në Durrës, Migjeni shkruan ndër të tjera me ironinë, që e karakterizonte te «Husarët n'Adriatik»: «*Nga Tirana në Durrës shndrruam tre automobila. Jo për qejf! Por pse i pari na hudhi në hendek dhe bani stop si me i pasë ra pikë, të dytit — po sa erdh nga Durrësi dhe u ndal para nesh — i a zu ngerçi frejt dhe s'u lëviz ma e, të tretit, mu në Durrës, i mungoi*

benzina. Fati ynë që anija nuk ish gjermane të ndizet n'ora 9 përpikë simbas orarit. Nuk ishim dhe pa fat, si na tha shoferi i automobilit që i u prishën frejt: «Siete infortunati». Na mbante për italjanë.» Ende më me hollësi, por tanj përzier me një humor të hollë, ai pëershkuaran udhëtimin me vapor nga Durrësi në Torino. «Deti asht i qetë. Kemi me udhëtue mirë — më thoshte shoku dhe, i inkurajuem, më tregonte se si njani, që e kish shumë frikë detin deri sa ish n'anije tue udhëtue, e uronte detin: O det i bekuem, sa i madhnueshëm je, sa e madhe asht mirsija jote, ti lidhë të gjitha qytetet e botës, bashkon të dashunit, miqtë dhe anmiqtë... Por, kur kambët e këtij frigacaku prekën tokën e sigurtë, ai i u suell detit dhe e pështyni: fuj! të marroftë Zoti, ti katil, hë... gjithkuaj ia more shpirtin... Dhe shaj detin me gojë të plotë...» Duke kaluar në sferën e politikës, për të vënë në lojë «miqësinë tradicionale» midis Shqipërisë dhe Italisë, që aq shumë trumbe-tohej nga zogistët dhe fashistët, Migjeni vazhdon: «Kush mund ta parashifte se, dikur, mbas mijë vjetësh, stërnipat e këtyne husarëve ilirë dhe stërnipat e romakëve të pasun, kush e mendonte se do të bahan miq, dhë miq të singertë? Nga miqsija e madhe të rrroken e të puthen, t'i ndihmojnë shoqi-shoqit me rasën e ndonjë disfate...» Herë pas here ai ironizon edhe në këtë mënyrë «E anija — herë i dridhej kurrizi, herë lëkundej djathtas e majtas, herë vente poshtë e naltë. Po mos ta kiske njeriu miden, në këtë rasë do të bante qejf. Por njeriu do të bante qejf dhe në shumë rasa të tjera, po mos të kish miden. Sidomos ne, stërnipat e ilirëve, do t'ishim të lumtun pa mide. Nuk do të vuejshim as në tokë as

në det. (Po ç'e do dhe jetën pa mide? — mendoj bashkë me ata të cilëve mideja u bluen ar e djamat. Po, ç'e do jetën pa mide?)»

Milloshi banoi në fillim në Via della Rocca, Nr. 10, të qytetit të Torinos. Motra tij, në kujtimet e veta, rrëfen se Milloshit dokumentat shkollore iu kthyen nga Tirana të palegalizuara, prandaj ai nuk mundi të bënte regjistrimin në fakultet. Po gjëja që e shqetësoi më shumë të sëmurin, qe klima e fortë e Torinos. Si pasojë, sëmundja e tij mori hov. Në mars të vitit 1938 mjekët e këshilluan që të shtrohej në sanatorium. Milloshi u shtrua në sanatoriumin «San Luigi», afër Torinos. Në fillim u duk sikur shëndeti po i printe mbarë dhe po shërohej. Njerëzit e afërt, që e vizitonin, ia thoshin këtë gjë. Edhe ai vetë sikur po e ndjente përmirësimin. Shokët dhe miqtë vizitorë i priste me padurim dhe i gjuar... Pikërisht në këto rrethana, ai shkroi mbresat nga qyteti i Torinos, në punimin e pakryer me titull «*Kanga e qytetit të huej*», ku vlon dëshira për të jetuar, me gjithë sëmundjen e rëndë dhe ndjenjën e vetmisië në dhe të largët: «*Kanga e qytetit të huej asht kanga e jetës, që rrohet. Ejeta rrohet kështu, thotë kanga: O njeri, që vjen nga dheu i huaj, hiqe melankolinë ose nostalginë për vendin tand — në se e ke — ze vend në një skaj në kryqëzimin e udhëve dhe vrz lëvizjen e tërbueme që shkaktojnë passionet njerzore.*

— O dritat e bukura të qytetit të huej!

— O dritat e bukura... kuq, blu, jeshil, verdhë. Secila dritë një grishje. Sinema, kabare, kafe, tregtiza. Të gjitha janë për plotësimin e dëshirave tueja. U shembellejnë luleve kah hyjnë bletët, thithin nektarin dhe dalin të dehura nga ëmbëlsina e jetës.

Ambëlsinën, ambëlsinën e jetës kërko ta gjesh, se e hidhuna e jetës vjen vetë. Prandaj janë dritat me ngjyra që ta kujtojnë: mos harro ta shijosh ambëlsinën e jetës! Prandaj dhe ngasin këta njerëz. Prandaj vrapojnë këto makina. Prandaj uturijnë kësh-tu tramet. Dhe të gjitha këto ngajnjë me një tempo të shpejtë, e cila të kujton se sa e shkurtër asht jeta.

Tek lëngonte në sanatorium me shpresën e shë-rimit, në prill të vitit 1938, Migjeni shkroi skicën *Kanga e trumcakut*, e cila, për fat të keq, na ka arri-tur jo e plotë, sepse i ka humbur faqja e parë. Skica trajton një temë të njojur filosofike që autori e shtjelloi edhe në *Sokrat i vuejtun, apo derr i këna-qun?*, në *Vetëvrasja e trumcakut*, etj. Duke vënë ba-lle për ballë figurën e trumcakut, që ka ndjenja të forta, por s'ka mundësi të këndojoë si bilbili, me figurën e bilbilit, që e ka një mundësi të tillë, Mi-gjeni shkruan: «... i pakënaqun trumcaku me fat, qëndron mbi degë. Me urrejtje shikonte natyrën, natyrën që s'e krijoi ma artistikisht. Me përbuzje vrente bylbylin. Tashma e kuptoi mirëfilli se duhet të vuejë nga fataliteti i gjanave! — Kështu tue me-ndue, ndjeu një lehtësi trumcaku. Në thellësinë e ndërgjegjes së tij filloj të ndjehet filozof. (Kish të drejtë! Se, kush arrin ndër trutë e vërtet fillon me bamë filo-zofi — dhe një filozofi ma të vërtetë se çdo tjetër filozofi)».

Duket, në këtë skicë, një hije fatalizmi, por, njëkohësisht, edhe dëshpërimi i Migjenit, që, duke pasur ende shumë për të thënë si poet, po e mbylle jetën aq i ri!

Tek lëngonte në sanatorium, Migjeni u rrek të mbante shënimë, ndoshta në formën e një ditari, por

këtë dëshirë nuk e realizoi. Në prozën e pakryer «*Torino — Sanatorium San Luigi*», ai shkruan: «*Më 15 maj 1938 — ka kohë që më sillet ndër tru mendimi të marr shënimë në shtëpinë e të dëshpruemve —, në sanatorium. Sot, ma tepër se kurrë, m'asht duke kjo banesë shtëpie e të dëshpruemve, mbasi nuk ndihesha mirë fizikisht e, kur nuk ndjehëm mirë fizikisht, ruej dy herë ma tepër shpirtnisht...».*

Megjithë vuajtjen e thellë shpirtërore, Milloshi interesohej për punët e shkollës, për të afërmit, miqtë dhe shokët. Në letrën e dërguar një shoku të punës më 12 shkurt 1938, lexojmë: «*Më duhet me ditë sa më parë kush po emnohet në vend tem, për t'i shpjegue shumë gjana, mbasi punët e Pukës, tue mendue se do të kthehem, i kam lanë mjaft të ndërlikueme... Më bahet, Lin, se vjetin 1938 s'e kam fillue për së mbari».*

Një motre së tij i shkruan më 27 shkurt 1938: «*Ministrisë i kam kërkue leje për tre muej. Ti mos u mërzit. I kam shkrue në Shkodër që nga rroga e eme me të çue 1.000 dinarë*». Ai përpinqet t'u japë zemër të afërmve, që e kanë mendjen dhe zemrën te shëndeti i tij: «*Kam vendosun të fryhem, prandaj kam hy në këtë sanatorium. Mos mendoni aspak për mue. Unë jam si gjithmonë. Vetëm se këtu, në sanatorium, po e ndjej se po shëndoshem: për njëmbëdhjetë ditë kam shtuz 1,5 kg., domethënë në një muej mund të shtoj 4 kg. dhe ma tepër. Prandaj mos u shqetësoni*».

Më 14 mars 1938 i tregon një motrës së vet: «*Unë jam fare mirë dhe nuk mërzitem. Shumë shqiptarë vijnë me më pa...*» Në këtë letër i kërkon asaj romanin shoqëror — dokësor «*Gjaku i papastër*» të shkrimtarit Borisav Stankoviq. Në letrën e 14 qer-

shorit 1938 i shkruan sërisht së motrës: «*Këtu, para 3 ditëvrz, bani një të nxehtë i madh e tash asht tue ramë shi. Unë, kësaj jave, po nisem për në bjeshkë...»*

Kaq shënimë, që sjellin interes, kemi prej tij. Motra e vogël, që i qëndroi afër deri në fund, vazhdon të na i sjellë kujtimet e dhembshme e të na rrëfejë se si përsëri Milloshi zuri të ndjehej keq. Mjekët i propozuan që të kalonte një operacion të vogël. Milloshi iu nënshtrua këtij operacioni në qershori. Po operacioni qe fatal dhe ndryshoi menjëherë gjendjen e tij. Milloshit iu pre oreksi, iu shteruan fuqitë dhe iu shoja humori i këndshëm e tërheqës. Dëshira e flaktë për jetën veç nuk iu shoja. Dhe pikërisht kjo ia shtoi besimin se, po të transferohej në ndonjë sanatorium malor, shëndeti i tij do të merrete sërisht për mbarë. Memzi iu sigurua një vend në «Ospedale Valdese», në Torre Pellice, afër Torinos, ku e motra e shoqëroi më 12 gusht 1938. Iшин ditët e fundit të jetës së tij të jetuar aq shkurt dhe me aq brenga e travajë! Megjithatë, si tregojnë njerëzit, që e vizituan ndër ato ditë, Milloshi ndiqte me interesim të vazhdueshëm ngjarjet në Shqipëri, e cila po kalonte, ashtu si biri i saj i dhembshur, një dramë të thellë kombëtare. Duke depërtuar ende më shumë në punët e saj të brendshme dhe duke ia zhvatur pasuritë, në mënyrë të parreshtur, fashizmi italian po përgatiste më në fund pushtimin e saj ushtarak. Në mars të vitit 1938, qeveria kapitulluese e monarkut satrap kishte pranuar të krijonte bankën «Napoli-Shqipëri», me të cilën kapitali italiano siguronte koncensione të reja me fitime të mëdha. Por, ndërkohë, lëvizja punëtore e demokratike, antizogiste e antifashiste, po rritëj dhe po përhapej në masat e gjera. Kështu, në zgjedhjet bashkiake

në Korçë e në Durrës fituan listat e grupeve demokratike. Jemi vetëm 8 muaj përpara sulmit të forcave fashiste italiane kundër vendit tonë, përpara kapitullimit të plotë dhe tradhtisë së hapur të klikës zogiste, por edhe përpara fillimit të qëndresës me armë të popullit tonë të panënshtuar. Milloshi i kuptonte ngjarjet, që po ndodhnin, por ishte larg miqve dhe shokëve, me të cilët mund të hapte zemrën.

Me t'u vendosur në spitalin Valdez, në atë sanatorium malor aq tërheqës, në mes të një natyre fort të hijshme, Milloshi i tha së motrës se dëshiron-te, pas çlodhjes nga udhëtimi, ta shetiste rreth e qark. Por më kot. Ai nuk e mori më veten dhe nuk e shëtitit kurrë atë natyrë joshëse. Për dy ditë mundi të dalë nga pak në kopshtin e lulëzuar të sanatoriu-mit, ditën e tretë pësoi një krizë aq të fortë, sa vetë kërkoi t'i jepnin oksigjen. Ditët e mëpastajme u shtrua në shtrat dhe nuk lëvizi më. Merrte pak ose fare pak ushqim. Fliste përherë rrallë e më rrallë, krejt i ndërgjegjshëm për çfarë po ndodhte me jetën e tij aq të re — njëzeteshtatëvjeçare! Shokët studentë shqiptarë në Torino nuk ishin më pranë tij. Vetëm motra e gjorë, motra e vogël e pangushëlluar, me të cilën Milloshi kishte lodruar në mituri, në shtëpizën përdheske dhe në oborrin e vogël të qytetit të lindjes, vetëm ajo tanë po i qëndronte afër, në çastet e fundit. Ajo ruhej të mos qahej para tij. Ai ruhej të mos shprehte dhembjen para saj. Ai don-te t'i thoshte diçka, por ishte vonë... Dhe, kështu, u ngrys nata e 26 gushtit 1938. Milloshi u mbyll krejt në vvetvete dhe, me një rezinjacion të çuditshëm, me një stoicizëm burrrëror, duke lënë pas vep-

rën e vet letrare të pamort, po dhe të pambaruar, qepi qepallat mbi qepallë, hoqi frymën e fundit dhe u shojt si në gjumë...

-
- 1) Luarasi Ollga (Nikolla): *Im vëlla Milloshi*, në «Migjeni — «Luli i vocër», mbledhur dhe redaktuar nga Bedri Dedja, Vehbi Bala dhe Nasho Jorgaqi, Tiranë, 1957, f. 9, 12, 13; sidhe *Shijet e tim vëllai*, po aty, f. 15-16.
 - 2) Popa Theofan: *Kujtime* në «Migjeni-Vepra», f. 12-14.
 - 3) Shaplllo Dalan: *Pas gjurmëve të jetës së Migjenit*, në «Nëntori», 1972, Nr. 2, f. 29-32.
 - 4) Zllatku Rexhep: *Zbulim interesant në Manastir: Vepër e panjohur e Migjenit* në «Rilindja» 8 nëntor 1971, f. 4; si dhe:
 - Jasiqi Ali: *Dy fjalë për dorëshkrimin «Jeta pa fat»* në «Fjala», 12 dhjetor 1971, f. 4;
 - Migjeni: «*Jeta pa fat*» (fragment i përkthyer shqip nga maqedonishtja prej Alush Kamberit) në «Fjala» 12 dhjetor 1971, f. 5.
 - 5) Muzeu popullor i Shkodrës, dosja «*Migjeni*» (Milosh Gjergj Nikolla), si dhe:
 - Llazari V. — Prenushi M.: *Të dhëna të reja për Migjenin*, në «Mësuesi» 1 janar 1965, f. 4.
 - 6) Luarasi Ollga (Nikolla): *Im vëlla Milloshi*, vepër e përmendur, f. 14.
 - 7) Gjyli Teufik në «*Migjeni — Luli i vocër*», vepër e përmendur, f. 4, 6-7; si dhe «*Disa shënime të jetës së Migjenit në vitet 1934-1937*» në «Nëntori», 1955, Nr. 11, f. 70-76; «*Kujtime*» në «Nëntori», 1961, Nr. 110 f. 65-68.
 - 8) Luarasi Skënder: *Hyrje. Jeta. Koha. Vepra e Migjenit* në «*Migjeni-Vepra*», mbledhur dhe redaktuar nga Skënder Luarasi, botim i dytë, Tiranë 1961, f. 5-46.

-
- 9) Stefi Andrea: *Rreth historisë së botimit të vëllimit «Vargjet e lira» të Migjenit*, në «Nëntori», 1955, Nr. 11, f. 68-70.
- 10) Ky raport dhe të tjerët, që citohen, gjenden në Arkin e Muzeut Popullor të Shkodrës, dosja «Migjeni» (Millosh Gjergj Nikolla).

II KRIJIMTARIA LETRARE

P O E Z I A

Krijimtaria poetike e Migjenit u zhvillua kryesisht në periudhën trivjeçare (1933-1935), kur ai shërbeu si mësues në fshatin Vrakë dhe në qytetin e Shkodrës, domethënë që kur u kthyte në atdhe dhe deri sa vajti në Pukë. Gjatë kësaj periudhe, ai krijoj rrëth tridhjetë e pesë vjersha. Kjo është shumica dërrmuese e prodhimit të tij poetik. Motivet e tyre janë nga më të ndryshmet. Në radhë të parë, ai shprehu pakënaqësinë ndaj realitetit shoqëror të kohës, dha pamje tronditëse ngajeta e klasave të shtypura dhe të shfrytëzuara, stigmatizoi rendin dhe institucionet e tij, shfaqqi dëshirën për një të ardhshme pa shtypje dhe shfrytëzim të njeriut mbi njeriun, si dhe besimin se të rinjtë me ndërgjegje revolucionare do ta përbysnin gjendjen e do të krijonin një shoqëri të re. Poeti është me ata që kërkojnë çlirim e masave nga zgjedha politike, ekonomike, shoqërore dhe shpirtore. Ai hedh kushtimin për luftë çlirimtare dhe paralajmëron revolucionin e afërt popullor. Këto ndjenja dhe mendime i shohim në plot vjersha me temë politiko-shoqërore, të karakterizuara nga një frymë e zjarrtë romantike, si të *Të birtë e shekullit të ri, Zgjimi, Të lindet njeriu, Shkëndija, Kanga e rinisë*. Te e pa-

Vjersha ka fryshtuar

ra, me një ton të ngritur, poeti i drejtohet kryesishët rinasë revolucionare, duke e konsideruar edhe vjeten pjestar të saj të pandarë në ballin e luftës politike kundër botës reaksionare të kohës. Me Të birtë e shekullit të ri poeti ngrihet pikërisht kundër forçave të errëta, konservatore, («kalbësinave të vjetra»), që donin ta mbanin Shqipërinë në errësirën mesjetare. Brezi i ri, në emër të të cilit flet poeti, kërkon që vendi të thyente prangat e marrëdhënieve të vjetra ekonomiko-shoqërore. Thelbi i kësaj vjershe është dëshira për zhvillimin e lirë të atdheut në rrugën e qytetërimit të vërtetë. Ajo mbyllët me vargjet, ku tingëllon i hapët zotimi për luftë kundër botës së mykur, ndërsa ndrit optimizmi për fitoren. Vjersha ka fryshtuar dhe ritmin e një kushtimi gjithë mëri e zjarr. Nga mendimet e shtetit luara, ajo mund të përfillet si program veprimi i poetit, i cili nisi kështu rrugën letrare prej luftëtarit për revolucionin çlirimtar. Ndaj ajo pati jehonë të madhe te rinia përparimtare, që shihte aty shprehjen e aspiratave të veta. Thirrja për t'u ngritur kundër gjendjes poshtëruese kumboi edhe te Zgjimi. Mendimi poetik zhvillohet këtu përmes aludimesh të largëta, që jo gjithëherë dalin të qarta. Poeti u drejtohet masave popullore, të cilat i quan «*vullnëte të ndrydhura*», në kuptimin e energjive të tuta-tura shekuj me radhë nën thundrën e pushtuesve. Duke u kujtuar të kaluarën, kur stërgjyshrit ilirë jetonin të pavarur, poeti i nxit masat në luftë për të ringjallur dinjitetin kombëtar:

*Tash shigjetat e flakta të shprehjes suej zharitse
drejtoni kah qielli në baltë të hyut a të dreqit,*

*i cili satin tonë mbytte në mnijë të vet përpise,
ta dijë se t'Birt' e Shqipes folen ia ngrehen vet-
vetit.*

Migjeni, që e shihte nga afër gjendjen e dhembshme të popullit, prapambetjen e madhe të vendit, ëndërronte kohën kur edhe Shqipëria do të bëhej e qytetruar dhe e lumtur. Por, që t'ia arrinte kësaj, duhej të fitohej liria. Vetëm në atmosferën e lirisë, mendonte poeti, mund të shpërthejnë energjitet krijuese të masave. Bashkë me lirinë, ai priste edhe daljen nga populli të një njeriu të shquar në ballin e luftës, të një prijesi, në kuptimin simbolik të një force udhëheqëse, që do të drejtonte njerëzit drejt shtigjeve të reja. Një ndër poezitë më popullore të Migjenit është Kanga e rinisë. Dashuria e tij për rininë është dashuri për të renë revolucionare, për ato forca të gjalla shoqërore, që do të përmbysnin botën e vjetër, botën e mjerimit, dhe do të ndërtonin botën e re. Vjersha është një tingëllim, thirrje e flaktë drejtuar rinisë, që do të luftonte për këtë çështje, për këtë ideal. «Kanga që i vlon në gji» rinisë është aspirata për ngadhnjimin e këtij ideali, në emër të të cilit ai fton që të luftohet:

*Rini, thueja kangës ma të bukur që di!
Thueja kangës sate që të vlon në gji.
Nxirre gëzimin tand, të shpërthejë me vrull.
Mos e freno kangën! Le të marri udhë.*

Edhe këtu mendimi i guximshëm është fshehur pas një aludimi të largët. Në vështrimin e jash-tëm, tingëllimi të lë përshtypjen e një kënge të thjeshtë rimore, të përshkuar nga entuziazmi i jetës,

pa ndonjë kuptim politik. Por, në thelb, ajo ka një nëntekst të thellë shoqëror, si një grishje e fushqishme, që zgjon mendimet dhe ndjenjat për një jetë më të bukur njerëzore.

Realiteti i zyrtë çifligaro-borgjez ishte një burg për poetin revolucionar. Migjeni nuk e ndjente vreten të lirë të shprehte atë që i vlonte në shpirt. Kjo gjendje shpirtërore u pasqyrua te *Kanga e të burgosunit*, ku vetja përfytyrohet si një «luan i ndrym në kafaz», te *Shpirti i ri* si një «shqiponjë me krah të thyem» dhe, sidomos, te *Kangët e pakëndueme*, ku çastet e pesimizmit nuk mbulojnë dot optimizmin e vërtetë revolucionar. Migjeni beson se do të vinte «një ditë ma e lumnueme» kur, «kangët e pakëndueme» do të shpërthenin «pa frikë e pa zori»... «në një mijë ngjyra, që nuk vdesin». Poeti pyet:

*Por a do të vijë dita kangët me u zgjue?
Apo ndoshta shekujt me ne prap po tallen?*

Dhe përgjigjet:

*Jo! Jo! Se liria filloi me lulzue,
dhe e ndjej nga Dielli alegorik valën.*

Dy diell alegorik ka kuptimin e diellit që përmend Migjeni te letra *Të fala nga fshati*, botuar më 1 korrik 1934. Me diellin alegorik poeti kuptonte idetë e Revolucionit Socialist të Totorit. Ai kështu shfaqi shpresën se, me fitoren e këtij Revolucioni, po krijuheshin mundësitë për fitoren e lirisë edhe në Shqipëri.

Por në qendër të veprës poetike të Migjenit
është tema e mjerimit e atij mjerimi të parrëfyer
të vegjelisë së qytetit dhe të fshatit, që do të zërë
gjithashtu vendin kryesor edhe në prozën e tij. Nga
ana e metodës artistike, poezia vjen e ngrihet në
një realizëm më të theksuar. Kur poeti e njohu mi-
rë se ç'rojtje të trishtuar bënte populli i thjeshtë,
krijimet i ngjeshi përherë e më shumë në brendi
shoqërore të marrë nga jeta, dhe me nota të kriti-
kës, të protestës dhe të revoltës. Nga vjershat e pâ-
ra me frymë më të spikatur romantike dhe me alu-
dime ndonjëherë jo dhe aq të qarta, poeti kalon në
ato realiste, ku jeta e popullit del e vizatuar me
ngjyra konkrete deri në hollësi tipike shumë shpre-
hëse. Krijimi më i rëndësishëm me këtë temë është
Poema e mjerimit, e cila mbetet një nga kryeveprat
e tërë poesisë shqipe. Ajo është thurur në formën
e një tregimi të poetit agitator për gjendjen tragji-
ke të masave të varfëra nën regjimin e urryer
zogist:

*Kafshatë, që s'kapërdihet asht, or vlla, mjerimi,
kafshatë që t'mbet në fyt dhe të zë trishtimi,
kur shef fytyra të zbeta dhe sy t'jeshilta,
që të shikojnë si hije dhe shtrijnë duert e mpita,
dhe ashtu të shtrime mbrapa teje jesin
të tanë jetën e vet, deri sa të vdesin.*

Duke shfryrë dhembjen që i shkakton mjerimi,
poeti vizaton pamje rrënqethëse, jep figura njerëzish
të mbërthyer nga një trishtim i rëndë. Migjenin e
indinjonte hendeku i pabarazisë shoqërore nën ren-
din çifligaro-borgjez, kontrasti i madh midis luksit
të të pasurve dhe mjerimit të masave. Me ironi the-

rëse e ka ngjeshur poeti vargun aty ku flet për qetësinë e zotérinjve, që «me zoja flejnë në shtretënit e lumnisë». Syri i tij dikton karakterin çnjerëzor të shoqërisë me klasa antagonistë, ku gruas i hiqet mundësia të jetë nënë, kurse nëna s'ka me çfarë të rritë fëmijën e vet. Mjerimin poeti e sheh si turp të kobshëm për njerëzimin:

*Mjerimi asht një njollë e pashlyeme,
në ballë të njerzimit që kalon nëpër shekuj*

Në poemë, me vija të hiperbolës dhe të groteskut, Migjeni ravijëzoi figurën e përbindshme të përfaqësuesit të klasave shfrytëzuese, të kapitalistikës, i cili ushqehet me gjakun e popullit («qen i pamëshirshëm me bark shekulluer, gjithmonë i pangishëm»). E re në këtë vepër është paraqitja, krahas viktimate të tjera të padrejtësisë shoqërore, e figurës së punëtorit, i cili: punon dit' e natë,

*tue i vlue djersa në gjoks edhe në ballë,
tue u zhigatun |deri në gjujë në baltë,
e prap zorrët nga uja i bahen palë-palë.*

Për këtë robëtisje, punëtori merr si shpërblim «vetëm lekë tre katër dhe marsh!». Te letra e 1 korrikut 1934, ku ai shkruante se vuante «me punëtorin, të cilin hekuri e ndrydh» te skica *Moll'* e *ndalue-me*, ku ai nxjerr figurën e punëtorit qysh endet rrugëve të qytetit pa punë porsi «Kolegët e tij në Berlin e në London» dhe është gati për të shpërthyer si «revolucion në miniatyrë», këtu, te *Poema e mjerimit*, ku përshkruhet figura kolektive e punëtorëve, që shtypen dhe shfrytëzohen deri në pal-

çë për një pagë tepër të vogël nga kapitalistët, kemi përpjekjet e para serioze për të paraqitur me artin letrar gjendjen reale të klasës punëtore në vitet 30 në Shqipëri. Tema e klasës punëtore do ta tërheqë Migjenin edhe më vonë, në disa proza të tjera, po ka rëndësi të vërehet se paraqitjen simbolike të figurës së punëtorit në vendet kapitaliste ai e bën nga pozita të avancuara edhe te *Kanga e Perëndimit*:

*Ku prej mëngjezi deri në mbramje shkrihen
ndjesitë, trutë njerzore
n'apoteozën e hekurit; shpirtënt përshkohen në
tymore.*

Duke zbuluar kontradiktën e thellë midis kapitalit dhe punës, kontrastin midis kapitalistëve dhe proletarëve, poeti bën thirrje që nga Perëndimi nuk duhet të tërhiqemi prej lustrës së qytetërimit borgjez, por duhet të dëgjojmë zërin e revoltës së klasës punëtore («kangë që mbështillet në shllunga avulli, në pika djerse»).

Çështjen e rrojtjes së vajtueshme të shumicës dërmuese të njerëzve poeti e lidh me rolin negativ të fesë, me qëndrimin e saj komplis dhe hipokrit ndaj kësaj plage, që e bren shoqërinë njerëzore ndër shekuj të shekujve. Ky është një nga motivet kryesore të *Poemës së mjerimit*, që nis me një kuadër kuptimplotë: mënjanë kemi të mjerët, që qëndrojnë si «hije», me «ftyra të zbeta» dhe me «sy të jeshilta», kurse mbanë tjetër:

*... Mbi ta n'ajri, si në qesëndi
therin qiellen kryqat e minarët e gurta,*

*profetënt dhe shejtënt në fushqeta të shum-
-ngjyra
shkëlqejnë. E mjerimi mirfilli ndjen tradhti.*

Poeti, i cili doli nga bankat e seminarit dhe e kuptoi se klerikët përpinqen ta nxjerrin fenë si ideo-logjinë e të varfërve, që gjoja i mbron këta, tregoi se e vërteta është krejt ndryshe, domethënë se feja është ideologjia, që mbron të pasurit, shtypësit dhe shfrytëzuesit. Ishte koha kur në Shkodër kisha katolike organizoi farsën mashtruese të luajtjes së syve të Shna Ndout, kurse kleri musliman organizoi një mevlud pompoz. Migjeni u indinjua thellë dhe, në mënyrë të vendosur, hodhi poshtë demagogjinë e tyre, duke u shprehur me këto vargje:

*...këtë njollë kurr nuk asht e mundshme
ta shlyejnë paçavrat, që zunë myk ndër tempuj.*

Poema e mjerimit tingëlloi si një aktakuzë dërrmuese kundër rendit çifligaro-borgjez dhe kundër institucioneve të tij, që orvateshin ta përbannin dhe ta përgjumnin zemëratën a revoltën e të shtypurve dhe të të shfrytëzuarve.

Edhe në mjaft vjersha të tjera, poeti del si zë-dhënës i të mjerëve. Te *Baladë qytetëse*, ai krijoj figurën tragjike të një gruaje rruge, e cila, e mibetur në pleqëri pa një kafshatë pér të mbajtur fryshtë gjallë, gjendet në buzë të çmendurisë. Dramën e dhëmbshme të njerëzve të thjeshtë e kemi edhe te *Lagja e varfën*, *Melodi e këputun*, etj. Ata, pasi sakatohen moralisht dhe fizikisht, plandosen pa më-shirë në greminën e jetës. Kjo nuk ishte gjë e jash-tëzakonshme në atë kohë. Ishte një nga skenat e

shumta që syri i poetit vërente përditë «fragment» i një kuadri të tërë, që i dilte kudo përpara. Këtë konkluzion na shtyn të nxjerrim te vjersha me të njëjtin titull (*Fragment*), ku na tregohet mbarimi tragjik i një lypësi të vogël. Duke ndjekur gjithnjë kontrastin, përballë të mjerëve, Migjeni pëershkroi me mllef të fuqishëm sarkazme pinjollët e familjeve të pasura, të cilët, ndërsa populli vuante për kafshatën e gojës, çonin një jetë të shthurur dhe boshe, në défrime të ulëta (*Rima e tretun, Mbas tryezës, etj.*)

Po në krijimtarinë poetike të Migjenit tema ateiste, e demaskimit të fesë dhe e moralit të saj, e klerit dhe e institucioneve të tij, ze një vend shumë të rëndësishëm. Sikurse te *Poema e mjerimit* dhe te disa skica në prozë, ashtu edhe te mjaft vjersha, ai e stigmatizon nga pozita të avancuara materialiste, fenë si ideologji. *Blasfemi* është një vjershë e fuqishme, ku poeti shpreh ateizmin e vet militant, urrejtjen ndaj klerit në shërbim të shtypësve dhe të shfrytëzuesve. *Kanga skandaloze zbulon qartë qëndrimin e tij antifetar dhe antiklerikal. Vargjet e kësaj vjershe janë dhe sfidë drejtuar moralit të fesë përmes figurës asketike të murgeschës:*

*Prej lutjesh (jo tallse) duel dhe në lutjen prapë
po shkon...
Pa lutjet e saja bota kushedi ç'fat do kishtë!*

Poeti shpreh konceptin e vet rrëth rolit frenues të kultit në historinë e shoqërisë njerëzore.

Por edhe nga lutjet e saja ende s'i zbardhi drita. Kjo është përgjegja e poetit ndaj trillimeve të

fesë. Me guxim të rrallë në atë kohë Migjeni tregoi qëndrimin e vet të papajtueshëm përballë fesë:

*Unë dhe ti, murgeshë, dy skaje po të një litari,
të cilin dy tabore ja ngrehin njani-tjetrit,
lufta asht e ashpër dhe kushedi ku është dali,
prandaj ngrehet litari dhe përplasen njerëzit.*

Te Migjeni lufta midis fetarizmit dhe afetarizmit, teizmit dhe ateizmit, është konceptuar si luftë midis idealizmit dhe materializmit, si luftë e papajtueshme klasash në ideologji. Me *Parathënjen e parathënjeve*, me vjershën që hapte vëllimin «Vargjet e lira», është shprehur gëzimi i poetit që shekulli nisi të çlirohet nga skllavëria shpirtërore e fesë, e cila, gjatë gjithë historisë, ka qenë pengesë për përparimin e njerëzimit.

Mbi tru të njerzimit zoti galuc ka ndejun.

Në krijimet poetike të Migjenit një kapitull më vete përbën (motivi i dashurisë) Poitin e tërheq bukuria reale e vashës, por këtë bukuri ai e shijon në mënyrë efimore. E kërkon dashurinë, por nuk arrin ta gëzojë. Ndjema e tij nuk është platonike, edhe kur ëndërron. Vjershat kushtuar dashurisë i përshkon shpesh një notë moskënaqësie, në mos dëshpërimi. Ato iu frymëzuan nga dashuria që ai ndjente konkretisht në jetë, por që nuk iu realizua (Z.B., *Ndeshja, Malli rinuer*, etj.).

Për temën që trajton, një vend të posaçëm në krijimtarinë poetike të Migjenit zë *Kangë në vete*, ku aludohet te fashizmi, që kishte nisur të gjente atëherë përkrahës në klasat sunduese të vendeve të ndryshme të Ballkanit. Fashizmin poeti e quan «verri», që, si hajn, «në shtëpijat e kojshive hyn», sjell

«acarin» dhe «ngrin» shpirtrat e njerëzve. Me mprehtësi të veçantë poeti ditë, pas demagogjisë së madhe që bëhej aso kohe, të diktonte thelbin tej-reaksionar të fashizmit, i cili përpiquej ta fshinte fytyrën e vet të ndyrë me një lustër «pallatesh të kristalta». Në Ballkan, sidomos në Jugosllavi, fashistët shfrytëzonin iluzionet e vjetra shoviniste të stërgjyshëve melezë. Por poeti nuk u gënjiye nga premtimet «e kristalta» të fashizmit dhe e demaskoi këtë me veriun,» që fryn pa mëshirë»:

*Unë ia mylle derën me reze të mos hyjë
m'e ma fikë këtë dritë,
me ma gri këtë shpirt,
me ma dridhë pér ndjesi tjetër,
me m'a joshë m'e andërr të vjetër.*

shkruan Migjeni. Kuptohet që denoncimi i fashizmit në Jugosllavi ishte njëkohësisht edhe denoncimi i fashizmit në Shqipëri.

Por jo kudo Migjeni ka qenë në pozita të qarta ideore. Në disa krijime të tij poetike vërehen mjafit dobësi dhe kufizime. Te *Zgjimi*, me vargun «zemra e kombit në liri kumbonte», poeti jep një paraqitje të idealizuar të së kaluarës së lashtë iliriane. Sipas vjershiës *Trajtat e mbinjeriut*, jeta është gjithë mjerim, sepse pranverat zhduken shpejt, porsi shkuma e detit dhe, me zhdukjen e tyre, shembet hareja. Në vend të tyre vijnë stinët e vjetra, që janë «pa ngjyra e pa trajta». Më kot përpiken njerëzit në jetë pér diçka më të mirë, sepse bëhen qesharakë dhe vdesin» ndër ethe mundimi pér me shijue jetën». Poeti arrin ta quajë jetën e njeriut «marrzi e vulosun» dhe, pér ta shpëtuar njeriun nga kjo «marrzi»,

u dashka një «sfinks i madhnweshëm» me sy rrufeje, «që qarkullojnë rrëth rruzullit tue synue vranshëm». Në vjershat Reziknata dhe Shpirti i ri shihet një farë nënshtimi ndaj jetës, kurse te *Kanga e të burgosunit* dëshpërimi rrjedh nga vetëdija e pafuqishmërisë së poetit, i cili ndjehet i vetëm në luf'ën që bën. Ndjenja e dëshpërimit dhe e skepticizmit e kap poitin. Te «*Frymëzimi i pasat*», ai e qorton frymëzimin, që e fton të shkruajë për të gjorët. Për më tepër, këtu gjejmë edhe thekse fatalizmi. Te *Poema e mjerimit*, siç u pa më sipër, Migjeni shfaqi haptazi qëndrimin e vet kundër shfrytëzimit kapitalist dhe kundër fesë. Por ai e trajtoi problemin e të mjerëve në mënyrë të kufizuar, kur shkroi se «mjerimi don vetëm të drejtë» dhe nuk nënkuptozi aty revolucionin çlirimtar.

Gjatë periudhës 1936-1937, Migjeni iu vu kriji mit të një poeme kushtuar punës ose, më saktë, një poeme ku punës do t'i këndonte hymnin e ngadhnjimit. Dëshmohet se në Pukë, në verën e vitit 1936, e filloj poemën në fjalë me këto vargje:

Jo, dashunisë, si Solomoni në Dhjatën vjetër
unë Kangën e Kangëve
s'do t'ia kushtoj,
por... punës —
hymnin e ngadhnjimit do t'ia këndojoj.

Nuk kemi të dhëna të tjera për dëshirën e tij që të shkruante vërtet një poemë të tillë për punën, ashtu siç shkroi një poemë për mjerimin. Është me interes të vërejmë se vjershën antifetare *Parathanja e Parathanjeve* poeti e titulloj duke parodizuar *Kangën e Kangëve*. Shumë faktorë na shtyjnë të besojmë se këto vargje që përmendëm i ka shkruar Migjeni, sepse të tilla zakonisht janë për-

mbajtja dhe forma, e tillë mënyra e të shprehurit, i tillë stili. Ne e dimë tanimë se poeti hodhi disa ide për punën dhe punëtorin në Shqipërinë e kohës dhe në botë, duke mbajtur anën e proletariatit dhe duke denoncuar dhunën kapitaliste (le të kujtojmë *Kan-gët e Prendimit, Poemën e Mjerimit, Moll'e ndalueme, etj.*) Të kësaj periudhe duhet të janë edhe vargjet:

*Për ditë shoh qartë e ma qartë
dhe vuej thell e ma thellë...*

që na dëshmohen në botimin «Vepra të zgjedhura» (1969). Vargjet tregojnë se poeti vuante pér gjendjen e vajtueshme të popullit dhe shihte gjithnjë më qartë pér të ardhshmen e tij. Por, njëkohësisht, në këtë periudhë dyvjeçare, gjejmë edhe shprehje zhgënji-mi tek ato pak vjersha që shkroi dhe që janë të fundit. Poeti kërkon dritë nga një *burre*, që *shkatërron edhe që ndërton së rish*, ankohet që nuk ka një pishë të madhe, të ndezur, që të shkruajë kushtimin me flakën e saj në qiellin e natës... *se vetëm janë burrat, shokët*. Ai dëshpérohet dhe tërhiqet në vetvete pér të pritur ngushullimin («*Një natë pa gjumë*»). Është i vtdijshëm pér sëmundjen, që e bren. Ndjen dhembjen e saj, që ia rrëmben mëngjezet e hovit e të punës, që e largon, aq të ri, nga lufta e jetës, sa të mbetet *flamur i vjetruem! i reckuem* «*Vuejtja*»). Në një gjendje të tillë dëshpërimi dhe skeptizimi i vjen frymëzimi dhe i djeg mu në gjii. Fluturimet lirike s'i duhen më. Ai do të shkrihet me masat e vuajtura në gjirin e atdheut:

*Nëpër balta...
të ditve tona të shklas unë due*

rrokë me njerzit që rrrokë nata.

(«Frymëzim i pa fat»)

Nga zemra e kombit u vodh një këngë, që shpërthen në vaj — këngë e buruar nga mjerimi, këngë e urisë. Zemra e kombit të vuajë? Jeta e zymtë është ajo që ia helmoi ditët dhe që ia gozhdoi dëshirat e gjallimit («Kanga që s'kuptohet»). Vëtmia i sjell poetit mërzitje dhe kjo, bashkë me përbuzjen eurrejtjen, emplak para kohe. Ndjen se ka shumë armiq të ligj-tërë forcat e shtypjes lëndore dhe shpirtërore, tërë njerëzit, që s'e përfillnin në vëminë e trishtuar («Vëtmija»). Së fundi, ai vëren se në tërë vendin

*Valojnë
flamujt e një melankolije
Të trishtueshme... dhe askush s'mund të thotë
se këtu rron
një popull,
që ndërton diçka të re...*

Është e vërtetë, vazhdon poeti, se

*Aty — këtu
nën hijet
e flamujvet,
mund të shifet
një mund, një përpjekje
e madhe përmbi vdekje,
për të pjellë diçka të madhe,
për të qitë në drithë një xhind.
Por, (o ironi!)*

*nga ajo përpjekje lind
vetëm një mi.*

(«*Nën flamujt e melankolisë*»)

Rreth kësaj vjershe është folur shumë dhe, disa herë, janë shfaqur mendime jo të drejta. Ajo është një sintezë e botëkuptimit të poetit në një periudhë zhgënjimi. Poeti e çel poezinë me një kontrast të hidhur. Përpjekjet, që bëhen në atdhe, janë ende të pamjaftueshme (të kujtojmë shprehjen e K. Marksit: *U mbars mali dhe polli një mi!*). Poeti dëshpërohet se nuk gjen fryshtësi e duhur revolucionare në kombin e vet (të kujtojmë mallkimin e Çernishevskit për kombin rus dhe mbrojtjen që i bëri V. I. Lenini nga interpretuesit e shtrembe të tij). Dëshpërimi i Migjenit rrjedh, pra, nga dashuria e vërtetë që ka për atdheun, për popullin, nga konstanti se lëvizja revolucionare, në atë kohë, ishte ende e dobët, jo kompakte. Këto ishin vjershat e fundit që njohim prej tij. Megjithatë, në tërësinë e artit poetik të Migjenit, nuk është tipike as thelbësore ndjenja e pesimizmit. Vepra e tij karakterizohet nga dashuria për jetën, nga besimi se masat popullore, më në fund, do të ngadhnjejnë mbi armiqjtë e tyre, mbi klasat shfrytëzuese, mbi regjimin reaksionar. Duke ëndërruar për një të ardhshme të lirë, poeti i thur hymne pranverës së vërtetë njerëzore në atdhe me një vizion thellësish optimist:

...dhe pranvera erdhi. . .

*Nëpër ftyra tona rrshqiti një gjëzim
dhe ndër zemra tona ngrehi një fole
e një jetë e bukur e një jetë e re
me dëshira t'shumta po buzëqesh n'luzim.*
(«Ekstaza pranverore»)

*Me kängë në buzë e me hove t'reja
u zgjue agimi pranveruer,
largsinat e hjedhta ka zatetë hareja,
n'argjent shkëlqejnë brigjet tèrthuer.*
(«Sonet pranveror»)

Në poezinë e Migjenit, fraza ka një frysëmarrje të gjërë, një ton të ndjeshëm oratorik, si në hovët lirike të zemërimit, si në ato të ngazëllimit. Vjershat janë strofike, monokolonë dhe të përziera. Poeti rrallë përdor vjershën me subjekt. Poema nuk shkroi. *Poema e mjerimit* është një vjershë e gjatë në formën e ligjératës së një agitatori, që deklamon para masës, ashtu siç janë përgjithësisht edhe vjershat e ciklit *Kangët e ringjalljes*. Dy tingëllimet e tij nuk i përbahen trajtës klasike, as në masën e rrrokjeve, as në sistemin e rimave, por vetëm në strukturën e jashtme, në numrin e vargjeve dhe të strofave. Vargjet silabotonike paraqiten në tri lloje: të rregullta, të thyera dhe të lira. Në tërsi, vetëm një e katërtë e vjershave janë të lira në kuptimin e vërtetë. Pas Asdrenit dhe ndonjë tjetri, Migjeni është nga të parët, që përdor vargjet e lira. Ai ndjek shkrimitarët e mëparshëm të variantit letrar verior të shqipes përsa i takon ë-s, herë duke e numëruar rrrokjen, herë jo. Shpesh poeti përdor liritë poetike: sinalefen, dierezin dhe hiatusin. Përvëç ndonjë përjashtimi të rrallë, ue-n e përfill si një rrrokje. Të rimuarit e vargut bëhet më shpesh me anë të asonancës se sa të rimës dhe, më pak, me anë të kosonancës. Kjo gjë formon një karakteristikë të veçantë në sistemin rimor. Ka raste kur poeti nuk përdor fare rimën ose përdor tinguj të përafërt, në mos edhe rimën e brendshme. Si mjete fi-

gurative të shprehjes, përveç antitezës, që rreh të pasqyrojë kontrastet e realitetit të shoqërisë së ndarë në klasa antagonistë, përveç simbolit, që kërkon të japë thelbin e fenomenit politik shoqëror, ai shtie në punë mjete të tjera, për shëmbull, figurat gramatikore (inversionin, sinalefën dhe elipsën), figurat e fjalëve (metaforën, krahasimin dhe sinekdokën) dhe figurat e mendimit poetik (shkallëzimin, hiperbolën, thirrjen retorike, etj.). Dinamizmi i vargut të tij qëndron edhe në aliteracionin. Shembuj aliteracioni të goditur kemi te *Poëma e mjerimit*, ku dufi i poetit shfren në tinguj të ashpër, në një kadencë orijinale ritmesh, në një tok rimash dhe asonancash, që, së bashku, formojnë një stil të fuqishëm imitativ. Karakteristikë procedimi stilistik nuk është analiza, por sinteza, jo figura për figurë, por figura për ide. I revoltuar në jetë, Migjeni u revoltua edhe në formën me të cilin shtjelloi poezinë. Me këtë kuptim të dyfishtë duhet marrë titulli i përmbledhjes së tij poetike «Vargjet e lira». Mënyra e të shkruarit e Migjenit është novatore në radhë të parë nga përbajtja e re shoqërore që trajton dhe pastaj nga figuracioni me të cilën e shjellon atë.

P R O Z A

Në krijimtarinë letrare të Migjenit, proza zë një vend më të madh se poezia. Sipas të dhënave kujtimore, ai e filloi prozën njëkohësisht me poezinë që kur ishte në Manastir. Duke ndjekur gjurmët e Milloshit dhe duke kërkuar elemente të panjohura të krijimtarisë së tij në Manastir, një studioz i ri, Alush Kamberi, gjeti në dorën e ish-bashkënxënësit të shkrimitarit tonë në seminarin teologjik, Simo Acevit, sot prift ortodoks në atë qytet, dorëshkrimin e prozës «Jeta pa fat» maqedonisht. Acevi i dëshmoi studiozit të ri se Milloshi e kishte hartuar vepren në shqip dhe, pastaj, i ndihmuar nga ai, e kishët përkthyer serbokroatësht. Përkthimin serbokroatësht Acevi e kishte përkthyer maqedonisht. Në fund, një fragment të përkthimit maqedonisht Kamberi e përktheu në shqipen e sotme letrare dhe e botoi te e përkohshmja «Fjala» e 12 dhjetorit 1971. Të humbura janë përkthimi serbokroatësht dhe originali shqip. Acevi pohon se originali shqip duhet të ketë ngelur te një ish-bashkënxënës tjetër i Milloshit në Durrës, por kjo gjë, ende sot e kësaj dite, nuk ka gjetur vërtetim.

Dorëshkrimi që zoteron Kamberi në përkthimin maqedonisht të Acevit shtrihet në gjashtë fletore

formati të zakonshëm, me rreth 250 faqe të shkruara me dorë. Lind pyetja: a thua vërtetë është kjo një vepër e Milloshit? Çfarë flet në mohim të autorësise dhe çfarë flet në pohim të saj?

Në mohim mund të sillen mjaft argumente: mungesa e origjinalit shqip dhe e përkthimit serbokroatish, ashtu si dhe e vjershavës dhe e prozave të tjera, që pandehen se janë hartuar nga Milloshi në Manastir; fakti që vetë Milloshi nuk e zë në gojë këtë vepër, as edhe ndonjë jetëshkrues i tij deri më sot; pohimi i Acevit se, në përkthimin maqedonisht, ka bërë disa ndërhyrje, me qëllim që t'i jepte sa më shumë ngjyrën e mjedisit maqedonas. Është e natyrshme, pra, që përkthimi maqedonisht të ketë të mangëta mjaft shprehje karakteristike të origjinalit. Prandaj, përderisa nuk i kemi në dorë as origjinalin shqip as përkthimin serbokroatish, dyshimi i ndokujt pér autenticitetin e autorësise migjeniane të veprës në fjalë qëndron në këmbë. Del detyrë e studiozëve të jetës dhe të veprës së Milloshit që të kërkojnë me ngulm gjurmët deri te gjeneza e kësaj proze të gjatë inedite.

Në pohim mund të sillen shumë argumente: logjika, e cila të çon deri në atë që fillimet letrare duhet t'i ketë pasur Milloshi në Manastir dhe që, ndonëse përkthim mbi përkthim, dorëshkrimi jep një tok elementesh në dobi të pandehjes se kemi të bëjmë me një vepër të panjohur të Milloshit të hartuar atje; fakti se ngjarjet vendosen në fshatrat midis Manastirit dhe Kërçovës, diku afér Treskës, pra në një mjedis të banuar edhe nga shqiptarë, gjë që vërtetohet me emrat shqiptarë të disa personazhevë vepruese të tregimit; të përmendurit e elementeve të mitologjisë shqiptare, gjë që jep dorë të

mendosh se vepra është hartuar nga një autor shqiptar, i cili i ka njojur elementet në fjalë; qenja në dorëshkrim e disa fjalëve shqipe si «rrufe», etj. të papërthyera maqedonisht, sepse përkthyesi Acev nuk i dinte ose sepse Milloshi nuk ia kishte dhënë; tematika, problemet dhe idetë, që shtrohen e rriven në këtë vepër, janë mjaft të ngjashme me ato që Milloshi do t'i shtrojë e do t'i trajtojë në vjershët dhe në prozat e veta, të hartuara më vonë në atdhe.

Duke peshuar anët mohore dhe anët pohore, argumentet në dobi të idesë, se vepra «Jeta pa fat» është e Milloshit, janë më të besueshme, prandaj po e përfillim si të tillë.

• Vepra, siç e njohim nga fragmenti i botuar, rreh temën shoqërore aktuale të fshatit në fillimet e viteve '30 të shekullit tonë, në një mjeshtësi, ku banojnë maqedonas dhe shqiptarë, me një mënyrë të caktuar jetese, në kushtet e sundimit të rendit feudalo-borgjez, në rrëthanat e diktaturës së monarkisë serbomadhe. Është po ai kontrast shoqëror, që përftohet nga lufta e klasave antagoniste dhe që Milloshi do ta trajtojë në kushtet e diktaturës zogiste në Shqipëri. Duke përdorur mjetin e njojur stilistik të antitezës, nga njëra anë autori pëershruan fshatarët e thjeshtë me hallet e brengat e tyre, me virtytet dhe veset, me doket e zakonet, veshjet e të folmen e tyre, të shtypur e të shfrytëzuar egërsisht. Nga ana tjeter, autori pëershruan njerëzit parazitë, arrogantë e prepotentë, që përfaqësojnë klasat shfrytëzuese dhe regjimin monarkik të Jugosllavisë së kohës. Bie në sy përpjekja përfshirë paraqitur jo vetëm përfaqësues klasorë, por edhe karaktere individuale. Fshatarit të pasur Zafir i ka vdekur para

katër muajsh i vëllai, Stoimir. I shtyrë në moshë dhe i thyer nga laktmia e papërbajtjat për t'u pasuruar në kurriz të të tjerëve, ai çon një jetë të zezë në familje. S'ka vëllezër e motra, po ka gruan, Kristianën e Maxhorahësve, djalin Zllatko dhe vajzën Stojanka. Mbahet si mos më keq: pa u krehur e pa u rruar, lecka-lecka, ndonëse ka pasuri të madhe toke, mulli, ara e livadhe, një shtëpi dykatëshe, ku mban me qira, në një dhomë, mësuesin e fshatit, dhe është gati të lëshojë me qira një dhomë tjetër për priftin e ri të fshatit. I pangopur siç është për pasuri, blen veresie, çan dru me para, pranon një palë opinga pa shpërblim, shet raki me çmim të lartë. Në fshat flitet se Zafiri e ka futur me qira mësuesin për Stojankën. Kristana nuk duron thashethemet e grave të fshatit dhe do ta largojë mësuesin. Po Zafiri kundërshton. Burrë e grua rriven aq shumë njëri me tjetrin sa burri mbetet i goditur rëndë. Ajo, si egërsirë, është gati ta mbytë të shoqin, që është shumë më i moshuar se ajo. Në këtë drejtim, Kristana ndiqte rrugën e s'ëmës, e cila, po kështu, kishte vrarë dikur burrin e vet. Portreti i Zafirit dhe mjedisi i tij familjar tregojnë lakuq rënjen morale të fshatarësisë së pasur në ato rrithana të caktuara historike.

Në tregim, autori ka nxjerrë galerinë e shfrytëzuesve: fajdexhiun, që, si shkërbe, rrëmben pajën e vajzave për martesë; komendantin e xhandarmërisë, Borojeviç, nursezin e kapadaun, që përvetëson me dhunë plaçkat e fshatarët dhe i shet përvete; tagrambledhësin shtinjak, që mbledh taksat me pahir; priftin Ariton, që, në emër të fesë, u zgrap fshatarëve për çdo pagëzim e shërbesa të tjerë para e sende në natyrë. E, sikur ky të mos mjaf-

tonte, autoritetet vendosin të sjellin edhe një prift tjetër, për të forcuar pushtetin shpirtëror dhe, me të, atë ekonomiko-politik mbi masën e fshatarëve.

Në tregim dalin, me mjaft tipare vetjake, fshatarët e thjeshtë: Dimkua, Lale Simokovci, Ratkua, Nikolla, hanxhiu Branko dhe fallxhesha «doktore-shë», gjyshja Damjankë. Kjo plakë e regjur në të mashtruar të njerëzve, përgatit «ilaçë», me bar të thatë «të xhindeve» dhe me ujë nga «burimi i Osmanit». Në një episod tjetër, që na dëshmohet nga zotëruesi i dorëshkrimit maqedonisht, përshkruhet jeta e vështirë e një familjeje fshatare, e cila ka vëtëm një arë. Vdes babai i shtëpisë dhe djali, për të përballuar shpenzimet e varrimit, i drejtohet fajde-xhiut. Ky i prenton se «*do të gjejë të holla*», po qe se djali «*i jep arën*» Duke dëshiruar një zgjidhje të drejtë të problemit fshatar, autori përmend shndërrimet rrënjosore agrare, që ishin bërë në vendin e parë socialist, dhe ëndërron që një ditë ato shndërrime të bëhen edhe në vendin e tij. Në se kjo është kështu, atëherë konfirmohet më qartë dëshmia e mësuesit letrar, Teufik Gjylit, i cili do ta njohe Milloshin mësues në fshatin Vrakë, fill pasi ky ishte kthyer nga Manastiri, dhe që i kishte folur për kolkozet, sovkozet dhe SMT-t e Bashkimit Sovjetik. Në fragmentin e botuar takojmë edhe disa karakteristika të prozës së ardhshme të Migjenit: paraqitjen e ambientit shoqëror me detaje tipike, përshkrimin e shpejtë të veprimit, skicimin e personazheve me tiparet më kryesore, dialogun e shkathët, antitezën dhe ironinë therëse.

Gjatë periudhës 1933-1935 Migjeni krijoi rreth dhjetë proza të shkurtëra. Mjeshtër i tregimit dhe i përshkrimit të ngjeshur, Migjeni arrin që, në pak

penelata e dataje të goditura, të sjellë një brendi të madhe ideore dhe të shprehë ndjenja të fuqishme. Ai lavroi kryesisht prozën e shkurtër, duke mbetur shembull sidomos i hartimit të skicës. Proza e tij shquhet për realizmin dhe tematikën e gjerë aktuale që shtjellon. Për nga forca e shprehjes lapidare dhe ritmi energjik i frazës, shumë skica të Migjenit kanë harmoninë e brendshme të prozës poetike. Duke e vështruar prozën e Migjenit nga llojet e saj, dallojtmë tri kategori: shkrimet e shkurtëra me karakter satirik dhe pa ndonjë subjekt të dhënë, tek të cilat, përmes alegorisë dhe simbolit, goditen anët negative të realitetit; tregimet e shkurtra, tek të cilat, mbi bazën e një varfërije tragjike, nga e cila rrjedhin aq forma mjerimi, përshkruhen ngjarje të ndryshme ose përvijohen portrete njerëzish, të gjitha këto të gjetura si shkak për të zbuluar konceptet politike dhe shoqërore të autorit; tregime të gjata me tema ngajeta, të cilat afrohen më shumë me llojin e novelës. Në periudhën 1933-1935, Migjeni lavroi vetëm dy llojet e para. *Te Sokrat i vuej-tun apo derr i kënaqun* janë vënë ballë për ballë dy botë: mënjanë bota e virtutit, e bukurisë morale, e nderit, mishëruar me figurën e Sokratit, dhe, mbanë tjetër, bota e poshtërsisë, që drejtohet nga intresa egoiste dhe të ulëta, e paraqitur në mënyrë alegorike nga një derr. Nga këto dy përfytyrime antipode, gjatë rrjedhës historike të njerëzimit, konklidon autori, ka dalë një sintezë kompromisi, të cilën e përfaqëson njeriu filistin me paraqitje sokratike, por me përbajtje morale prej derri. Natyrish, Migjeni nuk e ka fjalën këtu për njeriun në përgjithësi, por për përfaqësuesin e klasave të pasura, të cilat jetonin mbi bazën e shfrytëzimit të

njeriut mbi njerium. Veçse ide jo tē drejtē ka realizuar autori te *Vetëvrasja e trumcakut*, ku fabula lidhet me tragjizmin e njeriut tē paracaktuar që tē rrojë nē një natyrë tē shkretë, te e cila, nē vend tē barit, mbinin qimet e derrit, e, nē vend tē pemëve, brenat e një shtaze parahistorike. Cilësitë shpirtërore, mendon autori, nuk i shërbejnë pér as gjë këtij njeriu, pérderisa natyra është aq e egër me tē. Fabula ka një mbarim pesimist. Ide më tē qarta ai shprehu nē skicat e fryshtuara drejtpërdrejt nga realiteti i gjallë i ditës. Me mjeshtëri të rrallë portretizmi Migjeni skaliti figurën e Lulit te *Luli i vocërr*. Duke e vëzhguar si mësues dhe artist nxënësin e vet, nëpërmjet këtij vogëlushi tē varfër Migjeni nxori nē pah kontrastin e thellë shqëror nē jetën e atëhershme. Luli është pjekur para kohe nga vetë rrethanat dhe pikërisht nē figurën e një fëmije tē tillë, artisti mësues Millosh ka zbuluar atë dashuri tē madhe, që karakterizonte fëmijët e popullit pér edukatorët e tyre tē vërtetë. Me Lulin dhe me një tok personazhesh tē tjerë fëmijë, shkrimitari krijoj një galeri tipash tē fëmijëve tē vegjëlisë së fshatit dhe tē qytetit, tē cilët nuk qëndrojnë pas tipave tē burrave dhe grave tē portretizuar nē prozë dhe nē poezi. Në skicat dhe nē tre-gimet mbi jetën e fshatit, shkrimitari rrëfen se si fshati gjendej nē një kontrast tē thellë me qytetin. Personazhet e ambientit fshatar, që detyroheshin tē vinin nē kontakt me botën e qytetit, binin pre tē moralit tē ulët, pre tē hipokrizisë dhe tē mashtrimit — karakteristika këto tē borgjezisë së qytetit. Nga nevoja pér tē shitur barrën e qymyrit nē pisk tē vapës, malësorja e re detyrohej tē shiste më parë nderin e vet te zotëria i qytetit (*A do qymyr, zot-*

ni?) Po një gjendje aq të mjeruar sa në jetën e fshatit, shkrimtari e vuri re edhe në vegjelinë e qytetit. Në skicën *Moll' e ndalueme* (titulli është nxjerrë pér parodi nga legjenda biblike), ai realizon një portret të qartë të proletarit të papunë, gjë që do ta bëjë, ndërkokë, edhe në disa vise të poezisë. Pünëtori endet nëpér rrugët e qytetit, porsi (*kolegët e tij në Berlin e në London»*), por nuk gjen kund punë pér të nxjerrë jetesën pér vete dhe familjen. I uritur dhe i leckosur, në kontrast të thellë me zoterinë e ngopur dhe të veshur, që sillet vërdallë pér të kalluar kohën, i papuni pështyn me urrejtje dhe kërcellen dhëmbët nga inati, shtrëngon grushtet e fortë, gati pér të qëlluar. Këtë mëri klasore Migjeni e quan «revolucion në miniatürë». Ky shtrëngim grushtash i punëtorit të papunë këtu dhe revolta individuale, që do të përshkruhet te figura e Cubit (*Puthja e Cubit*) më vonë në Pukë, dëshmojnë, nga njëra anë, pér grumbullimin e urrejtjes së punëtorëve dhe të fshatarëve ndaj rendit çifligaro-borgjez në fuqi dhe, nga ana tjetër, edhe mungesën e organizimit të tyre në një front të përbashkët të luftës revolucionare në mesin e viteve 30. Portreti i proletarit përvijohet përmes një dialogu të brendshëm dhe skicimit të shpejtë të gjesteve të tij: «*E duert e tij janë të forta, të fuqishme. Edhe dreqin e kishin kapë pér fytì dhe e kishin mbytë. Por edhe dreqin e mbron ligji.*» Migjeni tregon se shfrytëzimi thellon gjithnjë varfërinë ndër shtresat popullore, duke i kthyer, një pjesë të tyre, në lypës. Lypësi është një nga personazhet më të shpeshta te vepra e shkrimtarit. Lypësinë, ashtu si prostitucionin, rrugaçërinë dhe pijen e tepërt ai i përshkroi si fenomene tipike të realitetit bashkëkohor. Në këtë vështrim, kuptim-

plotë është titulli i prozës. *Nji refren i qytetit tim.* Shkrimtari dëgjon vetëm një refren nëpër rrugët e Shkodrës, refrenin e lypësit «*Zotni, zotni, të lutem zotni, më fal ndoj send!*» Që të mund të sigurojë kafshatën e gojës, lypësi është i shtrënguar të durojë fyerje dhe poshtërime gjithfarësh. Këtë aspekt tragjik të jetës së këtyre njerëzve autori e ka nën-vizuar me episodin e kësaj skice. Skena është dhë-në me vija të shpejta, po ka një realizim ngjethës. Një i pasur tallet me urinë e lypësit.

— «A të kujtohet si e kemi ba? Unë ty me të gjuejtë në krye me gjithë të hollat që kajm në dorë e ti, mandej, me i marrë... A je në fjalë?

— Po, por mos më bje fort. Më len tu ve syve duert, mos të më verbojsh.

— Mirë. Hajt shpejt! Haha, pse dridhe? A po ke frikë?

— Jo... por po ndjej uri.

— A ?... A nuk ke frikë?... dhe fill e në krye me kërcënimi djali e gjuejti. Monedhat u shpërndanë me tingllim e kryet s'e luejti lypsi i vogël, lypsi i mjerë; por, mandej, pa fuqi, i lodhun, u ul ndër gjuj dhe, më buzëqeshje, filloj lekët më mbledhë. Në ballë të tij, dielli shkëlgente në një pikë të kuqe: ishte gjak».

Në skica, ashtu si edhe në poezi, mjeti më i preferuar i Migjenit për pasqyrimin e jetës është kontrasti, veçanërisht ai midis të varfërve dhe të pasurve. Duke vizatuar «*njeriun zotni*», që «*notonte ndër mendime: sezona e re vjen... ndrron sezona do ndrrohet grueja, ai, fëmijët, si e lyp sezona*», dhe lypësin, që «*këndonte*» nëpër rrugët e qytetit «*Zotni, zotni, të lutem zotni, më fal ndoj send!*», shkrimtari ka theksuar me forcë të madhe pabarazinë sho-

qërore. | Këtë kontrast të trajtuar me mendime filozofike e gjejmë edhe në *Alternativë*, ose... ose... dhe *Tragjedi apo komedi*, si dhe në skicat *Ngjarje pa lëvizje* dhe *Në kishë*, ku kleri predikon nën shtrim ndaj rendit në fuqi, ndërsa vetë rron me të gjitha të mirat. Lypësi largohet nga kisha duke iu drejtuar plot urejtje priftit «*Po si do të jetoj unë?*.. Këtë kurr s'ma the. È unë, pra, duë të jetoj!». Së fundi, duke kritikuar ashpër artin antipopullor, që nuk pasqyronte mjerimin e popullit dhe i shërbente rendit shfrytëzues në fuqi, te *Novelë mbi krizën* Migjeni tregon se si shteti i të pasurve ndërsen «*artin e çfardollojshëm*», që t'ju predikojë të varfërve të shtypur «*butësi dhe pajtim*», kurse të pasurve sundues mëshirë ndaj skamnorëve. Ai rrëfen se si ky «*art*» mashtron të varfërit, pér të hequr dorë nga kërkesat e tyre («*shpirti, dikur pëllumb, ishte bamë skyfter, tash u ba prap pëllumb*»), por nuk mashtroi të pasurit: «*Dredhi? Poshtni! Ndjenjat e ngurta të të pasurve mbetën pa prekë, ndërsa ndjenjat e lypësve u banë pambuk. Kështu, lypsat nuk u kërcënohen të pasunve. Këta, pa frikë, fryhen si bibaj me thalba arrash dhe shkëlqejnë si lustra e këpucëve*».

Në periudhën 1936-1937, Migjeni e thelloj përbajtjen realiste të prozës së vet. Skicat, që iu frymëzuan nga mjedisi i fshatit malor të Pukës, janë: *Legjenda e misrit*, *Qershijat*, *Bukurija* që vret, *Zeneli*, *Puthja e Cubit*. Ndërkohë, ai trajtoi temën e qytetit te skica *Zoti të dhashtë!* dhe, më gjerë akoma, te novelat *Historia e njanës nga ato*, *Bukën tonë* të përditshme falna sot, *Studenti* në shtëpi, *Të çelen arkapijat*, etj. Te prozat e shkurtëra *Idhujt pa krena*, *Gogoli*, *Të korrundat*, *Vetvrasja e trumcakut*,

rreh mendime filozofike, kurse te *Program' e një reviste* dhe *Urime pér 1937* denoncon kryesisht artin dekадent borgjez në shërbim të klasave sunduese.

Në «*Legjenda e misrit*», një nga skicat më të goditura, shkrimtari trajtoi problemin e bukës. Por diapazoni, me të cilin e shtjelloi, tejkaloj kufijtë e këtij problemi. Në kundërshtim me disa shkrimtarë klerikalë të veriut dhe borgjezë të letërsisë zyrtare të kohës, që e idealizonin dhe e lustronin jetën e mjerë të malësisë, Migjeni e përshkroi fshatin malor ashtu siç ishte, të uritur dhe të zhveshur, ku «*një kokërr Misri asht një kokërr dhimbje, kur ka shumë û e aspak Misër*». Në ato male, me gjithë vuajtjet e rënda, dëshira pér jetë nuk është shuar te njerëzit. Por jeta nuk ka se si të kuptohet pa bukë. Dhe buka pér «*ta asht legjendë, sepse misri asht fjala e ditës, asht sinlonim i jetës pér banorët legjendarë të këtyne maleve të egra*». Kur shteti «*me gjymtyrët e mpita*» përhapi lajmin se do të ndante misër, malësorët u drodhën nga gëzimi dhe, «*si thneglat, që mblidhën rrëth një kokrrës së Misrit, q'ashtu në një qendër nënprefekturë*» u mblodhën ata «*rrëth depos së Misrit*». Ata do të merrnin misër «*pér fëmijët e tyne të nximë nga mjerimi, të cilët, kur duert shtrijnë, u përngjajnë lugetënve të vocërr*». Askush tjetër si Migjeni nuk arriti të paraqesë në letërsinë shqipe me kaq ngjyra të sakta figurën e malësorit të uritur dhe të poshtëruar, me atë krahor vërtet si copë graniti, që «*u shkëput nga mali dhe u vendos mbi dy këmbë të drejta e të forta si linda e pyllit*», por që e ka shtypur aq forturia, sa të bjerrë «*cilësinë karakteristike*» — burrerinë tradicionale — dhe të dridhet pér një kokërr misër. Për

këtë ishte shkaktar regjimi në fuqi. Me ironi të pa-përbajtur shkrimtari shfren urrejtjen e vet kundër veglave të regjimit antipopullor, duke i tallur si «*engjuj që ndajnë Misér*». Mjerimin e madh të fshatarës së autorit e paraqet me ngjyra të tillë edhe në *Qershijat*, ku përshkruhet një familje e varfër malësore. Nusja është «*e bukur, me sy të kaltërt si qielli e buzë si qershija*», por vuan nga uria. Prapë, ajo e do jetën, nuk heq dorë prej saj. I vetmi gjëzim për të ishte gjëzimi efimer që i fal dashuria e burrit. E vetmja shpresë e saj është krijesa që i fal kjo dashuri. Por një kujdes e mundon: po të lindë vajzë, ajo do ta shesë «*dhe shtëpia do fitojë*», kurse, po të lindë djale, «*ai do të detyrohet të fitojë lekë, që të blejë diçka për vete*». Kuadri i kësaj familje të varfër fshatare plotësohet me figurën e vjehrrës, së cilës jeta i shkoi me vuajtje, prandaj edhe nuk e trondit skena tragjike e lindjes së fëmijës nën pemë, me frutet e së cilës gruaja shuan urinë në vend të bukës, që i mungon, dhe me figurën e Rexh Metës, të cilin mjerimi e ka plakur para kohe dhe e ka bëré cinik e gojështurur. Në «*Bukuria që vret*», Mijgjeni jep një pamje edhe më tragjike. Një natë dimri, në një kasolle fshatarësh të varfër, ngriu një fëmijë. Për të ruajtur nga të ftohtit lopën, burimin e vetëm të jetesës, prindët u bënë padashur shkaktarë të vdekjes së fëmijës. Autori akuzon ministrat dhe deputetët, që mbajnë vegjelinë në një gjëndje të tillë shtypjeje dhe shfrytëzimi, mjerimi dhe errësire. Atyre ua «*dhuron*» si «*përmendore*» fëmijën e ngrirë. Për shkak të marrëdhënjeve të vjetra prapanike në fshat, bujqësia jo vetëm nuk përparonte, por shkonte gjithnjë e më te poshtë. Në «*Zaneli*», përmes fjalëve të nxënësit Zenel, shkrimtari paraqiti

ti edhe një herë gjendjen e prapambetur të fshatarësise punonjëse: «*Mjaft ma, Zotni mësues, mjaft na mësuet si duhet me jetue, çka asht mirë e bukur mjaft na mësuet, — megjithatë na po rrojmë si rrojtën stërgjyshnit tanë, po në ato gëzime e po në ato mjerime, të lanun e të tretun ndër këto bjeshkë. Qe, na shiko një herë, njenit nëpër këmishë të shkyeme i shifet supi i verdhë, tjetrit barku si drrasë, atij atje asht gati t'i bjerë të fikët nga uria, një tjetër prap memëzi përbahet mos t'i bajnë, dhambët brr nga ethet...» Nëpërmjet gojës së nxënësit duket se fliste një fshatarësi e tërë, e shtypur pa mëshirë nga feudo-borgjezia. Me figurën e këtij nxënësi shkrimitari dha tipin e vogëlushit malësor, i cili kishte etje të madhe pér të nxënë dhe, ndonëse i mitur, ishte aq i zgjuar dhe i vëtdijshëm, sa të kuptonte gjendjen aq të vajtueshme në të cilën jetonte. Ai është tipi i fëmijës, që, mbi dhembjen vetjake, ndjente dhembjen e popullit: «*S'kemi kurrgja, Zotni, as vegla të reja pér punë, as shtëpia higjenike të mira si në shtetet e tjera, jemi të vegjël*». Proza mbyllt me një arsyetim fatalist të autorit, por lexuesi ndahet me optimizmin që sugjeron romantika e nxënësit.*

Në skicat dhe në tregimet mbi jetën e fshatit, shkrimitari rrëfen se si fshati gjendej në një kontrast të thellë me qytetin. Personazhet e mjedisit fshatar, që detyrohen të vijnë në kontakt me botën e qytetit, bien pre e moralit të ulët, pre e hipokrizisë dhe e mashtrimit — karakteristika këto të borgjezisë së qytetit. Por me tregimin e shkurtër «*Puthja e Cubit*», Migjeni ngrihet në shkallën e kuptimit të së drejtës së fshatarësise pér t'u revoltuar. Megjithëse cubëria ishte një formë e protestës individua-

le, në një kohë kur fshatarësisë i mungonte organizimi dhe programi i qartë revolucionar që do t'ia jepte më vonë klasa punëtore me partinë e vet të pararojës, ajo formë lufte bënte për vete mjaft fshatarë të thjeshtë: «*Dilës iu ba se ky Cub nuk asht ai cub për të cilin flitshin se vret, grabit, përdhunon. Me të vërtetë po atë emën kishte, por jo, nuk ishte ai. Cubit — mik njëzetekatërvjeçar i buzëqeshej nana, i buzëqeshej Prenda, e shoqja e re e vllaut, baba i fliste me za të butë e vllau këndonte me të. Cubi — mik ishte i mirë dhe të gjithë e nderojshin».*

Një gjendje po aq të mjeruar dhe një revoltë të tillë sa në jetën e fshatit Migjeni i vuri re edhe në jetën e qytetit. Në «*Zoti të dhashtë!*» tregohet se si shfrytëzimi e thellon edhe më shumë varférinë ndër shtresat popullore, duke i kthyer një pjesë të tyre në lypës. Lypësi është një nga personazhet më të shpeshta te vepra e Migjenit. Lypësinë, ashtu si prostitutionin, rrugaçerinë dhe pijen e tepërt ai e tregoi si fenomen tipik të realitetit të kohës. Ashtu si në poezi, edhe në skica, tregime dhe novela, mjeti më i preferuar i Migjenit për pasqyrimin e jetës është kontrasti, veçanërisht ai midis të varférve dhe të pasurve. Në këtë mënyrë, shkrimtari ka theksuar me forcë të madhe pabarazinë shoqërore, p.sh., midis punëtorit të papunë dhe zotërisë parazit, etj. Por shkrimtari ka paraqitur edhe protesta kundër kësaj pabarazie. Lypësi, që dikur kishte qenë farkëtar (*Zoti të dhashtë!*), urren dhe mallkon pa pushuar. Mallkimet e tij nuk kursejnë as perëndinë. Atë e neverisin fjalët që dëgjon në kishë: — *Zoti, që kujdeset për zogjtë e qiellit, s'ka me i lanë njërezit të vdesin nga ûja. Hee — thoshte lypësi tue dalë, sot*

nuk asht njashtu. Zoti ndoshta kujdeset për trumcakë dhe për priftën, por për mue s'e besoj. Mue dhe shokët e mi po na harron edhz bota, e si të mos na harrojë Zoti, që s'na ka parasysh?» — thotë lypësi në dialogun me vetveten. I indinjuar thellë nga qëndrimi i ftohtë, i pamëshirshëm, i të pásurve, dhe nga predikimet demagogjike, mashtruese, të kishës, lypësi «shtrëngoi dhëmbët për ta ndalë gjuhën, e cila ishte gati të kalonte kufinin e njerëzisë. Shtrëngoi edhe grushtat e thojt... Përpara vetes nuk shref asgja tjetër, veç objekte mënje».

Por më gjerë jetën e qytetit e ka pasqyruar Migjeni te tregimet dhe novelat. Në tregimin «*Historia e njenës nga ato*», ai përshkruan atë kategorji njerëzish, të cilëve rendi feudalo-borgjez u shkatërron jetën: gratë e përdalura. Personazhi kryesor i tregimit është Lukja, një malësore, që kishte zbritur në qytet, e shtyrë nga uria. Për të rrojtur, ajo u shtrëngua të shiste veten. «*Shoqnia, drejt ose zhdrojt, e detyroj*», shpjegon shkrimtari. Rruga, që ajo mori, e gjymtoi fort moralisht. Ajo u bë cinike, sikurse shoqëria, ligjeve të së cilës iu nënshtrua. Por, me gjithë jetën tërë poshtërimë që bën, Lukja ka ruajtur në shpirt edhe disa gjëra pozitive. Shpesh, ndjenja e dinjitetit njerëzor, dëshira për të jetuar në mënyrë të ndershme, nxjerr krye në ndërgjegjen e Lukes të helmuar nga morali i prishur i shoqërisë së ndarë në klasa antagonistë. Ajo fillon të urrejë gjendjen e vet të poshtëuar dhe i dhembset vetja, se çdo ditë e më tepër shket në greminë. Një valë humanizmi aktiv shpërthen nga penda e Migjenit për këto krijesa, viktima të rendit shfrytëzues në fuqi: «*Kanjëherë edhe Luken e zente një trishtim i pakufishëm. I dhimbte ajo gja, që e quajnë shpirt,*

por vetëm një herë, se, po t'i dhimbte ma shpesh, zotnia do ta qitte jashtë, pse Lukja ndër ato çaste të rralla thente gota, çinia, pasqyra dhe çka t'i vinte për dore... O, sa trishtim, pothuej një dhimbë fizike ndjente kur u kujtonte se asht nji grue, që nuk prodhon, nji kukull, nji lodër, me pasë për t'ia ku-shtue dhe harrwe ato orët e mbrapshta, kur e shef veten të zhigatun në baltë». Ajo bën përpjekje për të dalë nga kjo gjendje, por pa frysht. Burri, me të cilin u martua, filloj t'ia hajë të dyqind napolonët që ajo mblođhi për të kaluar një pleqëri të qetë. E flakur në mes të katër udhëve, e vetme, pa njeri dhe pa mjete jetese, Lukja çmendet. Te ky tregim, shkrimtari sulmon me mëri moralin hipokrit të shoqërisë çifligaro-borgjeze, që rreket më kot të mbulojë shëmtinë e vet. Se si papunësia shkatërron familjet dhe i shtyn njerëzit në udhën e rrënimit moral tregohet në «Bukën tonë të përditëshme falna sot...», Personazhi, i tregimit, Kola, më parë kishte qenë kamari, kurse tani ka mbetur pa punë. Cdo ditë, që nga mëngjezi gjer në mbrëmje, ai më kot përpinqet të gjejë ndonjë punë. Punë për të s'ka. Kriza ekonomike hedh «n'ankand» cdo ditë njerëz të tjerë. Gjendja keqësohet. Në shtëpi mungon edhe gjëja më e domosdoshme — buka. Nga uria e vazhdueshme, fëmija e vetme sëmuret rëndë. Për të gjetur punë, Kola shkon në një qytet tjetër. Por edhe atje punë nuk gjen. Kur kthehet në shtëpi, ai sheh se e shoqja, për të shpëtuar fëmijën dhe për të jetuar, ka filluar të shesë veten. Atij nuk i mbetet tjetër, veçse të mbylli sytë. Duke treguar, me një realizëm të ashpër, historinë tragjike të kësaj familje, Migjeni i çjerr maskën shoqërisë borgjeze. Nga ana tjetër, ai vë re në këtë tregim se protesta,

që zë fill në shpirtin e të varfërve, duke qenë spontane, e 'paorganizuar, mbetet në gjysmë të udhës. Shkrimtarit i vjen keq që ata nuk kuptojnë ende arsyet e vërteta të mjerimeve, ku janë pllakosur. Bile, në zërin e tij, ndjehen nota qortimi. «*Kush ka faj? — Kola thotë askush s'ka faj — dhe aty qëndron e tanë tragjedia e tij.*» Monologut të brendshëm të Kolës i përgjigjet autorri në këtë mënyrë: *Vuejtja intime dëshpëruese, e cila të udhëheq në vetëvrasje. Po mirë asht që Kola mendonte ashtu e jo ndryshe. Ta dinte ai se kush e ka fajin, ose, së paku, t'ia kishte vu ai vetë kujt fajin, atëherë — eh, atëherë!.. Fuqitë e njerëzve n'ankand kushedi si do të veprojshin!*» Edhe këtu Migjeni përdor kontrastin, siç është ai që përftohet midis gjendjes shpirtërore të të papunit, Kolës, dhe tregtarit të qytetit, zotit Filip, midis varfërisë së tmerrshme të njerës palë dhe jetës së ngopur të palës tjetër. Novela «*Studenti në shtëpi*» ka për temë jetën e një familje borgjeze krahinore. Sikurse edhe tregimet e tjera, kjo novelë trajton disa probleme së toku. Kur ishte ende student, në një nga vendet e Evropës perëndimore, Nushi ishte betuar se do të jepte një «*kontribut*» për «*gjeste ideale*». Mbasimbaron studimet dhe kthehet në shtëpi, ai ndeshet me despotizmin e babait në familje dhe me zakonet patriarkale të mjedisit, siç është qëndrimi fyes ndaj femrës, etj. Të gjitha këto Nushi i vështron si gjëra, që pëngojnë përparimin e shoqërisë. Por ai nuk hidhet të luftojë konservatorizmin patriarkal që sheh si në jetën familjare ashtu dhe në atë shoqërore. I vemi «*kontribut*», që i dha përparimit të shoqërisë, ishte se mundi t'i shfaqte babait «*disi mospëlqimin e vet*» për martesën e së motrës, Ages, me një treg-

tar, burrë i kaluar nga mosha dhe i shëmtuar. Duke mos gjetur në vete forca për t'u ngritur kundër zakoneve të vjetra prapanike, që e ndrydhin njeriun shpirtërisht, Nushi filloi t'i harrojë parimet e përparrimit, për të cilat kishte ëndërruar, kur kishte qenë student. Shumë shpejt, mqedisi rrethues dhe ideo- logjia patriarkale mundën ta mposhtnin atë. Hegja dorë nga synimi për të kontribuar në emancipimin e shoqërisë ose «*falignimenti dogmatik-shpirtnuer*», si shprehet autori, ngjan sepse Nushi nuk ishte shkëputur plotësisht nga e vjetra, se ai vazhdonte t'i quante «*të shenjta*» parimet — bazë mbi të cilat ngrihej familja borgjeze. Një vend të dukshëm te novela «*Studenti në shtëpi*» zë demaskimi i moralit hipokrit të shoqërisë së kohës. Kjo temë është e lidhur me figurën e motrës së Nushit, Agen. Ajo mori një rrugë të papëlqyer, jo sepse ishte e degjeneruar, por sepse e shtyu mqedisi, në të cilin jetonte. Familja, pa e pyetur, i dha një burrë të vjetër dhe të shëmtuar, vetëm e vetëm sepse ishte i shtresës së vet të pasur, kurse, më vonë, aprovoi heshtazi lidhjen e saj me Lulin, çirakun e burrit. Lidhur me këtë motiv, Migjeni e ndërpret tregimin dhe, me një tiradë të fortë ironie, i gjerr maskën moralit borgjez: «*Nderi i shoqërisë asht i pacënueshëm. I mjeri ai, i cili provon ta cënojë! Së paku kështu ngjan përfaqe. Mos të gërdhishtet, mos të prishet lustra e shoqnisë së qytetit tonë. Të shkëlqeje lustra e marrëdhënieve tona të përditshme me shoqi-shoqin, të shkëlqeje si këpuca e lustrueme në baltë... Vettëm diçka: skandali nuk durohet. Bani çmos që të mos shkaktoni skandal!*» Temën e marrëdhënieve patriarkale trajton edhe tregimi «*Të çelen arkapijat*». Në të shkrimitari vë në lojë fanatikët e tërbuar nga

shtresa e pasur e qytetit, që nuk lënë gjë pa bërë pér të penguar emancipimin e femrës. Përfaqësuesi tipik i kësaj shtrese të mykur, që mban nën sundimin despotik familjen, është 'personazhi Oso Bakalli.

Një vend të veçantë tani zënë skicat, që trajtojnë probleme filozofike. Te «*Idhujt pa krena*», Migjeni shtron idenë se çdo rend shoqëror ka edhe format e veta shpirtërore. Kalimi nga njëri rend te tjetri bëhet nëpërmjet një «*tufani të tmershëm*», i cili del «*nga zemra e dheut*» domethënë, nga revolucioni i përcaktuar prej kushteve të brendshme të vendit dhe jo «*nga një anë e horizontit dhe as nga qielli*», domethënë jo nga revolucioni i importuar prej jashtë. Në periudhën e kalimit ndodh, në planin ideologjik, një ballafaqim i së vjetrës me të reñë, që do të përfundojë me fitoren e së resë, e cila do të jetë e aftë «*të ndërtojë*» idhujt e rinj, domethënë idealet e reja «*për t'u adhurue nga turmat*. *Se landa e tyne ka pér të qenë moral i kohës e modeli i tyne — njeriu i socëm*». Te «*Gogoli*», ku rrihet, në sferë filozofike, një temë ndërkombejtare, figura e gogolit na kujton figurën e fantazmës, me të cilën përfytyrohej nga borgjezia komunizmi, ashtu siç e kanë përshkruar K. Marksi dhe F. Engelsi te «*Manifesti komunist*». Migjeni aludon në gjendjen politike të Evropës në prak të Luftës së Dytë Botërore. Nëpërmjet liliputëve, vihet në lojë mburrja zhurmëmadhe e fashistëve, të cilët bënин «*parakalime demonstrative plot pompë, plot fjalë kumbuese nga uniformat shkëlqyese*». Shkrimtari vë në dukje frikën e madhe që i kishte kapur fashistët nga përhapja e lëvizjes komuniste ndërkombejtare. «*Zot na shpëto nga gogoli!*» thërrisin ata, ndërsa përgatit-

tin luftën. Me kauzën e fashistëve bashkohej edhe feja. «*Njerëzit e vegjël, që gjinden në errësinë, autosugjestionohën, se errësina krijon gogola. Ndonjë rrëze drite, e ardhun me gërma të ndonjë shtypi të shenjtë — u jep idenë e gogolit. Asht si King-Kongu fantastik. I tmerrshëm...*» Ashtu sikurse një nënë injorante, me qëllim që të vejë në gjumë fëmijën, e tremb këtë me hijen e gogolit, pa menduar të zbulojë shkakun e brendshëm të vajit të fëmijës, ashtu edhe klasat feudale e borgjeze, të tmerruara nga revolucioni, i trembin njerëzit e vegjël me «*gogolin*» e komunizmit, duke injoruar kërkesat e masave që ato shtypin dhe shfrytëzojnë. Te skica «*Të korrundat*», Migjeni flet për mjerimet që do t'u sillte masave punonjëse lufta imperialiste, e përgatitur me ankth nga shtetet fashiste. Me elementët e një fabule, Migjeni përshkruan njerëzit, që lëvrojnë arat, por të cilëve, në vend të grurit të mbjellur, u shfaqen topa hekuri, me gryka të drejtuara nga fshati... «*Të gjorë, me shpresë të thyera, me trishtim të papërshkrueshëm, u kthyen në fshat. E, kur arritën ndër shtëpia, gjysëm të marrë nga mendimi dhe vuajtja, fëmive, që kërcejshin dhe këndojsin, u thanë: — Do të mësoheni me ngranë hekur! — Oho, oho, me ngranë hekur! — Këndojsin dhe kërcejshin fëmijtë pa të keq.*»

Në disa skica të tjera, shkrimtari kritikon ashpër artin antipopullor. «*Program' e një reviste*» vë në lojë «*apoliticizmin*» e politikanëve hipokritë dhe të gazetarëve reaksionarë. Shkrimtari stigmatizon politikën e regjimit, i cili subvensiononte shtypin zyrtar, për të mashtuar lexuesit se, me një «*revistë ideale*, gjoja do të mbronte «*ata, që nuk kanë mbrojtje*», do të përhapte «*moralin*» fetar dhe do të

zgjonte «kombarizmin». Migjeni ka mbajtur qëndrim të papajtueshmë kundër artistëve, që nuk e vrisnin mendjen për brengat e popullit. Bashkë me ta, ai tall teorinë e «*artit për art*». Te skica «*Bukuria, që vret*» ai flet për artistët, të cilët, në vend që të pasqyrojnë jetën e mundimshme të masave, i marrin motivet për veprat e tyre nga lashtësia klasicke. Ai nuk lë pa qëlluar edhe filmat e kohës, të cilët shprehin qartë degjenerimin e artit. Dihet se Shqipëria ishte bërë një treg i lirë për kompanitë kapitaliste të kinematografisë italiane, amerikane, frenge, gjermane, që e përdorin filmin si mjet, për të propaganduar ideologjinë borgjeze dhe moralin e prishur. Te proza e llojit të epistolës, «*Urimë për 1937*», Migjeni ironizon sentimentalizmin lëngues të filmit «*Mbretëresha Kristina*»: «*Nga gëzimi i madh, në sentimentalizëm, të puthish drrasat e dhomës e shtyllat, si bani Greta Garbo, në filmin «Mbretëresha Kristina», kur shijoi dashurinë shtazore (deshë të thom hyjnore, por një soj asht)*».

Megjithatë, jó kudo Migjeni ka realizuar ide të drejta. Ashtu si tragjizmi i njeriut, që qenka i paraçaktuar të jetojë në një natyrë të shkretë malore («*Vetërrasja e trumcakut*»), ashtu edhe notat e trish-timit dhe të fatalizmit («*Zeneli*»), janë kufizime në paraqitjen e realitetit. Por, marrë në tërësinë e vep-rës në prozë, ato nuk përbëjnë thelbin ideor të saj, janë disa luhatje shpirtërore të autorit, që rrjedhin, siç e thamë edhe për ndonjë vjershë, nga gjendja shoqërore e kohës, nga presioni i ideolgjisë sunduese dhe nga kundërshtitë e tij të brendshme si njeri e si shkrimitar.

* * *

Migjeni mohon strukturën dhe superstrukturën e rendit në fuqi. Kjo pozitë e mohimit përcakton pjesën dërrmuese të prozave të tij. Ai mohon duke paraqitur, pikësëpari, me mjaft vërtetësi, gjendjen reale të shoqërisë, në pabarazinë e saj të theksuar, në ndarjen e saj klasore, në kontrastin midis punëtorëve dhe borgjezit, të fshatit dhe të qytetit, të gruas dhe të burrit, etj. Migjeni ia doli me artin e portretizimit të rijapë përfaqësuesit tipikë të masave në rr Ethanat tipike të kohës — mënjanë, përfaqësuesit e klasave të shfrytëzuara dhe, mbanë tjetër, ata të klasave shfrytëzuese. Imazhi i qytetit dhe ai i fshatit dalin mjaft qartë në veprën e tij. Ideologjia drejtuese dhe metoda artistike i dhanë dorë Migjenit që, me forcën depërtuese të vëzhgimit, të 'pasqyrimit dhe të portretizimit, të nxirrte në pah marrëdhëni et shoqërore — mjerimin e vegjëlisë, mënjanë, dhe begatinë e klasave parazitare e të veglave të tyre, mbanë tjetër. Te asnjë vepër tjetër shqiptare, para asaj të Migjenit, nuk doli më gjerë, më thellë dhe më me vërtetësi realiteti shoqëror me disa pamje të gjalla të jetës qytetare dhe fshatare, me një galeri të tërë personazhesh tipike. Migjeni është i pari që bën përpjekje serioze për të paraqitur figurën e punëtorit, të shtypur dhe të shfrytëzuar, dhe, krahas tij, vargun e cirakëve, lypësve, etj. të flakur në mes të rrugëve. Ai është nga të parët që paraqet femrën si viktimë të organizimit të padrejtë të shoqërisë, të gjendjes së saj të robëruar në familje dhe në shoqëri, të katandisjes së saj në një mjet shfrytëzimi dhe poshtërimi të pashembullt, (Qershijat,

*Studenti në shtëpi, Të çelen arkapijat, Bukën tonë
të përditshme falna sot, etj.)*

* Në galerinë e personazheve nga vegjelia bëjnë pjesë një radhë figurash fshatare, burrash dhe grash. që robëtohen në punë, të uritur dhe të zhveshur, të shfrytëzuar deri në palcë nga klasat në fuqi. (A do qymyr, Zotni?, Legjenda e misrit, Bukurija që vret. Të korrurat, etj. Dhe, në mes të këtyre personazheve nga vegjelia e qytetit dhe e fshatit, një vend të konsiderueshmë zenë figurat e fëmijëve, që nga ato anonime deri te Luli dhe Zeneli. Te këta përfaqësues të vegjelisë, shkrimtari nuk sheh vetëm objektin e shtypjes dhe të shfrytëzimit, por edhe revoltën e tyre, qoftë spontane ose të paorganizuar. Të tilla, në radhë të parë, janë figura e proletarit të papunë (Moll' e ndalueme) dhe ajo e malësorit komit (Puthja e Cubit). Përballë tyre, Migjeni ka vënë, në kontrast të thellë, përfaqësuesit e klasave shfrytëzuese: zotérinj të borgjezisë e feudalë (Sokrat i vuejtun apo derr i kënaqun?, Studenti në shtëpi, Të çelen arkapijat, etj.), që jetojnë si parazitë, duke shfrytëzuar punëtorët, që ruajnë doke dhe zakone aq prapaniqe në familje dhe në shoqëri, priftërinj hipokritë dhe servilë, që i shërbejnë me zell rendit feudalo-borgjez, duke mashtruar popullin me predikime boshe (Në kishë, Idhujt pa krena, etj.), gazetarë kalemxhinj në shërbim të regjimit reaksionar (Program' e një reviste, Novelë mbi krizë, etj.). Gjithë këto figura ai i ka dhënë me mjeshtëri të madhe portretizuese. Të parët, njerëzit e popullit, i ka përshkruar jo vetëm me ndjenjën e dhëmbjes së thellë, por edhe të dashurisë së zjarrtë, kurse të dytët, përfaqësuesit e klasave sunduese dhe veglat e tyre, me përbuzje, ironi, satirë dhe sarka-

zëm, shpesh në mënyrë karikaturale. Ai i kushtoi një rëndësi të veçantë portretizimit. Në tregimet, bile edhe në novelat, veprimet kanë një shtrirje të kufizuar dhe ndodhin shpesh pa ndonjë ndryshim planesh. Në shumicën e skicave, sikurse edhe në poezitë, nuk ekziston një veprim a subjekt i vërtetë. Migjeni i jep rëndësi veprimit, aq sa i vlen përtë ndërtuar personazhin. Figurat e njerëzve përvijohen në mënyrë të spikatur, duke nxjerrë në pah më tepër tiparet morale se sa ato fizike. Përvijimi i personazheve realizohet përmes përshkrimit të shpejtë të gjesteve, por kryesisht të monologut të brendshëm. Thua jse gjithë personazhet, që përfaqësojnë shtresat e popullit, janë të kredhura në mendime, çojnë një jetë të brendshme intensive. Por, mbi bazën e tipareve të skicuara nga autori me disa detaje tipike, që shprehin vijat më karakteristike morale dhe fizike të personazheve, mbi bazën e lëvizjeve e veprimeve të tyre të thjeshta, imagjinata e lexuesit i rindërton ato në tërë kompleksitetin e tyre. Pikërisht këtu qëndron një nga meritat më të mëdha të artit të Migjenit në prozë. Krahë paraqitjes së mjerimit të popullit, krahë paraqitjes së urrejtjes së grumbulluar në masat, protestës dhe revoltës së tyre, ai, në emër të forcave të reja shoqërore, bëri thirrje për përblysjen e rendit të padrejtë politik, ekonomik dhe shoqëror. Këto thirrje-sidomos në poezi — si dhe ëndërrimet për një të ardhshme më të bukur njerëzore, formojnë notat e romantizmit të tij revolucionar — pjesë përbërëse e realizmit, gjë që ia sugjeruan, në radhë të parë, lëvizja punëtore dhe përhapja e ideve komuniste në Shqipëri.

Por Migjeni nuk arriti që, krahë mohimit të

botës së vjetër, të shprehte pohimin e botës së re, botës socialiste. Dhe kjo ndodhi për arsyen objektive dhe subjektive. Në radhë të parë, në vitet '30, në Shqipëri ende nuk ishte ngritur në nivelin e duhur, nga ana ideologjike dhe organizuese, lëvizja punëtore, pasi i mungonte partia e pararojës, që do të themelohej vetëm pak vjet më vonë, në kushte të njo-hura historike. Njëkohësisht, Migjeni vetë ende nuk ishte i formuar plotësisht në botëkuptimin e tij materialist shkencor dhe kishte mjaft kufizime, luhatje e dobësi të tjera të karakterit vetjak, që u shprehën kryesisht te disa poezi intime dhe te disa skica të mendimit filozofik. Po pikërisht në bazën e ideologjisë drejtuese përparimtare dhe të metodës artistike të realizmit kritik me nota të romantizmit revolucionar qëndron stili i tij karakteristik, që e dallon menjëherë nga shkrimitarët e tjerë të vendit. Stili i Migjenit është zakonisht energjik. Ai gjëmon nga dhembja për të mjerët, jo me ankime, por me duf të brendshëm, me urrejtje. Ai shpërthen në sulm me poterë, kur godet shtypësit, përshkohet nga ndjenja të zjarrta, kur u bën thirrje të shtypurve për revoltë; stili është i ngjeshur me ironi, në satirën e mprehtë kundër armiqve të popullit, — ironi e cila kalon menjëherë në një sarkazëm tragjik. Në çastet e ëndërrimeve për të ardhshmen, stili bëhet thellësisht i ëmbël.

Migjeni, pra, nuk e pasqyron jetën në mënyrë indiferente, soditëse. Në prozë, ashtu si dhe në poezi, ai e përcakton qartë tendenciozitetin e vet. Një rol të caktuar për kuptimin e koncentruar të brendisë së shkrimeve të tij kanë titujt, që janë mjaft origjinalë dhe shprehës. Në të dyja gjinitë, mjetet kryesore figurative që përdor Migjeni janë: antiteza, simboli

dhe alegoria. Antitezat synojnë të nxjerrin në shesh pabarazinë në shoqëri, ndarjen në klasa antagonistë, kurse simbolet dhe alegoria thelbin e fenomeneve politike e shoqërore, që tèrheqin vëmendjen e shkrimtarit. Shpesh ai flet me aludime, nënkuptime. Ndonjëherë, përmes tyre, është e vështirë të zbulohet mendimi i tij sintezë, siç ngjet, për shembull, me disa proza filozofike. Por, kur lexuesi njihet me realitetin e kohës dhe me stilin e shkrimtarit, nuk e ka të vështirë të ndjekë fillin e ideve. Megjithatë, ka raste kur ato bëhen me të vërtetë të errëta (*Vetëvrasja e trumcakut*, etj.). Në prozë, ndryshe nga poezia, fraza është zakonisht e shkurtër, lakonike. Migjeni përshkruan, tregon dhe gjykon në mënyrë konçize. Ai nuk ndjek procedimin e analizës, por të sintezës. Prozat e tij, veçanërisht të shkurtërat, i afrohen ritmit të poeziës. Koncentrimi maksimal i frazës bëhet duke nënvisuar predikatin logjik, fjalët më të rëndësishme të mendimit. Si rregull, foljat e përherë vjen në fund. Fraza përban atë ritëm, që i jep harmoni karakteristike shprehjes. Shumica e frazave të shkurtëra ndiqet nga përsëritjet e shpeshta. Përsëritjet bëhen duke rimarrë një fjalë të frazës pararendëse, qoftë për të forcuar idenë, qoftë për të bërë lidhjen midis dy mendimeve. Janjë shembull: «*A mundet me qenë fryti i saj prodhim dashnuer i natyrës? — Fryti i saj, i filluem dhe i lindun në mjerim, edhe ka me u rritë në mjerim, se vuejtjen dhe mjerimin e merr në trashëgim. dhe, si pasojë e këtyne: urrejtjen. Urrejtja, me të cilën u lind, do ta bajë ndoshta edhe cub. E cubi asht cub!*» (*Qershijat*). Herë të tjera, përsëritet fjalë e konsideruar si thelbësore nga përbajtja për të endur tregimin. Fjalët misër (*Legjenda e misrit*), idhuj

(*Idhujt pa krena*), *gogoli* (*Gogoli*), etj. duken shpesh pér të përcaktuar vazhdimisht vlerën e tyre në têrësinë e kontekstit. Inversionet, aq të shpeshta në prozën e Migjenit, sa të përbëjnë një procedim të dendur stilistik, janë gjithashtu karakteristikë pér poezinë (*Puthja e cubit*, etj.). Përshkrimi bëhet me pak penelata, me një plasticitet skulpturor. Thellësisht realiste, proza e Migjenit dallohet pér situata, ambiente dhe figura, që japid përfytyrime të gjera. Me shprehjet konçize, që shmangin çdo rrëthanë të panevojshme pér veprimin e personazhit, shkrimitari grumbullon faktet kryesore dhe, përmes tyre, nxjerr në pah tiparet shquese të fenomenit shoqëror. Ai bën zakonisht një hyrje të menjëherëshme në shkrim ose në tregim. Dekoret e natyrës i pikëzon me ngjyrat më karakteristike, në mënyrë shumë të kursyer, sidomos kur do të nxjerrë kontrastin midis natyrës së bukur të Pukës dhe gjendjes së rëndë të banorëve të saj. Një mjet i veçantë procedimi është dialogu, i cili bëhet i ngjeshur, por i shkathët. Ndognjëherë, mjafton një frazë e vetme, në formën e pyetjes retorike ose të ndërhyrjes emocionale të autorit, pér të thyer monotoninë e tregimit. Shpesh shkrimitari përdor të folurën tipike të personazhit, pér ta karakterizuar këtë nëpërmjet gjuhës së tij.

III PËRKUJTIMI

1 Në kërkim të zbulimit dhe të botimit të veprës
së plotë.

*Thelltë në veten temë flejnë kangët e
pakëndueme,
të cilat ende vueta as gëzimi s'i nxori,
të cilat flejnë e presin një ditë ma të lumnueme
më shpërthye, m'u këndue pa frikë e pa zori.*

(Kangët e pakëndueme).

Për të gjallë të Migjenit, publiku i gjerë njo-
hu vetëm një pjesë të veprës së tij. Shumica e pro-
zave dolën në dritë pas vdekjes së shkrimtarit.

Sa ishte në Torino, atij iu botuan. *skica të ko-rrunat*¹), vjershat *Vuzjtja*²) e *Frymëzim i pafat*³) dhe, postume, novela *Zeneli*⁴). Atje, në dhe të huaj, ai shkroi prozat *Husarët n'Adriatik* dhe *Kanga e qytetit* të *huej*, filloji I fundmi *Skanderbeg*, *Kanga e trumcakut* e *Torino — Sanatorium San Luigi*, të mbeturat të gjitha dorëshkrim dhe të papërfunduara. Interes sjellin edhe letrat që u dërgoi prej atje një-
rëzve të familjes dhe disa shokëve e miqve në Shqipëri.

Pasi u bllokuan «*Vargjet e lira*» dhe nuk u lejuan të qarkullonin, admiruesit e veprës së shkrimtarit i mblodhën shkrimet e tij në poezi dhe në prozë, që ishin botuar nëpër organe të ndryshme shtypi, i daktilografuan në disa kopje dhe i shpërndanë dorë më dorë, sidomos gjatë Luftës Nacionallirimtare. Një përbledhje të tillë e ka pasë ruajtur edhe autori i këtyre radhëve.

Në fillim të vitit 1944, motra e vogël e Milloshit, Ollga, e përkrahur nga gjuhëtarri Kostaq Cipo, hodhi në shtyp «*Vargjet e lira*». Në Shqipëri sundonin nazistët gjermanë, kurse populli, i udhëhequr nga PKSH, zhvillonte luftën më të lavdishme për çlirimin e plotë kombëtar dhe shoqëror. Autoritetet censuruan dy vjersha të edicionit të parë të paqarkulluar (*Parathanja e Parathanjeve* dhe *Blasfemi*), si shumë të avancuara kundër fesë dhe klerit. Vëllimi iu shtuan tetë vjershat e fundit që poeti i kishëte shkruar pas vitit 1935 në Pukë, domethënë pasi kishte dorëzuar për shtyp variantin e parë të librit «*Vargjet e lira*». Vëllimi, i dalë më 1944, plot të meta e gabime shtypi, pati një përhapje të kufizuar në Shqipëri.

Me çlirimin e vendit dhe me ardhjen në fuqi të pushtetit popullor, interesimi për figurën dhe veprën e shkrimtarit u shtua në mënyrë të jashtëzakonshme, ashtu sikurse për figurat dhe veprat e më të shquarve shkrimtarë përparimtarë të së kaluarës.

Në gusht të vitit 1948, me rastin e 10-vjetorit të vdekjes së Migjenit, e përkohshmja «Literatura jonë», organ i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, botoi 16 nga të 22 prozat, që kishin dalë deri atëherë në shtyp.

Në gusht të vitit 1953, me rastin e 15-vjetorit

të vdekjes së Migjenit, e përkohshmja «Letërsia jonë», organ i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, batoi 2 nga të 8 prozat e panjohura, të ruajtura nga familja e autorit: *Të çelen arkapijat* dhe *Studenti në shtëpi*.

Një vit më vonë, më 1954, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve nxori librin «*Migjeni — Vepra*», që përfshinte pjesën më të madhe të lëndës së mbledhur dhe të përgatitur nga Skënder Luarasi, që në gusht të vitit 1948, për ta botuar nën kujdesin e Lidhjes së Shkrimtarëve, mbi bazën e dorëshkrimeve të ruajtura nga familja. Në vëllimin e vitit 1954 gjenden «*Vargjet e lira*», të plotësuara me vjershat e censuruara më 1944 dhe me «*Novelëzat*» ase «*Novelat e qytetit të veriut*», të pabotuara deri atëherë. Migjeni kishte lënë dorëshkrim një radhua prej 99 fletësh me titull «*Novelat e qytetit të veriut*» e me nëntitull «*Refrene të qytetit të veriut*», misur ose mbaruar së shkruari më 31 dhjetor 1936 në Shkodër. Lista përfshinte titujt: *S'ke të drejtë, o Lec!* (fshirë me vizë dhe shkruar përsipër «E drejta e Skënderit»). *Historia e njanës nga ato...*, *Bukën e përditshme falna* (zëvendësuar fjala e fundit me «epna sot»), *Matanë gardhit asgja të re*, *Pak poezi*, *Të çelen arkapijat*, *Fëmijët në shtëpi* (më vonë titulluar *Studenti në shtëpi*), *Babiloni*, *Në kishë*, *A do qymyr, Zotni?*, *Një refren i qytetit tem*, *Punëtori* (fshirë me vizë dhe zëvendësuar me *Moll' e ndalue-me*), *Në stinën e mizave* (më vonë titulluar *Në sezonen e mizave*), *Trajtat e qytetit*. Pas listës së tituve, radhiteshin, të shkruara me laps, në dorën e parë, të paqortuara: *Studenti në shtëpi*, *Të çelen arkapijat*, *Historia e njanës nga ato...*, *Pak poezi*, *Bukën tonë të përditshme falna sot*, *Matanë gardhit*.

asgja tē re (e pakryer). Në sezonën e mizave është shkruar në maj të vitit 1936 dhe lënë dorëshkrim në 4 faqe të panumëruara, kurse *Husarët n'Adriatik* dhe *Kanga e qytetit tē huej*, shkruar në Torino, janë lënë dorëshkrim në një radhua tjetër. Nëpër dorëshkrime është gjetur edhe një kartushkë, në njérën anë tē së cilës janë shkruar vargjet:

Prap dielli lindë...

dhe rrezet e tij shkrepën mbi ballna tanë» kurse në anën tjetër, «*Novelë — I fundmi Skanderbë*», filluar së shkruari më 27 korrik 1938 në Torino me këto fjalë: «*Ku janë orët dhe nuset? Shtojzavallet e zanat ku janë? S'po flitet ma për vallet e tyne. As për sytë e tyne, që tē shitojnë e tē bajnë fatbardhë, s'po flitet ma.*» Të gjitha këto tē dhëna na sillen nga S. Luarasi⁵) në botimin e vitit 1957.

Por, që nga ky botim dhe ribotimi i pastajmë i veprës së shkrimittarit nga ana e S. Luarasit, janë zbuluar disa tē dhëna tē reja tē krijimtarisë migjenniane. Kështu, në edicionin për tē rinj të vitit 1969, na sillen nga Llazar Siliqi dy vargje tē panjohura:

Përditë shoh qartë e ma qartë
dhe vuej thellë e ma thellë.

Në një shënim tonin, që e kemi ridhënë gjatë shtjellimit tē kësaj vepre, kemi sjellë fillimin e një proze tē panjohur («*Hik, moj flutur!*»), gjetur në faqen e një libri tē bibliotekës së Migjenit, dhe vargjet e para tē një poeme («*Poema e punës*»), kushtuar punës dhe dëshmuar nga një i njohur i poetit në Pukë. Vitet e fundit u zbuluan dhe u vendosën në arkivin e Muzeut popullor tē Shkodrës disa shënime me vlerë, tē shkruara nga Miloshi, dhe që

kanë lidhje me 'punën e tij si mësues në Vrakë⁵) dhe në Pukë.⁶) Gjithashtu, u bë e njohur një pjesë e një proze të gjatë me titull «*Jeta pa fat*»⁷), që thuhet se është shkruar shqip nga Migjeni në Manastir, por që na dëshmohet në përkthimin maqedonisht të një përkthimi të parë serbokroatish nga origjinali. Po bëhet fjalë, jashtë vendit tonë, edhe për një farë ditari të lënë nga Migjeni. Skënder Luarasi, në botimin e vitit 1957, shënonte «*Milloshi, jo vetëm që i lexonte, ai i studjonte shkrimtarët e mëdhenj.* Në një fletë dorëshkrimi, që na ka rënë në dorë nga koha shkollore e tij, ne kemi një provë të shënimëve që mbante në rusisht e serbisht. Pasi ka lexuar «*Peltie: Zakonet dhe arti i Revolucionit Francez*», bën përbledhjen në rusisht... Po në këtë fletë shënimesh, nën titullin «*Të mjerët*» e Viktor Hugo-jt, bën një përbledhje...». Dhe vazhdon të na sjellë shënimet e Migjenit për «Krim e ndëshkim» të F. Dostojevskit dhe për «Othello»-n e U. Shekspirit. Ky radhua nuk njihet prej nesh. A është ky, apo ndonjë tjetër, gjithashtu i panjohur prej nesh, që ka tërhequr vëmendjen e të tjerëve, nuk e dimë. Sidoqoftë, dëshmimi i origjinalit do të sillte shumë interes për të rrrokur botëkuptimin dhe botëndijimin e Migjenit si njeri dhe si shkrimtar.

2 Letërsia kujtimore

«*Milloshi studjonte shumë. Asnjëherë nuk e shikojshë pa një gazetë a pa një revistë në dorë...».*

(T. Gjyli: «Disa shënime të jetës së Migjenit në vitet 1934-1937»).

Figura dhe vepra e Millosh Gjergj Nikollës janë bërë objekt kujtimesh dhe letërsia kujtimore rrëth tyre po pasurohet gjithnjë e më shumë.

Për periudhën e fëminisë në Shkodër dhe për atë të fundit në Torino vlejnë të përmenden shënimet e motrës së vogël të Milloshit, Ollgës⁸⁾.

Jeta dhe mësimet e Milloshit si nxënës në Manastir janë ndriçuar pak deri më sot⁹⁾. Diçka më gjerë na është ndriçuar periudha e jetës dhe e veprimtarisë së tij gjatë qëndrimit si mësues në Vrakë, në qytetin e Shkodrës dhe në Pukë, falë kujtimeve, në radhë të parë, të Teufik Gjylit¹⁰⁾ dhe Andrea Stefit,¹¹⁾ si dhe të Abdullah Çangës, Filip Ndoçajt, etj. — që të gjithë bashkëmësues dhe të njojur të tij. Duhet shënuar se figura e Milloshit është rrokor vetëm si shkrimitar dhe pak e aspak si mësues. Për t'u vlerësuar, në mënyrë të veçantë, është kujdesi i Skënder Luarasit, i cili, duke qenë dikur shok i Milloshit dhe, më vonë, i afërt i familjes së tij, ka ruajtur dhe ka çmuar me pasion disa materiale të vyera të krijimtarisë migjeniane.¹²⁾ Hedhin dritë mbi disa kënde të panjohura të figurës dhe të veprës së Migjenit edhe kujtimet e shkrimitarit Petru Marko, mësueses Arta Franja, mjekut Nikolla Shurbani, etj.

Me siguri mbetet shumë për të plotësuar kuadrin e kujtimeve rrëth figurës dhe veprimtarisë së shkrimitarit e mësuesit Millosh Gjergj Nikolla. Është detyrë e të afërmve, e miqve, e shokëve edhe e të njoburve të tjerë që ta bëjnë këtë gjë. Dhe ne kemi besim se ata do ta bëjnë. Atëherë, një përbledhje e këtyre kujtimeve të çmuara në një vëllim më vete do të ishte mirëpritur nga publiku ynë

i gjerë lexues dhe, veçanërisht, nga admiruesit e shumtë të Migjenit.

3 Kritika dhe shkenca letrare

«Vjershat e Migjenit... i këndova me interes të thellë».

(Fan S. Noli, 21 tetor 1948)

Me jetën, veprimtarinë dhe krijimtarinë e vet, Migjeni është bërë objekt i rëndësishëm i kritikës dhe i shkencës letrare. Ai është si guri i çmuar, i cili në dorën e mjeshtrit, që e pastron nga pluhuri i kohës, merr një ndriçim të ri më të qartë, më të shkëlqyer. Ai ka hyrë në mendimin shoqëror letrar si një nga më të shquarit artistë të fjalës, si shkrimitari revolucionar i së kaluarës më i afërti i epokës sonë të revolucionit dhe të ndërtimit socialist, kurse, në historinë e arsimit tonë kombëtar, si Mësues i Popullit.

C'është e vërteta, deri tani, thuajse i tërë historishkrimi ynë letrar është marrë me anën ideomatike të veprës së tij dhe ka arritur të vlerësojë drejt, pas zbulimit të mjaft shkrimeve inedite, vepren e tij, duke nxjerrë në pah meritën e pasqyrimit realist, duke vënë në vendin e duhur të letërsisë sonë prioritetin e saj në krye të rrymës demokratike, përparimtare, antizogiste dhe antiimperialiste të viteve '30, pa injoruar kundërshtitë brënda kësaj rryme dhe brenda vetë figurës e veprës së shkrimtarit. Janë sqaruar mjaft mirë ideologjia

dredhuese, metoda artistike, rruga e krijimtarisë dhe disa çaste ose aspekte të jetës e të veprimtarisë së tij. Por kjo punë ende nuk është shterruar dhe sçsur, aq më tepër që ka mendime të ndryshme përmjaft probleme të karakterit krijues. Është detyrë e kritikëve dhe e studjozëve të sqarojnë më thellë idetë filozofike dhe pikëpamjet estetike të Migjenit, të dallojnë më qartë etapat e zhvillimit të artit të tij në poezi dhe në prozë, të përcaktojnë më mirë veçoritë themelore të këtij arti, lidhjen dialektike të idesë me figurën, të poezisë me prozën, të artistit me mësuesin, të njeriut me epokën. Mbetet përmë studjuar, gjithashtu, gjuhën e tij letrare, ndikimet që pësoi ai nga mjeshtrit e mëdhenj të fjalës artistike dhe ndikimet që ushtron ai te bashkëko-hësit.

Migjeni nuk ka nevojë as për spekulimet filozofike eklektike dhe estetizante as për tevlerësimet sociologjike vulgare, që ia kanë mbuluar tërë kufizimet dhe luhatjet objektive e subjektive. Ai nuk qas as denigrimin as idolatrinë, as ata që duan ta zbresin në radhën e shkrimitarëve të rëndomtë, duke ia hequr vlerën ideoestetike dhe emocionale realiste, revolucionare, novatore, as ata që duan ta mbiçmojnë në një piedestal të paqënë, duke e më-njanuar nga tabani historik kombëtar dhe shoqëror dhe duke e ngritur në një obelisk të veçuar. Migjeni kërkon vetëm një trajtim — vlerësimin shkencor.

Kemi përmendur konsideratën e lartë që kishte për figurën dhe krijimtarinë e tij «*Bota e re*» e Korçës, tribuna e shkrimtarëve të rinj përparimtarë realistë kritikë të lidhur me lëvizjen punëtore dhe demokratike, antizogiste dhe antiimperialiste. Por duhet theksuar se, sa qe gjallë, Migjeni nuk ia doli ta

botonte tërë veprën që shkroi, kështu që publiku lexues nuk e njohu në tërësinë e saj, sidomos protzën e tij të llojit të novelës. Sepse, sipas mendimit të përgjithshëm, ai shquhet po aq në prozë sa edhe në poezi.

Vdekja e tij prej ftizie në moshë aq të re, si Kolë Mirdita-Helenau para tij dhe Veli Stafa — Platonicus e Gaspér Pali — Gimi 'pas tij, u konsiderua si një humbje e madhe e letërsisë shqipe përparimtare. Migjeni pësoi gjithashtu atë fat që pësuan shumë shkrimitarë shqiptarë të periudhës së Rilindjes dhe të asaj që e pasoi — vdekjen në dhe të huaj. Vdekja e tij e parakohshme pikëlloi bashkudhëtarët e tij letrarë dhe mësues, si dhe rininë revolucionare, që kishte varur shpresa tek ai. Në sanatoriumin e Golnikut, ku priste vdekjen nga ajo lëngatë, kur dëgjoi humbjen e Migjenit, Veli Stafa — Platonicus shkroi: «*Poetët janë të paqetë... Migjeni heci nëpër male, kambë për kambë me mal-sorin e uritun, hyni nëpër kolibe, prigjojti kasolleth e gjet... Gjet një trup të pa mish me skeletën që lëkura nuk mund t'i mshifte, e gjet të ngrimë atë trup... Ndoshta nga të ftohtit? Ndoshta nga uria? O nga njana o nga tjetra. A por nga të dyja bashkë? E grabiti cunkthin e ngrimë, e muer më vete nëpër shkrepat e thatë të malësisë shkodrane, e çoi në qytet e bërtiti me za të dëshpruem: — Merrnje, o bashkëqytetas, ju kam pru një shtatore të mermertë, kushtonja kujt të doni!»¹³⁾*

Por i pari, që vërejti novatorizmin e artit të Migjenit, duke e çmuar si një prijës të letërsisë realiste shoqërore të së ardhmes, që Dhimitër S. Shuteriqi,¹⁴⁾ vetë shkrimitar i ri përparimtar i asaj kohë. Pak a shumë këtë vlerësim i bëri më pas Kristaq

Tutulani, që kishte debutuar te «*Bota e re*» e Korçës dhe që, me fillimet e Luftës Nacionallirimtare, u radhit në vargun e luftëtarëve komunistë me pushkë e pendë në dorë dhe ra dëshmor, bashkë me të motrën Margaritë. Ai shkroi, më 1940, me rastin e dyvjetorit të vdekjes së Migjenit: «*Migjeni solli në truallin tonë një frysme të he poetike. Të re në çdo pikëpamje, motive të reja, shprehje të reja, horizonte të reja, melodi të reja... Këndoi këngën e tij, këngën përbijtë e njerkës në këtë botë, poezinë bruttale të mjerimit, poezinë e revoltës kundër paragjykimeve Paçavra të mykura, poezinë e një agimi kuqërrrem, që nis të shpërndajë me dritën e tij të errtit e një nate plot èndrra të liga...*». Ai vërejti faktin se Migjeni, jo vetëm theu rregullat fikse të vargëzimit me ritme, rima dhe rrokje të matura, por i ra ndesh edhe rrymës manieriste të vjershërimit folklorizant, që u bë në modë aso kohe: «*Kënga e Migjenit shpërtheu në «Vargje të lira» dhe kjo qe një lule e re me një erë të panjohur në kopshtin tonë letrar të mësuar me format e vjetra plot caqe e rregulla. Meqenëse ishte shpërthimi spontan i një shpirti të lirë, nuk mund ta adoptonte muzikën monotone të një vargu të rregullt. Dhe, ndonëse, si kuptohet, nuk e krihë e nuk e përpunonte vargun, megjithëse ndiesia muzikore e tij është dicëka e vecantë, që s'i përngjan melodisë melankolike e të butë të ndonjë poeti tjetër shqiptar, prap se prap kushedi sa vargje na magjepsin me muzikalitetin e tyre.*»¹⁵⁾ Dihet simpatia që kishte përmigjenin dhe ndikimi që pësoi nga ai Qemal Stafa — Brutus, ashtu siç pësuan ndikim nga ai edhe Veli Stafa — Platonicus, Kristaq Tutulani dhe Gjikë Kuqali. Pikërisht ky i fundit, që posa kishte filluar

të shkruante dhe që, ashtu si Qemali dhe Kristaqi, do të bjerë dëshmor si luftëtar komunist gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, bëri këtë shënim, më 1940, me rastin e dyvjetorit të vdekjes të Migjenit: «*Poema në prozë të një të vërtete të hidhur... Jo fjalë e fjalë, varg e varg, por mendime madhështore të një gjentu të botës së re shqiptare, mendime që vijnë si një grusht i fortë dhe hedhin poshtë vallen e nxirë e të vjetër, që ia ndalon shkëlqimin mendjes së mykur të më së madhes pjesë të rinisë sonë!..*¹⁶⁾

Në vitet e zjarrrta të Luftës Nacionalçlirimtare, shtypi klandestin revolucionar e kujtoi me nderim Migjenin, krahas Naimit, Çajupit, etj., si shkrimitar, që i përkiste trashëgimit shpirtëror të popullit.

Me çlirimin e atdheut, me ardhjen në fuqi të pushtetit popullor, filloi studimi i veprës së shkrimitarit të shquar mbi baza shkencore. Nëpër organet e shtypit dolën shëname, artikuj kritikë, studime dhe monografi rrëth jetës dhe veprës së tij. Meritën, nga të parët, që t'i bënte një vlerësim të ri Migjenit në tërësi, e ka Dhimitër S. Shuteriqi, i cili botoi një studim¹⁷⁾ me rëndësi, më 1948, me rastin e dhjetëvjetorit të vdekjes. Nëpër antologjitet dhe tekstet shkollore të leximit letrar hynë pjesë të ndryshme nga vepra migjeniane në poezi dhe në prozë, duke zënë vendin e merituar në planet dhe programet e shkollave të të gjitha kategorive. Krahas përpjekjeve për të njojur figurën dhe veprën e tij, duke zbuluar shkrime të pabotuara dhe duke sjellë kujtime interesante, kritika dhe shkenca letrare ndërmorën studime serioze për t'i caktuar Migjenit vendin e denjë në historinë e letërsisë shqipe.¹⁸⁾ dhe kjo për meritë të disa studjozëve, si Koço Bihiku,¹⁹⁾ Skënder Luarasi,²⁰⁾ Razi Brahimi,²¹⁾ Mark

Gurakuqi,²²⁾ Hulusi Hako,²³⁾ Adriatik Kallulli,²⁴⁾ Luan Kokona,²⁵⁾ Jeton Ostreni,²⁶⁾ Dalan Shapullo,²⁷⁾ etj. dhe të disa shkrimtarëve, si Nonda Bulka,²⁸⁾ Ismail Kadare²⁹⁾, Shevqet Musaraj,³⁰⁾ Zihni Sako³¹⁾, Lazar Siliqi,³²⁾ etj. Përpjekje janë bërë për një bibliografi të Migjenit (1934-1961) nga Jup Kastrati³³⁾. Studime janë kryer rrëth jetës dhe krijimtarisë së tij edhe nga kritikë, studjozë e shkrimtarë të Kosovës, si Ali Jasiqi,³⁴⁾ Ramiz Kelmendi,³⁵⁾ Rexhep Qosja,³⁶⁾ etj. Fan S. Noli, kur lexoi vjershat e Migjenit që ia kishte dërguar Skënder Luarasi, i shkroi këtij nga Bostoni më 21 tetor 1948: «Ju falem nderit për vjershat e Migjenit të cilat i këndova me interes të thellë». ³⁷⁾ Duke përkufizuar, në mënyrë të ngjeshur, vlerën artistike të Migjenit, Lazar Siliqi shkruan: «Na e vlerësojmë... Migjenin për artin e tij të madh e të vërtetë, për fuqinë e mendimit dhe të shprehjes artistike, tipike migjeniane, për lakinizmin dhe largimin nga çdo retorizëm, për figurat e mëdha dhe të vëllimshme, për kontributin në pasurimin e letërsisë sonë me një figurativitet plot fantazi, për forcën impresionuese të përshkrimeve të tij, të kontrasteve dhe antitezave të tija, për potencën emocionale të fjalës së tij, për ironinë dhe sarkazmën asgjësuese, për ashpërsinë e sulmeve dhe për ndjenjat e holla lirike, aq delikate, për penelatat prej piktori dhe plasticitetin skulptural, për ndjenjën muzikore të artit të tij, për gjuhën e gjallë dhe jetësore». ³⁸⁾ Ndërsa për Razi Brahimin Migjeni është «flamurtar i letërsisë sonë luftarakë»³⁹⁾, për Ismail Kadarenë ai është «Novator i madh»⁴⁰⁾ i letërsisë sonë.

4. Përmendore morale për njeriun, mësuesin dhe shkrimtarin revolucionar.

«... i ngriti vetes një përmendore, që kurre
nuk do të humbasë...»

(Gjikë Kuqali, 1940)

Në shkurt të vitit 1956, u sollën në atdhe eshtrat e Millosh Gjergj Nikollës dhe u vendosën në varrezat e dëshmorëve të atdheut, në qytetin e tij të lindjes. Figura e tij u nderua me titullin e lartë «Mësues i Popullit» dhe me «Urdhërin e lirisë» të shkallës së parë. Të mbeturat e tij të çmueshme u vendosën në shtëpinë-muze, në qytetin e lindjes, pranë shtëpisë, ku ai lindi dhe kaloi fëmininë e parë. Me emrin e tij u pagëzuan shkolla, teatër, shtypshkronjë, ndërmarrje artistike, rrugë, etj. Artistë të fjalës i kushtuan vargje, kompozitorët këngë, piktorë dhe skulptorë i ilustruan vjershat dhe prozat ose e përjetësan me portrete, buste e përmendore. Herë pas here, sidomos në raste jubilare, krahas mbrëmjeve dhe konferencave përkujtimore, bëhen homazhe me lule të freskëta mbi varrin e tij, organizohen sesione shkencore dhe nxirren botime për kategori të ndryshme lexuesish. Në sytë e admiruesve, ai ka mbetur pérherë i ri. Nuk e kërkoi lavdinë. Lavdia e ndoqi pas. Dhe tërë kjo, që u bë e do të bëhet, është përmendorja morale e ngritur për të nga populli, nën udhëheqjen e Partisë, që çmon aq lart traditat e bukura patriotike dhe kulturore të kombit shqiptar.

Vepra e Migjenit tonë është përkthyer brenda

dhe jashtë vendit në disa gjuhë të huaja⁴¹) (ruse, italiane, angleze, etj.). Mjaft kritikë, studjozë, shkrimtarë dhe publicistë të huaj kanë vlerësuar dhe vlerësojnë veprën e shkrimtarit tonë të shquar. Nikolaj Moraru, shkrimtar dhe kritik rumun, ka shkruar: «*Kam qarë kur kam lexuar Migjenin. Nuk më vjen turp të them se qava, por më vjen turp të them që vetëm tani, në moshën dyzetvjeçare, munda ta njoh këtë poet të mrekullueshëm*». Alen Boské, shkrimtar dhe kritik freng, shënoi në «*Combat*» (1972) se Migjeni ishte «*poet i madh i viteve '30*».

Tani mund të nxjerrim disa konkluzione të përgjithshme.

Migjeni militoi në fushën e krijimtarisë letrare me një konceptim mjaft të përparuar materialist mbi natyrën, shoqërinë dhe artin. Demokrat me aspirata socialiste, ateist, antifetar dhe antiklerikal i vendosur, ai mori anën e lëvizjes mendore më përparimtare, që zhvillohej në Shqipëri në vitet '30, në kushtet e reaksionit të ashpër monarkik feudalborgjez. Mbështetje e ideologjisë së tij drejtuese përparimtare dhe e metodës së tij artistike të realizmit kritik me nota të romantizmit revolucionar ishte lëvizja demokratike dhe punëtore, antizogiste dhe anti-imperialiste, në krye të së cilës qëndronin forcat e reja shoqërore, në radhë të parë komunistët konsekuantë revolucionarë.

Vepra e tij përbën një unitet nga ana e përmbytjes dhe e formës, ashtu si poezia e tij me prozën.

Përbajtja e re i diktoi formën e përshtatshme. Ai shkruante në kushtet e një kontrolli dhe censure të rreptë të regjimit ndaj mendimit të lirë. Por,

veç kësaj, ai shprehej në mënyrën e vet, në atë stil, që ka tiparet e veta karakteristike.

Migjeni jetoi një kohë të gjatë larg atdheut. Kjo, pa dyshim, e pengoi të njihte më thellë pasurinë gojore dhe të shkruar të letërsisë shqipe. Në fillim, kur u ngul në vendlindje, ai duhet të ketë hasur vështirësi në shkrimin e shqipes, por, në sajë të pasionit dhe të vullnetit që tregoi, ia mori shpejt dorën gjuhës dhe e përdori këtë me shumë aftësi. Migjeni shkroi në variantin letrar verior. Por ai është njëri nga ata shkrimtarë të bashkëvariantit verior skajor, që, në vitet '30, i afrohen me shkrim bashkëvariantit të mesmë. Për më tepër, tek ai gjejmë edhe ndonjë ndikim të variantit letrar jugor. Ai bëri përpjekje t'u shmanget mjaft fonetizmave lokale dhe të përdorë një fjalor të pasur. Bile qëllon që të formojë edhe fjalë të reja ose të shtjerë në punë fjalë të 'papërdorura deri atëherë. Në stilin e vet futi edhe neologjizma, sidomos për sferën filozofike. Por ai ka edhe mjaft dobësi gjuhësore, që vërehen në disa trajta të ngushta dialektore, në luhatjet e drejtshkrimit, në përdorimin jo të përpiktë të ë-s, etj. Megjithatë, gjuha e tij është e gjallë dhe shumë shprehëse për idetë që shtjellon dhe figurat me të cilat i trajton ato. Fjala e tij artistike ka një fuqi emocionuese, që të rrëmben.

Migjeni mbetet një demokrat revolucionar, një mësues përparimtar, një shkrimtar i shquar, që talentin e vuri në shërbim të popullit, të demokracisë dhe të përparimit shoqëror.

Me veprën e vet, poezi dhe prozë, ai 'pasqyroj, në mënyrë realiste, në kushtet e pabarazisë shoqërore të viteve '30, gjendjen e vajtueshme të masave punonjësve të qytetit dhe të fshatit, të shtypura dhe

të shfrytëzuara, të gozhduara në varfëri, në mjerim, në sëmundje dhe në padituri. Ndaj u quajt «poet i mjerimit». Ai demaskoi pa mëshirë shkaktarin e kësaj tragedie shoqërore e kombëtare, rendin çifliga-ro-borgjez në fuqi, me institucionet e tij — shtetin, ligjet, fenë, artin, etj. — si dhe fashizmin, që po shtrinte kthethrat anembanë dhe po përgatiste luftën e përgjakshme botërore; përshkroi protestën dhe revoltën e masave; ëndërroi dhe paralajmëroi revolucionin e tyre për të shembur botën e vjetër dhe përtë ndërtuar një botë të re me aspirata socialiste që ia ushqeu lëvizja punëtore dhe komuniste në Shqipëri dhe në arenën ndërkombëtare. Ndaj u quajt «poet revolucionar», «poet i rinisë».

Përfaqësuesi më i denjë i letërsisë demokratike të viteve '30 në Shqipëri, ai e pasuroi më tej, me ide, tema dhe motive të reja, me tablonë realiste të shoqërisë shqiptare, fondin shoqëror të letërsisë sognë përparimtare, pavarësisht nga disa kufizime për shkaqe objektive dhe subjektive, formoi traditën më të shëndoshë për letërsinë e ardhshme të Luftës Nacionallçirimitare dhe të revolucionit socialist. Nga kjo anë, vepra e tij ruan një vlerë të madhe njohëse. Ajo ruan edhe një vlerë të madhe edukuese: frymëzon dashuri për masat punonjëse, për punëtorët dhe fshatarët, dhe urrejtje për klasat shfrytëzuese, feudale dhe borgjeze. Janë pikërisht këto dy ndjenja, që përshkojnë tejandanë veprën dhe përcaktojnë humanizmin e tij aktiv dhe optimizmin e tij për të ardhshmen e shoqërisë.

Vepra e Migjenit, poezi dhe prozë, ndonëse e pakët në vëllim, por novatore në brendi dhe në formë, ruan një vlerë të madhe artistike për pasqyrimin me vërtetësi të realitetit, për thellësinë e men-

dimit — sintezë, për forcën figurative të shprehjës konçize, për mjeshterinë stilistike.

Si e tillë, vepra e Migjenit ka hyrë jo vetëm në fondin e çmuar të letërsisë kombëtare, por edhe në kontributin që populli shqiptar sjell në visarin e kulturës së popujve përgjithësisht. Migjeni qëndron në radhën e shkrimtarëve më të shquar shqiptarë dhe, njëkohësisht, në galerinë e shkrimtarëve të njo-hur përparimtarë të viteve '30 në shkallë botërore.

-
- 1) «Përpjekja shqiptare», 16 gusht 1938.
 - 2) «Kombi», korrik-gusht, 1938.
 - 3) «Përpjekja shqiptare», dhjetor 1938.
 - 4) «Përpjekja shqiptare», dhjetor 1938.
 - 5) Llazari Vasil, Prenushi Mikel: *Të dhëna të reja për Migjenin si mësues*, në «Mësuesi», 1 janar 1965, si dhe Kraja Musa: *Migjeni si mësues*, në «Mësuesi», 23 gusht 1972.
 - 6) Muzeu popullor i Shkodrës: Dosja «Milosh Gjergj Nikolla — Migjeni», 1972.
 - 7) Jasiqi Ali: *Dy fjalë për dorëshkrimin «Jeta pa fat»*, në «Fjala», 12 dhjetor 1971, si dhe «*Jeta pa fat*», fragment i përkthyer shqip nga maqedonishtja prej Alush Kamberit, në «Fjala», 12 dhjetor 1971.
 - 8) Luarasi Ollga (Nikolla): *Im vëlla Milloshi* në «Migjeni»: «*Luli i vocërr*», Tiranë, 1957, si dhe në «Migjeni: *Veprat*», Tiranë, 1957.
 - 9) Popa Theofan: *Kujtime*, në «Migjeni: *Vepra*», Tiranë, 1957, si dhe Shaplllo Dalan: *Pas gjurmëve të jetës së Migjenit* në «Nëntori», 1972, Nr. 2, f. 29-32.
 - 10) Gjyli Teufik: *Disa shënime të jetës së Migjenit* në vitet 1934-1937, në «Nëntori», 1955, Nr. 11, f. 70-76, si dhe *Kujtime*, në «Nëntori», 1961, Nr. 10, f. 56-68;

- «Parathënje», në «Migjeni: *Luli i vocërr*», Tiranë, 1957.
- 11) Stefi Andrea: *Rreth historisë së botimit të vëllimit «Var-gjet e lira»*, në «Nëntori», 1955, Nr. 11, f. 68-70, si dhe *Rreth «Gogolit» të Migjenit* (letër redaksisë) në «Buletin» i I Sh, seria Shkencat Shoqërore, 1955, Nr. 1, f. 171-172.
 - 12) Luarasi Skënder: *Hyrje. Jeta. Koha. Vepra e Migjenit*, në *Migjeni: Vepra*, 1957.
 - 13) *Migjeni: Vepra*, mbledhur dhe redaktuar nga Skënder Luarasi, Tiranë, 1957.
 - 14) Shuteriqi Dhimitër S.: *Arti i Migjenit*, në «Përpjekja shqiptare», dhjetor 1938, f. 399-402.
 - 15) *Migjeni: Vepra*, mbledhur dhe redaktuar nga Skënder Luarasi, Tiranë, 1957.
 - 16) *Migjeni: Vepra*, mbledhur dhe redaktuar nga Skënder Luarasi, Tiranë, 1957.
 - 17) Shuteriqi Dhimitër S.: *Migjeni*, në «Literatura jonë» 1948, Nr. 8, f. 1-14.
 - 18) Bala Vehbi: *Millosh Gjergj Nikolla — Migjeni*, në «Buletin» i I Sh, seria «Shkencat Shoqërore», 1954, Nr. 1, f. 55-78.
 - 19) Bihiku Koço: *Proza e Migjenit*, në «Studime filologjike», 1971, Nr. 4, f. 11-46.
 - 20) Luarasi Skënder: *Vepër e përmendur*, 1957.
 - 21) Brahimi Razi: *Migjeni, flamurtar i letërsisë sonë lufta-rake*, në «Nëntori», 1958, Nr. 8, f. 137-160, si dhe *Migjeni dhe letërsia e sotme*, në «Drita», 1963, 25 gusht.
 - 22) Gurakuqi Mark: *Disa motive e veçanti të veprës letrare të Migjenit*, në «Drita», 1961, 1 tetor; si dhe *Tema antifetare në veprën e Migjenit*, në «Nëntori», 1967, Nr. 8, f. 175-188.

- 23) Hako Hulusi: *Migjeni ateist*, në «Shkencat shoqërore në shkollë», 1967, Nr. 2, f. 42-47.
- 24) Kallulli Adriatik: *Migjeni, poet revolucionar*, në «Drita» 1966, 13 nëntor.
- 25) Kokona Luan: *Mendime rreth metodës artistike të Migjenit*, në «Studime filologjike», 1965, Nr. 3, f. 131-138.
- 26) Ostreni Jeton: *Mendime mbi veprën e Migjenit*, në «Nëntori», 1961, Nr. 10, f. 37-51.
- 27) Shaplllo Dalan: «*Duke lexuar një novelë të Migjenit*, në «Drita» 1961, 8 tetor.
- 28) Bulka Nonda: *Millosh Gjergj Nikolla — Migjeni*, fjalë e mbajtur në Shkodër me rastin e 50 vjetorit të lindjes së Migjenit, në «Nëntori», 1961, Nr. 11, f. 147-155.
- 29) Kadare Ismail: *Pa i mbushur kurrë 28 vjetët dhe pa u plakur kurrë*, në «Drita», 1961, 8 tetor; si dhe *Novatori i madh*, në «Drita», 1963, 25 gusht, *Migjeni ynë i madh*, në «Drita», 1968, 25 gusht.
- 30) Musaraj Shevqet: *Lavdi e përjetëshme poetit tonë revolucionar*, fjalë e mbajtur në Tiranë me rastin e 50-vjetorit të lindjes së Migjenit, në «Nëntori», 1961, Nr. 11, f. 130-146.
- 31) Sako Zihni: *Millosh Gjergj Nikolla — Migjeni*, në «Zëri i Popullit» 1958, 27 gusht.
- 32) Siliqi Lazar: *Migjeni ynë*, në «Migjeni: Vepra të zgjedhura» Tiranë, 1969, f. 3-11.
- 33) Kastrati Jup: *Bibliografia e Migjenit (1934-1961)*, në «Nëntori» 1961, Nr. 10 f. 69-94 si dhe *Bibliografia e Migjenit (1934-1961)*, në «Migjeni: Vepra» Tiranë, 1961, f. 243-259.
- 34) Jasiqi Ali: *Dy fjalë për dorëshkrimin «Jeta pa fat»*, në «Fjala», 12 dhjetor 1971, f. 4.

- 35) Kelmendi Ramiz: *Proza e Migjenit* në «Jeta e re», 1955, f. 384-401.
- 36) Qosja Rexhep: *Dialogje me shkrimtarët-I*, Prishtinë, 1968, f. 179-213.
- 37) Luarasi Skënder: *Vepër e përmendur*, 1957.
- 38) Siliqi Llazar: *Vepër e përmendur*, 1969.
- 39) Brahimi Razi: *Vepër e përmendur*, në «Nëntori», 1938, Nr. 8.
- 40) Kadare Ismail: *Vepër e përmendur*, në «Drita», 1963, 25 gusht.
- 41) Migjeni (Milosh Gjergj Nikolla): *Izbranoe*, perevod s'allbanskovo gosudarstvenno izdatelstvo hudozhestvennoj literaturi, Moskva, 1954, f. 155;
Migjeni: — *Poesia e proso*, Tirana, 1962, f. 186;
- Migjeni: — *Selected albanian songs and sketches*, translated by Ali Cungu, the «Naim Frashëri», State Publishing House, Tirana, 1963, f. 114;
- Migjeni: *Poèmes*, Edition P. Seghers, Paris, 1965, f. 8.
- Migjeni: *Fructul oprit*, traducere si cuvînt înainte de Grigore Brâncuș, Editura pentru literatură universală, Bucuresti 1967, f. 147.

PASQYRA E LËNDËS

I JETA DHE VEPRIMTARIA	3
Fëminia në Shkodër	3
Nxënës në Tivar dhe në Manastir	13
Mësues në fshatin Vrakë dhe në qytetin e Shkodrës ..	33
Mësues në Pukë	55
II KRIJIMTARIA LETRARE	73
Në Torino, muajt e fundit	64
Poezia	73
Proza	90
III PËRKUJTIMI	117